**FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

**Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)*

KLAME

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K21518003F

NUIS/NIPT

Njesia Administrative 11, Koder Kamez, Rruga Gani Kryeziu, Nr.23, Kati I

Adresa

| Tiranë | Albania | 1000 |
|---|---|---|
| Qyteti | Shteti | Kodi Postar/Posta |

| 0686279075 | |
|---|---|
| Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) | Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës) |

gshehi@gmail.com

E-mail

Administrator Gëzim Shehi

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

| | 2024/06/18 |
|---|---|
| Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar | Data (viti/muaji/dita) |

| 0692335244 | |
|---|---|
| Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës) | Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës) |

**Seksioni II: Informacion mbi procedurën**

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-09025-06-11-2024

| Tipi i proçedurës për ankesën | Tipi i ankesës |
| --- | --- |
| Procedure Prokurimi Publik | Vleresim |

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Local

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor qe administron procesin e prokurimit.*

Bashkia Kamez

Vlera e përllogaritur e prokurimit

*Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

19647617

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuadër.*

Mobilim i shkollës 9- vjecare “Azem Hajdari” Njesia Administrative, Babrru Paskuqan

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2024/06/27

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

*(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)*

---

Data e nënshkrimit të kontratës

*(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)*

---

Tipi i kontratës

Mallra

Data e zhvillimit të procedurës

2024/06/07

Numri i njoftimit

REF-09025-06-11-2024

Kodi CPV

30100000-0

Ankese mbi argument në KPP

**Seksioni III: Përshkrimi i ankesës**

**1. Baza ligjore**

*(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)*

Ligji Nr.162/2020, date 23.12.2020 “Per Prokurimet Publike”, i ndryshuar

**2. Objekti i ankesës**

- Modifikim i dokumentave të tenderit ☑

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj. ☐

*(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)*

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. ☐

*(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)*

- Pavlefshmëri kontrate ☐

*(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)*

- Tjetër ☐

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

**3. Rrethanat dhe faktet**

*Përshkruani rrethanat e faktit.*

3. Rrethanat dhe faktet
Pershkruani rrethanat e faktit.
Ne daten 12.06.2024, eshte publikuar ne SPE procedura e prokurimit me te dhenat e referuara me siper. Nga verifikimi me kujdes i kritereve, rezulton se ato nuk jane hartuar ne perputhje me legjislacionin e prokurimeve publike. Duke qene se jemi brenda afatit 10 ditor te percaktuar ne nenin 110 te LPP-se, pasi procedura e prokurimit ne fjale eshte mbi kufirin e larte monetare (12.06.2024-21.06.2024), paraqesim ankesen me shkeljet konkrete si ne vijim: I) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
1. 2.3.2.Operatori/et ekonomik pjesemarres per te realizuar prodhimin/montimin dhe shperndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe sherbimin e transportit duhet te kete minimalisht te punesuar, si me poshte:
Stafi
Nr.
Shofer
2
Punetore te thjeshte
4
Marangoz
4
Saldator
2
Inxhinier Perpunimit te drurit
2
Arkitekt
1
Total
15
- Per punonjesit e punesuar shofer te paraqitet kontrate pune perkatese si dhe leje drejtimi per secilin.
- Per punonjesit e punesuar punetore te thjeshte te paraqitet vetem kontrate pune perkatese.

- Per punonjesit e punesuar marangoz te paraqitet kontrate pune perkatese si dhe iqt deshmite e kualifikimit profesional teknik per secilin .
- Per punonjesit e punesuar saldator te paraqitet kontrate pune perkatese si dhe iqt deshmite e kualifikimit profesional teknik secilin.
- Per punonjesit e punesuar Inxhinier Perpunimit te Drurit te paraqitet kontrate pune perkatese, diploma dhe CV per secilin,
- Per punonjesin e punesuar Arkitekt te paraqitet kontrate pune perkatese, diploma dhe CV,
Te gjithe punonjesit e kerkuar me lart duhet te jene te deklaruar dhe te paraqitet listepagesat e sigurimeve shoqerore per 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave
Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:
Nr
Emer Mbiemer

Profesioni
Data e fillimit te marredhenieve te punes
2. SE PARI Kerkesa per ......“4 Marangoz”...... eshte teresisht e ekzagjeruar dhe aspak e argumentuar, ne nje kohe qe proceset e punes jane teresisht te automatizuara dhe montimi i mobileve behet tereisht nga puntoret.
3. Referuar procesverbalit “PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM”, te publikuar nga ana e autoritetit kontraktor ne Sistemin Prokurimit Elektronik, eshte argumentuar si me poshte:
Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter eshte i lidhur ngushte me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarres.
Kerkesa per numrin minimal te punonjesve eshte percaktuar duke patur parasysh sasine e pajisjeve te nevojshme, afatin e percaktuar per levrimin e kontratave bazuar ne MK, e lidhur kjo me kohen e perfundimit te Rindertimit te godines dhe venien e menjehereshme te saj ne funksionim.
Kerkesa per dy Inxhinier Perpunimit te drurit eshte e lidhur ngushtesisht me realzimin e objektit te prokurimit per shkak te ndjekjes specifike dhe realizimit ne kohe te te gjithe sasise se mallit te prokuruar qe baze te tij ka materialet drusore dhe derivate te tij.
4. Sic dukshem shihet, pervec sa autoriteti kontraktor ka theksuar ne menyre te pergjithshme se “Kerkesa per numrin minimal te punonjesve eshte percaktuar duke patur parasysh sasine e pajisjeve te nevojshme, afatin e percaktuar per levrimin e kontratave bazuar ne MK, e lidhur kjo me kohen e perfundimit te Rindertimit te godines dhe venien e menjehereshme te saj ne funksionim.”, nuk ka argumentuar ne baze te nje Analize teknike dhe Grafike se numri prej 4 Marangozash eshte jetik dhe se 1 ose 2 Marangoz nuk japin garanci se objekti do realizohet me sukses. Pra, jemi perpara atyre rasteve klasike kur autoriteti kontraktor thjesht sa ka deshtuar te mireargumentoje nje kerkese per nje numer kaq te madh Mobileresh, thua se punen e bejne Mobileret dhe jo punonjesit dhe makinerite e automatizuara.

5. Sic del nga sa me siper, autoriteti kontraktor ka deshtuar te provoje ne baze te nje analize teknike dhe grafike se perse nevojiten 4 Marangoz dhe jo fjala vjen 6 apo 2 apo edhe 1 te tille. Autoriteti kontraktor eshte mjaftuar me nje rrjesht fjalie dhe mendon se e ka permbushur detyrimin ligjor qe te mireargumentoje kriteret dhe kerkesat qe i’u ngarkon operatoreve ekonomik qe duan te marin pjese ne gare.
6. Ne nenin 2 “Qellimi” te ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qellim i ketij ligji eshte: a) te rrise efiçencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik; b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik; dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik.”
7. Ne Nenin 3 “Parime te pergjithshme” te ligjit 162/2021 “Per prokurimin publik”,i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatoret ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore jane te detyruara te zbatojne detyrimet e percaktuara ne legjislacionin mjedisor, social e te punes dhe ne dispozitat e marreveshjeve dhe konventat nderkombetare, te ratifikuara ne perputhje me Kushtetuten.”.

8. Ne Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” te ligjit 162/2021 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor eshte pergjegjes per prokurimin ne perputhje me dispozitat e ketij ligji dhe te akteve nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij, duke garantuar respektimin e parimeve te trajtimit te barabarte, transparences, konkurrences dhe mosdiskriminimit, te parashikuara ne kete ligj. Ne kuptim te kesaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin te mireplanifikoje ne cilesi dhe ne kohe fondet publike e nevojat e tij dhe te prokuroje e te zbatoje kontraten ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.”.
9. Ne Nenin 77 “Kerkesat per kualifikim”, pika 4, te ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, i ndyshuar, parashikohet shprehimisht se: “4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne veçanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontratat e zbatuara ne te shkuaren. Aftesia profesionale e operatoreve ekonomike per te ofruar sherbimin, punen, mallin vleresohet ne lidhje me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem per te zbatuar kontraten, siç eshte pershkruar nga autoriteti ose enti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates.”.
10. Ne nenin 40, pika 5 “Kerkesa te veçanta per kontratat e mallrave” te VKM Nr. 285 date 19.5.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Per te provuar pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kerkon: a) licencat profesionale per prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore; dhe /ose b) nje liste te personelit

kryesor, te nevojshem per te zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentet e saj. Lista e personelit kryesor duhet te perfshije CV-te e tyre dhe licencat profesionale, kur kane te tilla sipas legjislacionit p?rkat?s; dhe/ose c) fuqine punetore te operatorit ekonomik te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo qe mund t’i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten, te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit.”.
11. Theksojme se kriteret per kualifikim vendosen qe ti sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithçka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne kete kuptim, per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatoret ekonomike pjesemarres ne proceduren e prokurimit zoterojne kapacitetin teknik e konkretisht deshmi per pervojen e meparshme. Autoriteti kontraktor eshte organi pergjegjes per prokurimin e fondeve publike, ne perputhje me dispozitat ligjore e nenligjore ne fuqi, ndaj dhe percaktimi i kritereve te veçanta per kualifikim eshte lene nen pergjegjesine e autoritetit kontraktor, gjithnje ne perputhje e perpjesetim me objektin e natyren e kontrates se prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret per kualifikim duhet te hartohen ne perputhje me LPP-ne dhe rregullat e prokurimit publik, ne menyre te tille qe te nxisin pjesemarrjen dhe konkurrencen e operatoreve ekonomike, te stimulojne pjesemarrjen e biznesit te vogel dhe te mesem, si dhe te sigurojne nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne keto procedura, per realizimin me sukses te kontrates me qellim zgjerimin e rrethit te pjesemarrjes se operatoreve ekonomike ne respekt te nenit 2 te LPP-se.
12. Bazuar ne sa me siper, si edhe referuar vleres se kontrates, natyres se mallit si dhe shperndajes se tij ne Bashkine Kamez, gjykojme se percaktimi i numrit te Marangozeve, duhet te vije pas nje analize te hollesishme te te gjithe elementeve te procedures se prokurimit si volumi, natyra, grafiku

i levrimit, afati i kontrates dhe mundesise se mobilizimit te Marangozeve ne orare te caktuara, sikunder parashikojne dispozitat ligjore ne fuqi. Sa me siper, bazuar ne te gjithe elementet e cituar me larte, shoqeria jone gjykon se, kerkesa per disponimin e 4 Marangozeve, eshte nje kerkese e pajustifikuar nga autoriteti kontraktor. Duam te theksojme se per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet disponimi i numrit te nevojshem te Marangozeve nga ana e operatoreve ekonomike, por percaktimi i numrit te tyre duhet te vije pas nje analize gjithperfshirese te autoriteti kontraktor, i te gjithe elementeve te cituara me siper, me qellim percaktimin e numrit te tyre, ne menyre te arsyeshme, proporcionale, si dhe ne perputhje me nevojat reale, per ekzekutimin e kontrates ne menyre te suksesshme, ne respekt te nenit 77 “Kerkesat per kualifikim”, pika 4, te ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, i ndyshuar dhe nenit 40, pika 3 te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “3. Kerkesat e veçanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 77, te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatoret ekonomike per permbushjen e ketyre kritereve”. Gjithashtu, referuar dokumentacionit te aktit mbi miratimin e dokumenteve te procedures se prokurimit objekt ankimi, konstatojme se autoriteti kontraktor nuk ka arritur te argumentoje teknikisht mbi kerkesen per disponimin e nje numri prej 4 Marangozesh si deshmi te fuqise punetore.
13. Sa me siper, kerkojme ndryshimin e kriterit kualifikues lidhur me numrin e Marangozeve duke e e ulur ne minimalisht 1-2 te tille ose ne proporcion me nje grafik dhe analize te detajuar dhe duke u bazuar ne volumin e zerave te furnizimeve te percaktuar ne listen e preventivit/zerave te mallrave.

14. SE DYTI, kerkesa qe ??. “Per punonjesit e punesuar marangoz te paraqitet kontrate pune perkatese si dhe iqt deshmite e kualifikimit profesional teknik per secilin.”, eshte nje kerkese teresisht e paligjshme per dy arsye:
15. Se pari, vertetimi i faktit se nje person eshte apo nuk eshte Marangoz nuk vertetohet me IQT apo sic ndryshe quhen deshmi te kualifikimit teknik, por vertetohen me diploma te shkolles se mesme profesionale ose me certifikata kualifikimesh te leshuara nga Institucione Publike apo Private te Akredituara per te kualifikuar dhe certifikuar punonjes si Marangoz.
16. Ne ligjin Nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise”, ne nenin 3 te tij percakton se: “Arsimi dhe formimi profesional ka per mision: a) te zhvilloje kompetenca personale e profesionale te nevojshme, si dhe shprehi e kompetenca te tjera te diversifikuara, qe pasqyrojne preferencat dhe nevojat e veçanta te punedhenesve per te siguruar mireqenie sociale dhe zhvillimin ekonomik; b) te ofroje arsim dhe formim profesional ne perputhje me nivelin e zhvillimit te shkences e te teknologjise, me kerkesat e tregut te punes ne ndryshim te vazhdueshem, si dhe me kulturen e traditen kombetare; c) te siguroje perputhshmeri nderkombetare te dokumenteve certifikuese te leshuara.” Ndersa ne piken 17 te nenit 4 te po ketij ligji thuhet se: “Certifikatat/deshmite/diplomat” jane dokumente zyrtare te llojeve te ndryshme, te leshuara nga nje organ certifikues, te cilat regjistrojne arritjet e nje individi pas vleresimit, sipas nje procedure e standardi te paracaktuar. Nderkohe sipas parashikimeve te ligjit te sipercituar, Kualifikimi profesional” eshte nje sistem njohurish, aftesish, qendrimesh dhe vlerash, te cilat mundesojne ushtrimin me sukses te nje aktiviteti te caktuar profesional, i cili mund te perftohet nepermjet mesimnxenies te nje ofrues i AFP-se, i permbyllur me provime dhe i certifikuar nepermjet nje dokumenti perkates (certifikate).
17. Akoma me tej, vete Komisioni i Prokurimeve Publike, me ane te Vendimit Nr. K.P.P.238/2021, date 25.05.2021, ka arsyetuar se:
“Lidhur me kete fakt, KPP gjykon se dokumenti Deshmi per kualifikimin e sigurimit teknik/Certifikate mbi sigurimin teknik te paraqitura nga operatori ekonomik ankimues per pjesen me te madhe te punonjesve, ka per qellim sigurimin teknik te punonjesve gjate ushtrimit te profesionit te tyre ne perputhje me ligjin nr. 8734 date 01.02.2001, “Per Garantimin e Sigurise se

Punes te Pajisjeve dhe Te Instalimeve Elektrike", i ndryshuar, por nuk zevendeson ne asnje rast deshmine profesionale te cilen autoriteti kontraktor e ka kerkuar shprehimisht ne kriterin e kualifikimit per te gjithe punonjesit."
18. Se dyti, IQT ose apo sic ndryshe quhen deshmi te kualifikimit teknik, jepen per personat qe punojne prane Impianteve Elektrike dhe jo cdo punonjes te mundshem.
19. Lidhur me kete fakt, shoqeria jone gjykon se dokumenti Deshmi per kualifikimin e sigurimit teknik/Certifikate mbi sigurimin teknik, ka per qellim sigurimin teknik te punonjesve gjate ushtrimit te profesionit te tyre ne perputhje me ligjin nr. 8734 date 01.02.2001, "Per Garantimin e Sigurise se Punes te Pajisjeve dhe Te Instalimeve Elektrike", i ndryshuar, por nuk zevendeson ne asnje rast deshmine profesionale per punonjesin e kualifikuar si Marangoz.

20. Ne kete kuptim, kerkojme qe te modifikohet kriteri duke vendosur qe vertetimi i punonjesve Marangoz te behet me diploma te shkolles se mesme profesionale ose me certifikate te leshuara nga Institucione Publike apo Private te Akredituara sipas legjislacionit ne fuqi.
21. SE TRETI Kerkesa per ......"2 Inxhinier Perpunim Druri"...... eshte teresisht e ekzagjeruar dhe aspak e argumentuar, ne nje kohe qe proceset e punes jane teresisht te automatizuara dhe montimi i mobileve behet teresisht nga puntoret.
22. Referuar procesverbalit "PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM", te publikuar nga ana e autoritetit kontraktor ne Sistemin Prokurimit Elektronik, eshte argumentuar si me poshte:
Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar. Ky kriter eshte i lidhur ngushte me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarres.
Kerkesa per numrin minimal te punonjesve eshte percaktuar duke patur parasysh sasine e pajisjeve te nevojshme, afatin e percaktuar per levrimin e kontratave bazuar ne MK, e lidhur kjo me kohen e perfundimit te Rindertimit te godines dhe venien e menjehereshme te saj ne funksionim.
Kerkesa per dy Inxhinier Perpunimit te drurit eshte e lidhur ngushtesisht me realzimin e objektit te prokurimit per shkak te ndjekjes specifike dhe realizimit ne kohe te te gjithe sasise se mallit te prokuruar qe baze te tij ka materialet drusore dhe derivate te tij.
23. Sic dukshem shihet, pervec sa autoriteti kontraktor ka theksuar ne menyre te pergjithshme se "Kerkesa per dy Inxhinier Perpunimit te drurit eshte e lidhur ngushtesisht me realzimin e objektit te prokurimit per shkak te ndjekjes specifike dhe realizimit ne kohe te te gjithe sasise se mallit te prokuruar qe baze te tij ka materialet drusore dhe derivate te tij." , nuk ka argumentuar ne baze te nje Analize teknike dhe Grafike se numri prej 2 Inxhinieresh eshte jetik dhe se 1 i tille do te conte ne deshtimin e realizimit te kontrates me sukses.
24. Pra, edhe ketu jemi perpara rastit kur autoriteti kontraktor thjesht sa ka deshtuar te mireargumentoje nje kerkese per nje numer kaq te madh Inxhinieresh, thua se punen e bejne ata dhe jo Puntoret dhe makinerite e automatizuara.
25. Ne nenin 2 "Qellimi" te ligjit 162/2020 "Per Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se: "Qellim i ketij ligji eshte: a) te rrise efiçencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik; b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik; dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik."
26. Ne Nenin 3 "Parime te pergjithshme" te ligjit 162/2021 "Per prokurimin publik",i ndryshuar, parashikohet se: "1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe

jodiskriminues per operatoret ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre

proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore jane te detyruara te zbatojne detyrimet e percaktuara ne legjislacionin mjedisor, social e te punes dhe ne dispozitat e marreveshjeve dhe konventat nderkombetare, te ratifikuara ne perputhje me Kushtetuten.".

27. Ne Nenin 21 "Autoriteti ose enti kontraktor" te ligjit 162/2021 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: "1. Autoriteti ose enti kontraktor eshte pergjegjes per prokurimin ne perputhje me dispozitat e ketij ligji dhe te akteve nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij, duke garantuar respektimin e parimeve te trajtimit te barabarte, transparences, konkurrences dhe mosdiskriminimit, te parashikuara ne kete ligj. Ne kuptim te kesaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin te mireplanifikoje ne cilesi dhe ne kohe fondet publike e nevojat e tij dhe te prokuroje e te zbatoje kontraten ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.".

28. Ne Nenin 77 "Kerkesat per kualifikim", pika 4, te ligjit nr.162/2020 "Per prokurimin publik", i ndyshuar, parashikohet shprehimisht se: "4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne veçanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontratat e zbatuara ne te shkuaren. Aftesia profesionale e operatoreve ekonomike per te ofruar sherbimin, punen, mallin vleresohet ne lidhje me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem per te zbatuar kontraten, siç eshte pershkruar nga autoriteti ose enti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates.".

29. Ne nenin 40, pika 5 "Kerkesa te veçanta per kontratat e mallrave" te VKM Nr. 285 date 19.5.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar parashikohet se: "Per te provuar pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kerkon: a) licencat profesionale per prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore; dhe /ose b) nje liste te personelit kryesor, te nevojshem per te zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentet e saj. Lista e personelit kryesor duhet te perfshije CV-te e tyre dhe licencat profesionale, kur kane te tilla sipas legjislacionit p?rkat?s; dhe/ose c) fuqine punetore te operatorit ekonomik te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten, te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit.".

30. Theksojme se kriteret per kualifikim vendosen qe ti sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithçka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne kete kuptim, per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatoret ekonomike pjesemarres ne proceduren e prokurimit zoterojne kapacitetin teknik e konkretisht deshmi per pervojen e meparshme. Autoriteti kontraktor eshte organi pergjegjes per prokurimin e fondeve publike, ne perputhje me dispozitat ligjore e nenligjore ne fuqi, ndaj dhe percaktimi i kritereve te veçanta per kualifikim eshte lene nen pergjegjesine e autoritetit kontraktor, gjithnje ne perputhje e perpjesetim me objektin e natyren e kontrates se prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret per kualifikim duhet te



hartohen ne perputhje me LPP-ne dhe rregullat e prokurimit publik, ne menyre te tille qe te nxisin pjesemarrjen dhe konkurrencen e operatoreve ekonomike, te stimulojne pjesemarrjen e biznesit te

vogel dhe te mesem, si dhe te sigurojne nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne keto procedura, per realizimin me sukses te kontrates me qellim zgjerimin e rrethit te pjesemarrjes se operatoreve ekonomike ne respekt te nenit 2 te LPP-se.
31. Bazuar ne sa me siper, si edhe referuar vleres se kontrates, natyres se mallit si dhe shperndajes se tij ne Bashkine Kamez, gjykojme se percaktimi i numrit te Inxhiniereve, duhet te vije pas nje analize te hollesishme te te gjithe elementeve te procedures se prokurimit si volumi, natyra, grafiku i levrimit, afati i kontrates dhe mundesise se mobilizimit te Marangozeve, Puntoreve, sikunder parashikojne dispozitat ligjore ne fuqi. Sa me siper, bazuar ne te gjithe elementet e cituar me larte, shoqeria jone gjykon se, kerkesa per disponimin e 2 Inxhiniereve, eshte nje kerkese e pajustifikuar nga autoriteti kontraktor. Duam te theksojme se per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet disponimi i numrit te nevojshem te Inxhiniereve nga ana e operatoreve ekonomike, por percaktimi i numrit te tyre duhet te vije pas nje analize gjithperfshirese te autoriteti kontraktor, i te gjithe elementeve te cituara me siper, me qellim percaktimin e numrit te tyre, ne menyre te arsyeshme, proporcionale, si dhe ne perputhje me nevojat reale, per ekzekutimin e kontrates ne menyre te suksesshme, ne respekt te nenit 77 "Kerkesat per kualifikim", pika 4, te ligjit nr.162/2020 "Per prokurimin publik", i ndyshuar dhe nenit 40, pika 3 te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar, parashikon se: "3. Kerkesat e veçanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 77, te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatoret ekonomike per permbushjen e ketyre kritereve". Gjithashtu, referuar dokumentacionit te aktit mbi miratimin e dokumenteve te procedures se prokurimit objekt ankimi, konstatojme se autoriteti kontraktor nuk ka arritur te argumentoje teknikisht mbi kerkesen per disponimin e nje numri prej 2 Inxhiniereve si deshmi te fuqise punetore.
Sa me siper, kerkojme ndryshimin e kriterit kualifikues lidhur me numrin e Inxhiniereve duke e e ulur ate ne 1 te tille.
32. SE KATERTI, Kerkesa qe krahas dokumentacionit si diploma, kontrata pune te ......"paraqiten edhe CV te Inxhiniereve te Perpunimit te Drurit dhe Inxhinierit Arkitekt"...... eshte teresisht e ekzagjeruar dhe aspak e argumentuar, ne nje kohe qe nuk eshte kerkuar si kriter nje eksperience e caktuar per ta.
33. Referuar procesverbalit "PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM", te publikuar nga ana e autoritetit kontraktor ne Sistemin Prokurimit Elektronik, eshte argumentuar si me poshte:
Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar. Ky kriter eshte i lidhur ngushte me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarres.
Kerkesa per numrin minimal te punonjesve eshte percaktuar duke patur parasysh sasine e pajisjeve te nevojshme, afatin e percaktuar per levrimin e kontratave bazuar ne MK, e lidhur kjo me kohen e perfundimit te Rindertimit te godines dhe venien e menjehereshme te saj ne funksionim.

Kerkesa per dy Inxhinier Perpunimit te drurit eshte e lidhur ngushtesisht me realzimin e objektit te prokurimit per shkak te ndjekjes specifike dhe realizimit ne kohe te te gjithe sasise se mallit te prokuruar qe baze te tij ka materialet drusore dhe derivate te tij.
34. Sic duket nga sa me siper, kemi zero argument se perse kerkohen CV e Inxhiniereve, per pasoje kemi te bejme me mosargumentim te kerkeses, nuk eshte kerkuar qe Inxhinieret te kene nje eksperince te caktuar, per pasoje kerkojme heqjen e kerkeses per CV si te pa argumentuar.
35. SE PESTI, Kerkesa qe ka te beje me:
Te gjithe punonjesit e kerkuar me lart duhet te jene te deklaruar dhe te paraqitet listepagesat e

sigurimeve shoqerore per 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave
Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:
Nr
Emer Mbiemer
Profesioni
Data e fillimit te marredhenieve te punes
36. Referuar procesverbalit "PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM", te publikuar nga ana e autoritetit kontraktor ne Sistemin Prokurimit Elektronik, eshte argumentuar si me poshte:
Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar. Ky kriter eshte i lidhur ngushte me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarres.
Kerkesa per numrin minimal te punonjesve eshte percaktuar duke patur parasysh sasine e pajisjeve te nevojshme, afatin e percaktuar per levrimin e kontratave bazuar ne MK, e lidhur kjo me kohen e perfundimit te Rindertimit te godines dhe venien e menjehereshme te saj ne funksionim.
Kerkesa per dy Inxhinier Perpunimit te drurit eshte e lidhur ngushtesisht me realzimin e objektit te prokurimit per shkak te ndjekjes specifike dhe realizimit ne kohe te te gjithe sasise se mallit te prokuruar qe baze te tij ka materialet drusore dhe derivate te tij.
37. Sic duket nga sa me siper, kemi zero argument se perse kerkohet DATA e FILLIMIT te MARDHNIEVE te PUNES, kur ne kriter nuk kerkohet asgje ne lidhje me eksperiencen e punonjesve, per pasoje kemi te bejme me mosargumentim te kerkeses, per pasoje kerkojme heqjen e kerkeses si te pa argumentuar.
II) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
39. 2.3.3 Operatori ekonomik pjesemarres, duhet te disponoje te pakten 2 (dy) mjete transporti, me qellim transportin e mallrave, te cilet duhet t'i kete ne pronesi ose me qira.
Nje mjet transporti me kapacitet mbajtes te pakten 3 Ton dhe te pajisur me Certifikaten e transportit te mallrave dhe nje mjet transporti me kapacitet mbajtes te pakten 1,5 ton.
Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:
Nr.
Lloji i mjetit
Targa
Kapaciteti mbajtes
Statusi

1
Pronesi/qira/perdorim
Shenim: Per mjetet e transportit OE duhet te paraqese Certifikaten e Pronesise, Leje Qarkullimi, Kolaudimin, Siguracionin dhe pagesen e taksave.
Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.
Mjetet e transportit qe do te deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.
- Kriteri konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit te vetedeklarimit sipas shtojces 8 te DST. Shenim: Referuar pikes 1, te nenit 26, te VKM nr.285, date 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : "Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas p?rcaktimit n? nenin 82, t? LPP-se, dhe n? k?to rregulla", si dhe percaktimet e pikes 6, te ketij neni, ku parashikohet:

“Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njesuara me origjinalin”.
40. Kerkesa qe kapaciteti mbajtes i mjeteve te transportit te jete minimalisht 1.5 ton dhe 3 ton, eshte e pa nevojshme dhe aspak e argumentuar teknikisht apo grafikisht, sa kohe ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar qe operatoret te deklarojne transportin e mallit me mjetet e tyre, sa kohe eshte kerkuar qe operatoret te kene eksperienca te ngjashme te meparshme te sukseshme, sa kohe ka kerkuar qe operatoret te jene te certifikuar me ISO 9001-2015.
41. Sipas llogjikes se autoritetit kontraktor nje mjet transporti qe mban 500-600-800 apo 900 kg nuk vlen per te realizuar transportin e mallit. Akoma me tej, referuar Argumentave per kete kriter ne Procesverbalin per Argumentimin e Kritereve te Kualifikimit, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka hartuar nje analize dhe grafik teknik qe do te mbeshteste kerkesen e tij se mjetet duhen patjeter minimalisht 1.5 ton dhe 3 ton, pra, kemi te bejme me nje kerkese evazive dhe per pasoje abuzive. Kjo eshte nje kerkese teresisht e pajustifikuar dhe si e tille duhet te modifikohet.
42. Ne procesverbalin “PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM”, te publikuar nga ana e autoritetit kontraktor ne Sistemin Prokurimit Elektronik, eshte argumentuar si me poshte:
Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky kriter eshte i lidhur ngushte me objektin e kesaj kontrate si dhe me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarres.
43. Baza ligjore e referuar nga autoriteti nuk e zhvesh kete te fundit nga pergjegjesia per te mireargumentuar kerkesat e vecanta te kualifikimit. Pra, autoriteti nuk mund te justifikohet se ka referuar nje baze ligjore por duhej te kishte analizuar se perse i duhen mjetet me kete tonazh gje qe ka deshtuar ta beje.

44. Nisur nga sa me siper referuar, shoqeria jone gjykon se, percaktimi nga ana e autoritetit kontraktor te kriterit kualifikues te referuar me siper qe kapacitetet mbajtes te mjeteve t transporti te jene minimalisht 1.5 ton dhe 3 ton, ku ne argumentim nuk del pesha qe ka secili mall qe do furnizohet dhe rruget qe do te kryeje secili prej mjeteve si dhe duke mos percaktuar nevojen qe ka autoriteti kontraktor per nje tonazh te tille kaq te madhe dhe qe ky tonazh na qenkerka vendimtar, jetik dhe i lidhur shume ngushte me realizimin me sukses te objektit te prokurimit. Kujtojme se pesha me madhe e mallit nuk i kalon 80 kg dhe per keto pesha nuk nevojitet mjet me kapacitet mbajtes me shume se 500 kg. Referuar procesverbalit per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve per kualifikim, gjykojme se autoriteti kontraktor ne asnje rast nuk ka argumentuar ligjerisht e jo me teknikisht, se si keto dy mjetet me kapacitet mbajtes me tonazh minimalisht 1.5 ton dhe 3 ton dhe jo me fjala vjen 500-700 kg, ndikon ne realizimin me sukses te kontrates. Ne kete kuader shoqeria jone gjykon, se autoriteti kontraktor duhet te heqe kerkesen qe mjeti te kete kapacitet mbajtese minimalisht 1.5 ton dhe 3 ton duke e vendosur kete kapacitet ne nje tonazh me te ulet se 1.5 ton, sipas nje grafiku te analizuar qarte dhe sakte teknikisht, keshtu te rritet konkurrenca ndermjet operatoreve ekonomike. Per me teper qe autoriteti ka kerkuar nga operatoret ekonomik te paraqesin deklarate me ane te se ciles ata marrin persiper:
“2.3.6 Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me ane te se ciles merr persiper te kryeje sherbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen neper vende te te gjithe artikujve ne adresen e autoritetit kontraktor, te perfshire ne kete procedure prokurimi.”
45. Pra, nese nje operator deklaron nen pergjegjesin ligjore se i del “per zot” transportit te mallit sipas afatit atehere nuk ka vend per kerkesa te tjera te ekzagjeruara dhe te pa argumentuara.
46. Neni 2 Qellimi i ligjit 162/2020 Per Prokurimin Publik, parashikohet shprehimisht se: “Qellim i

ketij ligji eshte: a) te rrise efiçencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik; b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik; dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik."

47. Neni 3, "Parime te pergjithshme" te ligjit Nr.162/2021 "Per prokurimin publik",i ndryshuar, parashikohet se:

"1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatoret ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore jane te detyruara te zbatojne detyrimet e percaktuara ne legjislacionin mjedisor, social e te punes dhe ne dispozitat e marreveshjeve dhe konventat nderkombetare, te ratifikuara ne perputhje me Kushtetuten."

48. Ne Nenin 21 "Autoriteti ose enti kontraktor" te ligjit 162/2021 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: "1. Autoriteti ose enti kontraktor eshte pergjegjes per prokurimin ne perputhje me dispozitat e ketij ligji dhe te akteve nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij, duke garantuar respektimin e parimeve te trajtimit te barabarte, transparences, konkurrences dhe mosdiskriminimit, te parashikuara ne kete ligj. Ne kuptim te kesaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin te



mireplanifikoje ne cilesi dhe ne kohe fondet publike e nevojat e tij dhe te prokuroje e te zbatoje kontraten ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.".

49. Akoma me tej, ne nje procedure te ngashme per nga volumi Komisioni i Prokurimeve Publike i cili merr vendime administrativisht perfundimtare, me ane te Vendimit Nr.454/2024, date 07.05.2024, ka arsyetuar se kerkesat per tonazhe ka te medha duhen hequr pasi kufizojne konkurrencen:

"III.2.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi kerkesen e autoritetit kontrakror qe mjeti i transportit te kete kapacitet mbajtes jo me te vogel se 1 ton, Komisioni i Prokurimit Publik veren se, referuar kritereve te veçanta te kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kerkuar nder te tjera se Operatori Ekonomik duhet te deklaroje ne formularin permbledhes te vetedeklarimit se disponon jo me pak se 1 (nje) mjet transporti me kapacitet mbajtes jo me te vogel se 1 ton. Komisioni pas shqyrtimit ne teresi te dokumentacionit te procedures se prokurimit objekt-ankimi, informacionit te dorezuar nga autoriteti kontraktor prane tij, si dhe Procesverbalit "Per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve per kualifikim" konstaton se ky i fundit, ne lidhje me piken 2.3.4 nuk ka dhene asnje argument se ku eshte bazuar ne percaktimin e tonazhit te mjetit te trasportit. Pervec kesaj pike, AK ka kerkuar ne piken 2.3.6 Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje deklarate nga administratori, me ane te se ciles merr persiper te kryeje sherbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen neper vende te te gjithe artikujve ne adresat e autorizuara nga AK ne planin e shperndarjes, bashkelidhur. Referuar kerkesave te sipercituara AK si pergjegjes per dokumentacionin e tenderit duhet te kete parasysh parimin e proporcionaliteti bazuar kjo ne rendesine e procedures se prokurimit, objektin e konrates, llojin e mallrave si edhe sasine, duke percaktuar kritere te thjeshtuara, sic eshte procedura objekt ankimi, per te lehtesuar punen e operatoreve ekonomike dhe rritur pjesmarrjen dhe konkurrencen. Akoma me tej, Komisioni thekson se eshte pergjegjesi e operatoreve ekonomike qe me nenshkrimin e kontrates te realizojne ate me mjete transporti ne kohen e duhur sipas afateve te percaktuara. Me nenshkrimin e kontrates operatori ekonomik eshte subjekti i pare i interesuar ta realizoje ate ne kohe. Persa referuar me siper, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet te rishikoje kriterin 2.3.4 duke modifikuar ate ne lidhje me tonazhin e mjetit te tansportit te mallrave."

50. Gjithashtu, ne nje procedure te ngashme per nga volumi Komisioni i Prokurimeve Publike i cili merr vendime administrativisht perfundimtare, me ane te Vendimit Nr.357/2024, date 08.04.2024, ka arsyetuar se kerkesat per tonazhe ka te medha duhen hequr pasi kufizojne konkurrencen:
“III3.6. Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit ne teresi te dokumentacionit te procedures se prokurimit objekt- ankimi, informacionit te dorezuar nga autoriteti kontraktor prane KPP, konstaton se ky i fundit, ne procesverbalin, “Per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve per kualifikim”, ne lidhje me piken 2.3.4 Argumentim: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, te VKM nr. 285, date 19.05.2021, “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane ne dispozicion apo qe mund t’i vihen ne dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike per te permbushur kontraten, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit. Referuar specifikimeve te administruara ne dosjen e procedures eshte percaktuar se perveç furnizimit te mallit objekt – prokurimi, do te kryhet transporti dhe vendosja e tyre prane venddorezimit te tyre ne destinacionin perkates, pra per kete arsye eshte e domosdoshme qe operatoret e mundshem ekonomike te paraqesin deshmi mbi pajisjet teknike qe kane ne dispozicion, per te permbushur kontraten objekt - prokurimi. Jane kerkuar dy kamione te pershtatshem per transport mallrash, per te vertetuar qe ofertuesit pjesemarres kane automjetet e nevojshme per transportin e mallrave, kapacitetet organizative, aftesite organizative per te zbatuar kontraten, reputacionin dhe besueshmerine, duke qene se kontrata eshte komplekse me shume artikuj, te cilat duhet te transportohen



dhe te behet furnizim vendosja e tyre sipas shkollave te percaktuara.. Perveç kesaj pike, AK ka kerkuar ne piken 2.3.5. Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me ane te se ciles merr persiper te kryeje sherbimin e transportit, prane Autoritetit Kontraktor. Referuar kerkesave sipercituara, AK si pergjegjes per dokumentacionin e tenderit, duhet te kete parasysh parimin e proporcionaliteti, bazuar kjo ne rendesine e procedures se prokurimit, objektin e konrates, llojin e mallrave, si edhe sasine, duke percaktuar kritere te thjeshtuara siç eshte procedura objekt - ankimi, per te lehtesuar punen e operatoreve ekonomike dhe rritur pjesemarrjen dhe konkurrencen. Akoma me tej, Komisioni thekson, se eshte pergjegjesi e operatoreve ekonomike, qe me nenshkrimin e kontrates, te realizojne proceduren me mjetet e transportit ne kohen e duhur sipas afateve te percaktuara. Me nenshkrimin e kontrates operatori ekonomik eshte subjekti i pare i interesuar ta realizoje ate ne kohe. Operatori ekonomik ne ankesen e tij, argumenton qarte pretendimet per modifikim te kriterit 2.3.4., si kriter diskriminues dhe pengues per operatoret ekonomike. Per sa referuar me siper, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet te rishikoje kriterin 2.3.4, dukee modifikuar ate ne lidhje me tonazhin e mjetit te tansportit te mallrave. Pretendimet e ankimuesit ne lidhje me kriterin 2.3.4 qendrojne.”
Nga sa me siper analizuam si edhe bazuar ne vendimin me te fundit te Komisionit te Prokurimeve Publike te referuar me siper, kerkojme modifikimin e kerkeses ne lidhje me tonazhin e mjeteve duke e ulur ate sipas nje plani te detajuar grafik.
III) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
51. 2.3.5 Operatori ekonomik pjesemarres, duhet te kete ne pronesi/qira ose ne perdorim te pakten 1 (nje) ambient per prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi
- Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

| Nr. | Vendodhja | Statusi |
|---|---|---|
| 1 | | Pronesi/qira/perdorim |

Ne rastin e paraqitjes te kontrates se qirase kontrata te jete e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertes deri ne realizimin e kontrates.

52. Ne neni 77, pika 1 dhe 4 "Kerkesat per kualifikim" te ligjit 162/2020 "Per Prokurimin Publik" parashikohet shprehimisht se: "Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne kerkesat per kualifikim per operatoret ekonomike bazuar ne:
a) pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale;
b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
c) aftesine teknike dhe profesionale.
Kerkesat kufizohen vetem ne ato qe jane te pershtatshme per te garantuar qe nje kandidat ose ofertues te kete kapacitetet juridike, financiare dhe aftesite teknike e profesionale per te zbatuar kontraten qe do te jepet. Te gjitha kerkesat duhet te kene lidhje dhe te jene proporcionale me objektin e kontrates.".
4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie.
Autoritetet ose entet kontraktore, ne veçanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontratat e zbatuara ne te shkuaren.

Aftesia profesionale e operatoreve ekonomike per te ofruar sherbimin, punen, mallin vleresohet ne lidhje me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem per te zbatuar kontraten, siç eshte pershkruar nga autoriteti ose enti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates.".
53. Kerkesa e me siperme eshte teresisht e panevojshme persa kohe operatoret ekonomik kane lejen e ushtrimit te aktivitetit dhe eksperiencen e duhur qe jep garanci per realizimin me sukses te kontrates. Autoriteti kontraktor nuk mund te kerkoje dokumentacion i cili ka sherbyer per leshimin e dokumentit final qe ka te beje me lejen e ushtrimit te aktivitetit.
54. Akoma me tej, Komisioni i Prokurimeve Publike i cili merr vendime administrativisht perfundimtare. Ne vendimin Nr.357/2024, date 08.04.2024, KPP ka arsyetuar se duhet hequr kerkesa per Ambient:
"III.2.5 Komisioni i Prokurimit Publik vlereso,n se kriteret per kualifikim vendosen qe t'I sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithçka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Autoriteti kontraktor eshte organi pergjegjes per prokurimin e fondeve publike, ne perputhje me dispozitat ligjore e nenligjore ne fuqi ndaj dhe percaktimi i kritereve te veçanta per kualifikim eshte lene nen pergjegjesine e autoritetit kontraktor, gjithnje ne perputhje e perpjesetim me objektin e natyren e kontrates se prokurimit.
Referuar kritereve te kualifikimit, konstatohet, se eshte kerkuar qe "Kerkesa e mesiperme eshte teresisht e panevojshme per sa kohe operatoret ekonomike kane lejen e ushtrimit te aktivitetit dhe eksperiencen e duhur qe jep garanci per realizimin me sukses te kontrates.
Autoriteti kontraktor nuk mund te kerkoje dokumentacion i cili ka sherbyer per leshimin e dokumentit final qe ka te beje me lejen e ushtrimit te aktivitetit. Per sa me siper, kerkojme heqjen e kesaj kerkese si e panevojshme dhe e paargumentuar.".
Sa me siper, referuar specifikimeve teknike, sasise dhe grafikut te levrimit te mallit, si dhe termave te references, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kerkesa e autoritetit kontraktor per nje 1 (nje) ambient, per prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt - prokurimi eshte nje kerkese e ekzagjeruar, jo ne perputhje me objektin dhe natyren e objektit te prokurimit, e cila kufizon pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne kete procedure prokurimi. Gjithashtu, autoriteti kontraktor, ka te drejte te kerkoje furnizime te pjesshme nga operatori ekonomik fitues, dhe eshte

detyre e ketij te fundit menaxhimi i kerkesave dhe permbushja ne kohe e tyre, akoma me tej plotesimi i ketij kriteri nuk eshte tregues mbi krijimin e besueshmerise nga ana e autoritetit kontraktor per operatoret ekonomike
pjesemarres, per permbushjen me sukses te kontrates.
Referuar DST dhe kritereve te percaktura nga ana e autoritetit kontraktor verejme se garancine per zbatimin me sukses te kontrates, autoriteti e siguron nepermjet kritereve te tjera te kualifikimit sikurse eshte "pervoja e meparshme e realizuar"..Per autoritetin kontraktor e rendesishme eshte qe operatori ekonomik te vertetoje, se gezon kapacitetet e nevojshme per realizimin e furnizimit dhe nuk mund te percaktoje kritere ne tejkalim te natyres dhe objektit te prokurimit. Sqarojme gjithashtu, se dokumentet e tenderit dhe kriteret per kualifikim, duhet te hartohen ne perputhje me LPP-ne dhe rregullat e prokurimit publik, ne menyre te tille qe te nxisin pjesemarrjen dhe konkurrencen e operatoreve ekonomike, te stimulojne pjesemarrjen e biznesit te vogel dhe te mesem, si dhe te sigurojne nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike pjesemarres ne keto procedura, per realizimin me sukses te kontrates, me qellim zgjerimin e rrethit te pjesemarrjes se operatoreve ekonomike, ne respect te ligjit dhe rregullave per prokurimin publik. Per kete arsye, autoriteti

kontraktor duhet te modifikoje kriterin, duke e hequr kete kerkese. Sa me siper, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qendron."
55. Persa me siper, kerkojme heqjen e kesaj kerkese si e pa nevojshme dhe e pa argumentuar.
IV) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
56. 2.3.7 Kerkohen te paraqiten kataloge teknike per te gjithe artikujt e ofertuar ku te jene te pasqyruara te gjitha specifikimet teknike te kerkuara per artikujt. Ne kataloge, duhet te shenohet sipas numrit te artikullit ne Formularin e Ofertes dhe te markohen me ngjyre te ndezur (te verdhe), artikujt e ofruar. (Katalogет duhet te ngarkohen ne www.app.gov.al se bashku me dokumentacionin e kerkuar ne keto DT. Pershkrimi teknik duhet te jete i perkthyer ne gjuhen shqipe).
57. SE PARI, nga verifikimi me kujdes i specifikimeve te Karriges rrotulluese drejtuesi me rregullim gjatesie, nuk konstatojme askund fjaline ose ekuivalent, thua se kjo karrige eshte e vetmja ne bote dhe nuk ka prodhues te tjere te karrigeve rrotulluese. Kerkojme ndryshimin e specifikimeve, duke vendosur ne specifikimet teknike fjalin ose ekuivalente.
58. 23. Karrige rrotulluese drejtuesi me rregullim gjatesie
Shtylla vertikale me sklet te perberenga pese kembe , ne forme ylli me pese rrpta rrotulluese ne forme sferike te pershtatura per dysheme me tapete
Zvvendosje pa shkalle te pjeses ku rri ulur , me suste per thellesine dhe mekanizem clodhes , susta perkuljes e rregullueshme sipas peshes se trupit.
Tapiceria e ndjenjeses dhe e mbeshteteses e mbushur me material mbushes sfugjer dhe veshur me cope stof , ngjyra sipas deshires se porositesit me bordura mbrojtese.
Krahet e karriges : Prej plastike , prodhim , furznizim dhe vendosje .
60. Neni 2 "Qellimi i ligjit" 162/2021 "Per prokurimin publik" parashikohet se: Qellim i ketij ligji eshte: a) te rrise efiçencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik; b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik; dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik.

61. Neni 3 Parime te pergjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatoret ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar

ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore jane te detyruara te zbatojne detyrimet e percaktuara ne legjislacionin mjedisor, social e te punes dhe ne dispozitat e marreveshjeve dhe konventat nderkombetare, te ratifikuara ne perputhje me Kushtetuten.

62. Neni 77 “Kerkesat per kualifikim”, te ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne kerkesat per kualifikim per operatoret ekonomike bazuar ne: a) pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftesine teknike dhe profesionale. Kerkesat kufizohen vetem ne ato qe jane te pershtatshme per te garantuar qe nje kandidat ose ofertues te kete kapacitetet juridike, financiare dhe aftesite teknike e profesionale per te zbatuar kontraten qe do te jepet. Te gjitha kerkesat duhet te kene lidhje dhe te jene proporcionale me objektin e kontrates. 4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie”.

63. Ne nenin 40 pika 1, 2 dhe 6 te VKM Nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimmisht se: “1. Ne procedurat e prokurimit per mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasine e mallrave qe do te levroje, si dhe grafikun e levrimit te mallrave. 2. Per mallrat qe do te prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojne specifikimet teknike, te cilat duhet te pershkruajne minimumin ose teresine e elementeve me te rendesishme perberese, qe garantojne cilesine e kerkuar, ne perputhje me nenin 36, te LPPse, dhe qe i vlereson mallrat si te pranueshme per funksionet e kerkuara. 3. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kerkoje operatoreve ekonomike te dorezojne deshmi, qe tregojne se ata i plotesojne kerkesat minimale, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si: a) mostra te mallit, kur e gjykon se kjo ka rendesi per vleresimin e ofertes teknike. N? k?t? rast, autoriteti/enti kontraktor duhet t? argumentoj? k?rkes?n p?r mostrat. Mostrat duhet te trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet te jene ne kontroll te autoritetit/entit kontraktor. N? rastin e procedurave t? zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor p?rcakton qart? procedur?n p?r dor?zimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori t? interesuar si dhe konfidencialitetin p?r pjes?marrjen n? proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesen e tij, brenda 30 (tridhjete) diteve pas nenshkrimit te kontrates, me kusht qe kontrata ne fjale te mos jete objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqesor. Ne rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesen e tij, brenda 30 (tridhjete) diteve nga data e marrjes se vendimit perfundimtar te anulimit; dhe/ose b) fotografite apo katalogshet teknike; dhe/ose c) deshmi per rezultatet e testimeve zyrtare, te leshuara nga institucione te autorizuara, qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike.”

64. Ne nenin 36 “Specifikimet teknike” te ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “1. Specifikimet teknike, siç percaktohen ne nenin 4 te ketij ligji, duhet te pershkruhen ne dokumentet e tenderit. Ne specifikimet teknike percaktohen qarte karakteristikat e puneve, sherbimit ose furnizimit qe do te prokurohet. Keto karakteristika mund te lidhen edhe me procesin specifik ose metoden e prodhimit ose ofrimit te puneve, furnizimeve ose sherbimeve te kerkuara ose me nje proces specifik per nje faze tjeter te ciklit jetesor edhe kur keta faktore nuk perbejne permbajtjen e saj thelbesore nese ato jane te lidhura me objektin e kontrates dhe proporcionale me vleren dhe objektivat e saj. Ne specifikimet teknike mund te specifikohet edhe nese do te jete i nevojshem transferimi i te drejtave te pronesise intelektuale. Specifikimet teknike, me perjashtim te rasteve te justifikuara plotesisht, hartohen



ne menyre te tille qe te marrin ne konsiderate kriteret e aksesueshmerise per personat me aftesi te kufizuar ose projektimit per te gjithe perdoruesit, sipas kerkesave ne legjislacionin ne fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet te mundesojne trajtim te barabarte per te gjithe kandidatet dhe ofertuesit dhe te mos sherbejne si pengesa per konkurrencen e hapur ne prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet te pershkruajne qarte kerkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu

referuar: a) kerkesave funksionale ose te performances, perfshire karakteristikat mjedisore, me kusht qe parametrat te jene te sakte ne menyre qe t'u japin mundesi ofertuesve te percaktojne objektin e kontrates dhe autoriteteve ose enteve kontraktore te japin kontraten; b) standardeve kombetare, qe mbeshteten ne ato nderkombetare, miratimeve teknike nderkombetare, specifikimeve teknike te pergjithshme, standardeve nderkombetare apo sistemeve te tjera teknike te referimit, te percaktuara nga organet nderkombetare te standardizimit. Kur keto nuk ekzistojne, ato u referohen standardeve kombetare, miratimeve teknike kombetare ose specifikimeve teknike kombetare, qe lidhen me projektimin, perllogaritjen dhe ekzekutimin e puneve ose perdorimin e produkteve; c) kerkesave ne terma funksionale sipas shkronjes "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjes "b" te kesaj pike, si menyre qe nenkupton pajtueshmeri me kerkesat funksionale; ç) te dyja metodave te percaktuara ne shkronjat "a" dhe "b" te pikes 3 te ketij neni, per mallra, sherbime ose pune te ndryshme, te perfshira ne te njejtin objekt kontrate. Çdo reference duhet te shoqerohet nga fjalet "ose ekuivalenti i tij/saj". 4. Ne specifikimet teknike, nese nuk e justifikon objekti i kontrates, nuk duhet te permendet asnje marke prodhimi ose burim specifik apo proces i veçante, qe karakterizon produktet ose sherbimet e ofruara nga nje operator ekonomik specifik apo asnje marke tregtare, patente, tipi ose origjine apo prodhim specifik, me qellim favorizimin ose eliminimin e disa

65. Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit ekonomik per permbushje me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj, autoriteti kontraktor percakton kerkesat e veçanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit. Operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumente duhet te refuzohen si te papranueshme. Gjithashtu, nje nder parimet kryesore te zhvillimit te procedures se prokurimit eshte ai barazise ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Per prokurimin publik". Zbatimi i parimit te transparences, barazise dhe mosdiskriminimit, jane garancite kyçe ndaj ofertuesve qe ofron kuadri ligjor ne fuqi. Keto parime nder te tjera nenkuptojne, se operatoret ekonomike duhet te jene ne nje pozicion barazie, si kur pergatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur te vleresohen ato. Operatoret ekonomike pjesemarres ne proceduren e prokurimit, me dokumentacionin e dorezuar, duhet te vertetojne, qe produkti i ofruar eshte ne perputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kerkuara nga autoriteti kontraktor. Operatoret ekonomike ofertues marrin persiper permbushjen e specifikimeve teknike/kritereve te percaktuara ne dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nepermjet deklaratave dhe dokumentacionit provues ne te cilin duhet te faktojne perputhshmerine e dokumentacionit me kriteret e percaktuara nga autoriteti kontraktor, ne menyre qe nga ana e ketij te fundit te mund te kryhet me lehtesi e saktesi vleresimi i mallrave apo sherbimeve te ofertuara nga operatoret ekonomike pjesemarres, duke perzgjedhur ate ofertues i cili me dokumentacionin e dorezuar garanton perputhshmerine me kriteret e percaktuara ne DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses te kontrates objekt-prokurimi.

66. Vlen te theksojme se, ne respekt te parimeve te ligjit per prokurimin publik, specifikimet teknike te hartuara nga autoriteti kontraktor, ne asnje rast nuk duhet te diskriminojne /perjashtojne nga konkurrimi operatoret ekonomike ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin keta kombetar apo nderkombetare. Ne hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet te shmangin çdo forme diskriminimi, qofte ato te dukshme, qofte ato te fshehta, te cilat kane



te njejtin efekt. Ne asnje rast, specifikimet teknike nuk duhet te hartohen ne menyre qe te drejtojne drejt nje produkti/malli/sherbimi, qe ofrohen nga nje operator i vetem ekonomik ose nga nje prodhues i vetem.

67. Modifikimi eshte shume i domosdoshem, pasi sic do te shohim me poshte ka shume llojesh karrigesh zyrash drejtuesi, te prodhuara sigurisht nga prodhues te tjere, te cilet nuk duhet te

perjashtohen nga e drejta per te ofertuar me to:
68. Nga sa me siper, del qarte se karriget e drejtuesve prodhohen ne disa lloje, perfshi ketu edhe ato me kembe jo plastike por me metalike, krahet e karriges prej metali me mbeshtetese sfungjeri, me kembe druri, me krahet e karriges prej druri, etj etje dhe kjo nuk mund dhe nuk duhet te perjashtoj nga konkurrimi nje game shume here me te madhe se karriget qe kemi sjelle per shembush.
69. Theksojme se nga kerkimet qe beme ne, rezulton se Karrigja e kerkuar nga autoriteti kontraktor e ka nje shites dhe rrjedhimisht nje prodhues i caktuar, cka eshte teresisht ne shkelje te hapur te dispozitave ligjore te referuar me siper. Konkretisht, linku https://www.techly.com/easy-office-chair-red.html te njerre direkt ne Karrigen e kerkuar nga autoriteti kontraktor ne Specifikimet Teknike:

70. Akoma me tej, po ne linkun perkates ne Rubriken “Data sheet” del edhe emri i prodhuesit te kesaj karrige cili eshte TECHLY:

TECHLY - PROPERTY OF IC INTRACOM ITALIA S.P.A. TAX CODE 09228790151 R.E.A. 47752 - VAT ID IT01191370939 FULLY PAID SHARE CAPITAL 150.000,00 EURO IC INTRACOM ITALIA SPA 2016 ? ALL RIGHTS RESERVED
TECHLY- PRONA E IC INTRACOM ITALIA S.P.A. KODI TATIMOR 09228790151 R.E.A. 47752 - ID e TVSH-se IT01191370939
KAPITALI AKSIONAL I PAGUAR PLOTESISHT 150.000,00 EURO IC INTRACOM ITALIA SPA 2016 ? TE GJITHA TE DREJTAT E REZERVUARA
71. Nga sa me siper analizuar, kerkojme ndryshimin e specifikimeve teknike duke vendosur fjalen ose ekuivalent, si ne vijim:
Shtylla vertikale me sklet te perberenga pese kembe , ne forme ylli me pese rrpta rrotulluese ne forme sferike te pershtatura per dysheme me tapete OSE EKUIVALENTE
Zvvendosje pa shkalle te pjeses ku rri ulur , me suste per thellesine dhe mekanizem clodhes , susta perkuljes e rregullueshme sipas peshes se trupit. OSE EKUIVALENTE
Tapiceria e ndjenjeses dhe e mbeshteteses e mbushur me material mbushes sfugjer dhe veshur me cope stof , ngjyra sipas deshires se porositesit me bordura mbrojtese. OSE EKUIVALENTE
Krahet e karriges : Prej plastike , prodhim , furznizim dhe vendosje OSE EKUIVALENTE.
V) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
72. 2.3.8 Ofertuesi duhet te paraqese:
Certifikate ISO 9001:2015 ose ekuivalente, ”Per Sistemin e menaxhimit te cilesise”,
(Certifikata te jete leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, per tregtim dhe/ose prodhim te mobiljeve, per artikujt e mobilimit te ofertuara.)
Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Certifikate ISO 9001:2015 ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
73. Argumentimi: Kerkesa e mesiperme bazohet ne nenin 77, pika 1/a dhe 2, nenin 79 te LPP, nenit 40, pika 8, dhe 44, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.
Legjislacioni ne fuqi per prokurimin publik i jep mundesine autoriteteve kontraktore qe te kerkojne certifikime nga organe te pavarura te njohura nga sistemet e standardizimit kombetar

ose nderkombetar, ne menyre qe te vertetojne se mallrat objekt prokurimi dhe sherbimet lidhur me to, i plotesojne kerkesat e cilesise.
Autoriteti kontraktor, duke qene se eshte perfituesi direkt i kontrates objekt prokurimi, eshte ne te drejten e tij te garantohet se operatoret ekonomike pjesemarres i plotesojne kerkesat e cilesise per furnizimin qe do te kryhejne, e rrjedhimisht eshte e drejte e ketij te fundit t’u kerkoje ofertuesve te

paraqesin certifikata te leshuara nga organe te pavarura te njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombetar ose Nderkombetar, referuar nenit 79 te ligjit 162/2020.
Qe te realizohet me cilesi dhe konform standarteve procedura, objekt prokurimi, operatori duhet te jete i çertifikuar me çertifikaten ISO te menaxhimit si me siper, te cilat ne rastin konkret vleresohen te nevojshme persa i perket cilesise dhe sigurise, pasi deshmon se sistemi i administrimit te operatorit ekonomik te çertifikuar i pergjigjet asaj qe kerkohet nga Autoriteti Kontraktor. Pra konsiderohet si kriter i lidhur ngushtesisht me objektin e kontrates qe prokurohet dhe i bazuar ne LPP.
74. Ne nenin 44 i VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, nuk permend me asnje vend qe operatoret ekonomik duhet te ngarkohen me barre qe te detyrojne prodhuesin qe t'iu veri ne dispozicion Certifikatat ISO. Theksojme se Prodhuesi eshte person juridik i trete, qe nuk eshte pjestare ne gare, per pasoje autoriteti kontraktor nuk mund te detyroje operatoret ekonomik qe duan te marrin pjese ne gare te paraqesin ISO te Prodhuesit.
75. Ne nenin “Kerkesat e cilesise” te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, theksohet se:
“1. Autoriteti/enti kontraktor, per te vertetuar se punet, mallrat ose sherbimet, objekt prokurimi, i plotesojne kerkesat e cilesise, mund t'u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise, vetem nese ato jane te argumentuara dhe te lidhura ngushtesisht dhe ne menyre te drejtperdrejte me objektin e prokurimit.
2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se.
Kjo dispozite zbatohet edhe kur kerkesat teknike u referohen kualifikimeve te kandidatit ose te ofertuesit.
3. Certifikatat dhe etiketat e kerkuara duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me objektin e kontrates, si dhe çdo operator ekonomik duhet t? ket? akses n? to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.
4. N?se autoriteti/enti kontraktor k?rkojn? nj? certifikat?, ose etiket?, ata jan? t? detyruar t? pranojn? çdo certifikat? ose etiket? ekuivalente/ t? barasvlershme me t?, ose nj? dokument q? provon t? nj?jtin informacion.
5. Kur eshte e dukshme qe nje operator ekonomik e ka te pamundur te marre etiketen specifike, te cilesuar nga autoriteti/enti kontraktor ose nje etikete ekuivalente, brenda afateve kohore perkatese, per shkaqe qe nuk lidhen me ate operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon menyra te tjera vertetimi te pershtatshme, qe mund te perfshijne nje dosje teknike nga prodhuesi, nese operatori

ekonomik ne fjale verteton se punet, furnizimet ose sherbimet qe ai duhet te ofrojne permbushin kerkesat e etiketes specifike ose kerkesat specifike te cilesuara nga autoriteti/enti kontraktor.”
76. Pra, kerkesa per ISO, duhet te kufizohet vetem te operatoret ekonomik. Nga ana tjeter, dispozita ligjore e referuar me siper, thekson qarte se ofertuesit duhet te kene akses ne certifikatat e kerkuara sic eshte rasti i ISO se Prodhuesit, duke respektuar keshtu parimin e mosdiskriminimit. Pra, autoriteti kontraktor mund te detyroje operatoret ekonomik te paraqesin certifikimet e tyre per te cilat kane akses, por kurrsesi nuk mund te kerkoje certifikatat e prodhuesve te cilet ndoshta nuk certifikohen fare apo ndoshta nuk deshirojne te japin certifikatat Iso te bleresit.
Per sa analizuam me siper, kerkojme heqjen e kerkeses qe detyron operatoret ekonomik te paraqesin Certifikatat ISO te Prodhuesit.
VI) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:

77. Certifikate ISO 14001:2015 “Sistemi i menaxhimit te mjedisit” ose ekuivalente.
(Certifikata te jete leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, per tregtim dhe/ose prodhim te mobiljeve, per artikujt e mobilimit te ofertuara.)
Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Certifikate ISO 14001:2015 ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata te jete brenda afatit te vlefshmerise, ne gjuhen shqipe ose te perkthyera dhe te noterizuara.
78. SE PARI, ne nenin 44 i VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, nuk permend askund Certifikata per Menaxhim Mjedisi. Ne kete dispozite eshte specifikuar shume qarte se autoriteti kontraktor mund te kerkoje per Mallrat dhe Sherbimet, Certifikata te Cilsise.
79. Ne nenin 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, theksohet se:
“1. Autoriteti/enti kontraktor, per te vertetuar se punet, mallrat ose sherbimet, objekt prokurimi, i plotesojne kerkesat e cilesise, mund t’u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise, vetem nese ato jane te argumentuara dhe te lidhura ngushtesisht dhe ne menyre te drejtperdrejte me objektin e prokurimit.
2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se.
Kjo dispozite zbatohet edhe kur kerkesat teknike u referohen kualifikimeve te kandidatit ose te ofertuesit.
3. Certifikatat dhe etiketat e kerkuara duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me objektin e kontrates, si dhe çdo operator ekonomik duhet t? ket? akses n? to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

4. N?se autoriteti/enti kontraktor k?rkojn? nj? certifikat?, ose etiket?, ata jan? t? detyruar t? pranojn? çdo certifikat? ose etiket? ekuivalente/ t? barasvlershme me t?, ose nj? dokument q? provon t? nj?jtin informacion.
5. Kur eshte e dukshme qe nje operator ekonomik e ka te pamundur te marre etiketen specifike, te cilesuar nga autoriteti/enti kontraktor ose nje etikete ekuivalente, brenda afateve kohore perkatese, per shkaqe qe nuk lidhen me ate operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon menyra te tjera vertetimi te pershtatshme, qe mund te perfshijne nje dosje teknike nga prodhuesi, nese operatori ekonomik ne fjale verteton se punet, furnizimet ose sherbimet qe ai duhet te ofrojne permbushin kerkesat e etiketes specifike ose kerkesat specifike te cilesuara nga autoriteti/enti kontraktor.”
80. Nderkohe, ne piken 2 te Nenit 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, ligjvenesi ka lene nje hapsire per autoritetin kontraktor qe te kerkoje etiketa, kur prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera:
“2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se.”

81. Pra, ligjvenesi nuk i ka lene dore te lire autoritetit kontraktor me qellim qe te shmangi kerkesat abuzive dhe aspak te argumentuara sic eshte kerkesa per ISO 14001:2015 “Sistemi i menaxhimit te mjedisit”. Autoriteti kontraktor nuk po prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, perndryshe ne do ta kuptonim kerkesen. Ne procedure objekt ankese nuk ka asnje mall apo sherbim te cilat paskerkan karakteristika specifike Mjedisore.
82. Referuar Argumentimit te Kritereve te Kualifikimit, rezulton qartesisht se autoriteti nuk ka arritur dot ta mbeshtese ne ligj kerkesen dhe nuk ka arritur te argumentoje se perse kerkon nje ISO te tille. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka theksuar se:
Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky kriter eshte i lidhur ngushte me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale dhe respektimin e rregullave te mbrojtjes dhe sigurise ne pune nga OE pjesemarres.
Kriteri vendoset per rastin kur OE eshte prodhues vendor, si nje kerkese e shtuar per garantimin e zbatimit te kontrates ne cilesine dhe ne afatin e kerkuar nga AK.
Certifikatat per menaxhimin e sistemit te sigurise ne pune dhe menaxhimin e mjedisit nga keto OE, kane lidhje me kerkesat per zbatimin e standarteve, dhe jane vendosur ne perputhje me rekomandimin e APP nr. 3341/1 date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kritereve per kualifikim ne DT te procedurave te prokurimit”.

83. Referuar dispozitave ligjore ku eshte bazuar autoriteti kontraktor per hartimin e kriterit kualifikues, del qarte se asnje dispozite prej tyre nuk i jep te drejte autoritetit qe te kerkoje Certifikat ISO.
84. Nga ana tjeter, si baze ligjore ne vendosjen e kerkeses per ISO, autoriteti i referohet rekomandimit te APP nr. 3341/1 date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kritereve per kualifikim ne DT te procedurave te prokurimit”., ne te cilin ne asnje pike nuk i rekomandon autoritetet kontraktore qe te “Cmenden” dhe te kerkojne cfardo ISO qe egziston ne planet, por perkundrazi i orienton ata per procedurat e prokurimit per Punet Publike si dhe i’u kerkon autoriteteve qe te mos kerkojne certifikata ISO te cilat nuk jane te lidhura me objektin qe prokurojne duke respektuar parimin e mosdiskriminimit.
85. Persa analizuam me siper, del qarte se kerkesa e autoritetit kontraktor per Certifikaten ISO 14001:2015 “Sistemi i menaxhimit te mjedisit”., nuk lidhet aspak me objektin e kontrates dhe procedures se prokurimit, nuk eshte aspak e argumentuar, per pasoje kerkojme heqjen e ketij kriteri. Per me teper, qe operatoret jane te pajisur me leje mjedisi nga Ministria e linjes.
86. SE DYTI, ne ne lidhje me kerkesen “Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Certifikate ISO 14001:2015 ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata te jete brenda afatit te vlefshmerise, ne gjuhen shqipe ose te perkthyera dhe te noterizuara”., vlen argumenti i dhene me siper keshtu nuk do te bjeme perseritje.
Persa me siper, kerkojme heqjen e kerkeses qe detyron operatoret ekonomik te paraqesin Certifikatat ISO te Prodhuesit.
VII) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
87. Ofertuesi duhet te paraqese Çertifikate ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit te sigurise dhe shendetit ne pune” ose ekuivalente.
Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Çertifikate ISO 45001:2018 ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
88. SE PARI, ne nenin 44 i VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, nuk permend askund Certifikata per Menaxhim te Sigurise dhe shendetit ne Pune. Per me

teper, qe ne nuk jemi shoqeri ndertimi pra nuk ofrojme pune por mall dhe sherbim. Pavaresisht kesaj, ne dispoziten ligjore te referuar me siper, eshte specifikuar qarte se autoriteti kontraktor mund te kerkoje per Mallrat dhe Sherbimet, Certifikata te Cilsise.
89. Ne nenin 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, theksohet se:

“1. Autoriteti/enti kontraktor, per te vertetuar se punet, mallrat ose sherbimet, objekt prokurimi, i plotesojne kerkesat e cilesise, mund t’u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise, vetem nese ato jane te argumentuara dhe te lidhura ngushtesisht dhe ne menyre te drejtperdrejte me objektin e prokurimit.
2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se.
Kjo dispozite zbatohet edhe kur kerkesat teknike u referohen kualifikimeve te kandidatit ose te ofertuesit.
3. Certifikatat dhe etiketat e kerkuara duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me objektin e kontrates, si dhe çdo operator ekonomik duhet t? ket? akses n? to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.
4. N?se autoriteti/enti kontraktor k?rkojn? nj? certifikat?, ose etiket?, ata jan? t? detyruar t? pranojn? çdo certifikat? ose etiket? ekuivalente/ t? barasvlershme me t?, ose nj? dokument q? provon t? nj?jtin informacion.
5. Kur eshte e dukshme qe nje operator ekonomik e ka te pamundur te marre etiketen specifike, te cilesuar nga autoriteti/enti kontraktor ose nje etikete ekuivalente, brenda afateve kohore perkatese, per shkaqe qe nuk lidhen me ate operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon menyra te tjera vertetimi te pershtatshme, qe mund te perfshijne nje dosje teknike nga prodhuesi, nese operatori ekonomik ne fjale verteton se punet, furnizimet ose sherbimet qe ai duhet te ofrojne permbushin kerkesat e etiketes specifike ose kerkesat specifike te cilesuara nga autoriteti/enti kontraktor.”
90. Nderkohe, ne piken 2 te Nenit 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, ligjvenesi ka lene nje hapsire per autoritetin kontraktor qe te kerkoje etiketa, kur prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera:
“2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se.”
91. Pra, ligjvenesi nuk i ka lene dore te lire autoritetit kontraktor me qellim qe te shmangi kerkesat abuzive dhe aspak te argumentuara sic eshte kerkesa per ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit te sigurise dhe shendetit ne pune”. Autoriteti kontraktor nuk po prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike te sigurise dhe shendetit ne pune, perndryshe ne do ta kuptonim kerkesen. Ne procedure objekt ankese nuk ka asnje mall apo sherbim te cilat karakteristika specifike te sigurise dhe shendetit ne pune.

92. Referuar Argumentimit te Kritereve te Kualifikimit, rezulton qartesisht se autoriteti nuk ka arritur dot ta mbeshtese ne ligj kerkesen dhe nuk ka arritur te argumentoje se perse kerkon nje ISO te tille. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka theksuar se:

Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky kriter eshte i lidhur ngushte me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale dhe respektimin e rregullave te mbrojtjes dhe sigurise ne pune nga OE pjesemarres.
Kriteri vendoset per rastin kur OE eshte prodhues vendor, si nje kerkese e shtuar per garantimin e zbatimit te kontrates ne cilesine dhe ne afatin e kerkuar nga AK.
Certifikatat per menaxhimin e sistemit te sigurise ne pune dhe menaxhimin e mjedisit nga keto OE, kane lidhje me kerkesat per zbatimin e standarteve, dhe jane vendosur ne perputhje me rekomandimin e APP nr. 3341/1 date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kritereve per kualifikim ne DT te procedurave te prokurimit”.
93. Referuar dispozitave ligjore ku eshte bazuar autoriteti kontraktor per hartimin e kriterit kualifikues, del qarte se asnje prej tyre nuk i jep te drejte autoritetit qe te kerkoje Certifikat ISO.
94. Nga ana tjeter, si baze ligjore ne vendosjen e kerkeses per ISO, autoriteti i referohet rekomandimit te APP nr. 3341/1 date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kritereve per kualifikim ne DT te procedurave te prokurimit”., ne te cilin ne asnje pike nuk i rekomandon autoritetet kontraktore qe te “Cmenden” dhe te kerkojne cfardo ISO qe ekziston, por perkundrazi i orienton ata per procedurat e prokurimit per Punet Publike si dhe i’u kerkon autoriteteve qe te mos kerkojne certifikata ISO te cilat nuk jane te lidhura me objektin qe prokurojne duke respektuar parimin e mosdiskriminimit.
95. Persa analizuam me siper, del qarte se kerkesa e autoritetit kontraktor per Certifikaten ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit te sigurise dhe shendetit ne pune”., nuk lidhet aspak me objektin e kontrates dhe procedures se prokurimit, nuk eshte aspak e argumentuar, per pasoje kerkojme heqjen e ketij kriteri.
96. SE DYTI, ne ne lidhje me kerkesen Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Certifikate ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit te sigurise dhe shendetit ne pune”ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata te jete brenda afatit te vlefshmerise, ne gjuhen shqipe ose te perkthyera dhe te noterizuara., vlene argumenti i dhene me siper keshtu nuk do te bjeme perseritje.
Persa me siper, kerkojme heqjen e kerkeses qe detyron operatoret ekonomik te paraqesin Certifikatat ISO te Prodhuesit.

VIII) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
97. Ofertuesi duhet te paraqese Çertifikate sipas standartit EN ISO 28001 - 2007 per “zinxhirin e furnizimit” ose ekuivalente.
Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Çertifikate sipas standartit EN ISO 28001 - 2007 ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
98. Certifikata sipas standartit EN ISO 28001 – 2007, eshte referuar si sistemi i menaxhimit te sigurise se zinxhirit te furnizimit dhe ne shume sektore te zinxhirit te furnizimit mund te thyejne ose natyren ne problemet e sigurise publike ndikojne negativisht ne organizimin e tyre. Rreziqe te tilla duhet te identifikohen ne zinxhirin e furnizimit per organizatat dhe t'i menaxhojne keto rreziqe ne menyre efikase ne nje diagnoze te madhe te sakte.
ISO 28001:2007 Sistemi i Menaxhimit te Sigurise se Zinxhirit te Furnizimit eshte nje standard nderkombetar, ISO 28001 percakton kerkesat e sistemit te menaxhimit te sigurise se zinxhirit te furnizimit
99. SE PARI, ne nenin 44 i VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, nuk permend askund Certifikata te tilla. Per me teper, qe kjo ISO ka tebeje me Sigurine e

Furnizimit qe nuk ka asnje pike lidhje me shoqerite e Mobiljeve. Pavaresisht kesaj, ne dispoziten ligjore te referuar me siper, eshte specifikuar qarte se autoriteti kontraktor mund te kerkoje per Mallrat dhe Sherbimet, Certifikata te Cilsise dhe cdo certifikat te mundshme qe ka pare ne enderr personi qe ka hartuar keto kritee apo subjekti qe ia ka ofruar keto lloj kriteresh te cilat e bejne te pa mundur pjesmarrjen ne gare lirisht sikunder marrim pjese ne autoritete te tjera.
100. Ne nenin 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, theksohet se:
“1. Autoriteti/enti kontraktor, per te vertetuar se punet, mallrat ose sherbimet, objekt prokurimi, i plotesojne kerkesat e cilesise, mund t’u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise, vetem nese ato jane te argumentuara dhe te lidhura ngushtesisht dhe ne menyre te drejtperdrejte me objektin e prokurimit.
2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se.
Kjo dispozite zbatohet edhe kur kerkesat teknike u referohen kualifikimeve te kandidatit ose te ofertuesit.

3. Certifikatat dhe etiketat e kerkuara duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me objektin e kontrates, si dhe çdo operator ekonomik duhet t? ket? akses n? to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.
4. N?se autoriteti/enti kontraktor k?rkojn? nj? certifikat?, ose etiket?, ata jan? t? detyruar t? pranojn? çdo certifikat? ose etiket? ekuivalente/ t? barasvlershme me t?, ose nj? dokument q? provon t? nj?jtin informacion.
5. Kur eshte e dukshme qe nje operator ekonomik e ka te pamundur te marre etiketen specifike, te cilesuar nga autoriteti/enti kontraktor ose nje etikete ekuivalente, brenda afateve kohore perkatese, per shkaqe qe nuk lidhen me ate operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon menyra te tjera vertetimi te pershtatshme, qe mund te perfshijne nje dosje teknike nga prodhuesi, nese operatori ekonomik ne fjale verteton se punet, furnizimet ose sherbimet qe ai duhet te ofrojne permbushin kerkesat e etiketes specifike ose kerkesat specifike te cilesuara nga autoriteti/enti kontraktor.”
101. Nderkohe, ne piken 2 te Nenit 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, ligjvenesi ka lene nje hapsire per autoritetin kontraktor qe te kerkoje etiketa, kur prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera:
“2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se.”
102. Pra, ligjvenesi nuk i ka lene dore te lire autoritetit kontraktor me qellim qe te shmangi kerkesat abuzive dhe aspak te argumentuara sic eshte kerkesa e kualifikimit per EN ISO 28001 - 2007 per “Sistemet e menaxhimit te sigurise per zinxhirin e furnizimit - Praktikat me te mira per zbatimin e sigurise se zinxhirit te furnizimit, vleresimet dhe planet - Kerkesat dhe udhezimet”. Autoriteti kontraktor nuk po prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike te Sistemet e menaxhimit te sigurise per zinxhirin e furnizimit - Praktikat me te mira per zbatimin e sigurise se zinxhirit te furnizimit, vleresimet dhe planet - Kerkesat dhe udhezimet, perndryshe ne do ta kuptonim kerkesen. Ne proceduren objekt ankese nuk ka asnje mall apo sherbim te cilat

karakteristika specifike te Sistemet e menaxhimit te sigurise per zinxhirin e furnizimit - Praktikat me te mira per zbatimin e sigurise se zinxhirit te furnizimit, vleresimet dhe planet - Kerkesat dhe udhezimet.
103. Referuar Argumentimit te Kritereve te Kualifikimit, rezulton qartesisht se autoriteti nuk ka arritur dot ta mbeshtese ne ligj kerkesen dhe nuk ka arritur te argumentoje se perse kerkon nje ISO te tille. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka theksuar se:
Argumentim: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Ky kriter eshte i lidhur ngushte me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale dhe respektimin e rregullave te mbrojtjes dhe sigurise ne pune nga OE pjesemarres.

104. Referuar dispozitave ligjore ku eshte bazuar autoriteti kontraktor per hartimin e kriterit kualifikues, del qarte se asnje prej tyre nuk i jep te drejte autoritetit qe te kerkoje Certifikat ISO.
105. Persa analizuam me siper, del qarte se kerkesa e autoritetit kontraktor per Certifikaten EN ISO 28001 - 2007 per "Sistemet e menaxhimit te sigurise per zinxhirin e furnizimit - Praktikat me te mira per zbatimin e sigurise se zinxhirit te furnizimit, vleresimet dhe planet - Kerkesat dhe udhezimet", nuk lidhet aspak me objektin e kontrates dhe procedures se prokurimit, nuk eshte aspak e argumentuar, per pasoje kerkojme heqjen e ketij kriteri.
106. SE DYTI, ne ne lidhje me kerkesen "Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Çertifikate sipas standartit EN ISO 28001 - 2007 ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise", vlene argumenti i dhene me siper keshtu nuk do te bjeme perseritje.
Persa me siper, kerkojme heqjen e kerkeses qe detyron operatoret ekonomik te paraqesin Certifikatat ISO te Prodhuesit.
IX) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
107. Ofertuesi duhet te paraqese Çertifikate ISO 22301-2012 (e vlefshme) per "Sistemit te Menaxhimit te Vazhdimesise se Biznesit"ose ekuivalente.
Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Çertifikate ISO 22301-2012(e vlefshme) ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
108. SE PARI, ne nenin 44 i VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", nuk permend askund Certifikata te tilla. Per me teper, qe kjo ISO ka te beje me "Siguria shoqerore - Sistemet e menaxhimit te vazhdimesise se biznesit – Kerkesat" qe nuk ka asnje pike lidhje me shoqerite ne Shqiperi te cilat jane rregulluar nga nje kuader ligjor perkates. Pavaresisht kesaj, ne dispoziten ligjore te referuar me siper, eshte specifikuar qarte se autoriteti kontraktor mund te kerkoje per Mallrat dhe Sherbimet, Certifikata te Cilsise dhe cdo certifikat te mundshme qe ja ka futur kot personi qe ka hartuar keto kritere apo subjekti qe ia ka ofruar keto lloj kriteresh te cilat e bejne te pa mundur pjesmarrjen ne gare lirisht sikunder marrim pjese ne autoritete te tjera. Kerkojme nga KPP qe te pergatise nje medalje per kete person dhe ta dergoje prane APP-se qe tia dorezojne vete me doren e tyre, madje ti japin edhe nje bonus pasi eshte lodhur, ka vrare mendjen per te gjetur certifikatat ISO qe ekzistojne ne bote.
109. Ne nenin 44 "Kerkesat e cilesise" te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", theksohet se:
"1. Autoriteti/enti kontraktor, per te vertetuar se punet, mallrat ose sherbimet, objekt prokurimi, i plotesojne kerkesat e cilesise, mund t'u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga nje

organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise, vetem nese ato jane te argumentuara dhe te lidhura ngushtesisht dhe ne menyre te drejtperdrejte me objektin e prokurimit.
2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se.
Kjo dispozite zbatohet edhe kur kerkesat teknike u referohen kualifikimeve te kandidatit ose te ofertuesit.
3. Certifikatat dhe etiketat e kerkuara duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me objektin e kontrates, si dhe çdo operator ekonomik duhet t? ket? akses n? to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.
4. N?se autoriteti/enti kontraktor k?rkojn? nj? certifikat?, ose etiket?, ata jan? t? detyruar t? pranojn? çdo certifikat? ose etiket? ekuivalente/ t? barasvlershme me t?, ose nj? dokument q? provon t? nj?jtin informacion.
5. Kur eshte e dukshme qe nje operator ekonomik e ka te pamundur te marre etiketen specifike, te cilesuar nga autoriteti/enti kontraktor ose nje etikete ekuivalente, brenda afateve kohore perkatese, per shkaqe qe nuk lidhen me ate operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon menyra te tjera vertetimi te pershtatshme, qe mund te perfshijne nje dosje teknike nga prodhuesi, nese operatori ekonomik ne fjale verteton se punet, furnizimet ose sherbimet qe ai duhet te ofrojne permbushin kerkesat e etiketes specifike ose kerkesat specifike te cilesuara nga autoriteti/enti kontraktor."
110. Nderkohe, ne piken 2 te Nenit 44 "Kerkesat e cilesise" te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", ligjvenesi ka lene nje hapsire per autoritetin kontraktor qe te kerkoje etiketa, kur prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera:
"2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se."
111. Pra, ligjvenesi nuk i ka lene dore te lire autoritetit kontraktor me qellim qe te shmangi kerkesat abuzive dhe aspak te argumentuara sic eshte kerkesa e kualifikimit ne fjale "Siguria shoqerore - Sistemet e menaxhimit te vazhdimesise se biznesit – Kerkesat". Autoriteti kontraktor nuk po prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike te Sigurise shoqerore - Sistemet e menaxhimit te vazhdimesise se biznesit, perndryshe ne do ta kuptonim kerkesen. Ne proceduren objekt ankese nuk ka asnje mall apo sherbim te cilat karakteristika specifike te Siguria shoqerore - Sistemet e menaxhimit te vazhdimesise se biznesit.

112. Referuar Argumentimit te Kritereve te Kualifikimit, rezulton qartesisht se autoriteti nuk ka arritur dot ta mbeshtese ne ligj kerkesen dhe nuk ka arritur te argumentoje se perse kerkon nje ISO te tille. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka theksuar se:
Argumentim: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".
Çertifikate ISO 22301-2012(e vlefshme) ose ekuivalente, eshte nje standard nderkombetar per Sistemet e Menaxhimit te Vazhdimesise se Biznesit. Ky eshte nje standart dhe nje kriter i vendosur per te siguruar autoritetin kontraktor mbi qendrueshmerine e vazhdueshme te operatorit ekonomik ofertues duke siguruar vazhdimesin e operacioneve dhe sherbimeve te ofruara kundrejt cdo

rreziku. Ky kriter eshte nje kriter i cili siguron autoritetin kontraktor mbi qendrueshmerin ekonomike te vazhdueshme te operatorit ekonomik ofertues.
113. Referuar dispozitave ligjore ku eshte bazuar autoriteti kontraktor per hartimin e kriterit kualifikues, del qarte se asnje prej tyre nuk i jep te drejte autoritetit qe te kerkoje Certifikat ISO pavaresisht “merakut” te shtuar qe ka autoriteti kontraktor se mos Bizneset ngelen rruges dhe nuk i vene Mobilet ne destinacion.
114. Persa analizuam me siper, del qarte se kerkesa e autoritetit kontraktor per Certifikaten ISO 22301-2012 per “Siguria shoqerore - Sistemet e menaxhimit te vazhdimesise se biznesit”, nuk lidhet aspak me objektin e kontrates dhe procedures se prokurimit, nuk eshte aspak e argumentuar, per pasoje kerkojme heqjen e ketij kriteri.
115. SE DYTI, ne ne lidhje me kerkesen “Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Çertifikate ISO 22301-2012(e vlefshme) ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, vlene argumenti i dhene me siper keshtu nuk do te bjeme perseritje.
Persa me siper, kerkojme heqjen e kerkeses qe detyron operatoret ekonomik te paraqesin Certifikatat ISO te Prodhuesit.
X) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
116. Ofertuesi duhet te paraqese Çertifikate ISO 37001:2016 (e vlefshme) “sistemin e menaxhimit anti-ryshfet te kompanise ose ekuivalente” ose ekuivalente.
Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Çertifikate ISO 37001:2016 (e vlefshme) ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
117. SE PARI, ne nenin 44 i VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, nuk permend askund Certifikata te tilla. Per me teper, qe kjo ISO 37001:2016 per “Sistemet e menaxhimit kunder ryshfetit ? Kerkesat me udhezime per

perdorim” nuk ka asnje pike lidhje me objektin e prokurimit. Pavaresisht kesaj, ne dispoziten ligjore te referuar me siper, eshte specifikuar qarte se autoriteti kontraktor mund te kerkoje per Mallrat dhe Sherbimet, Certifikata te Cilsise dhe jo cdo certifikat te mundshme ISO.
118. Ne nenin 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, theksohet se:
“1. Autoriteti/enti kontraktor, per te vertetuar se punet, mallrat ose sherbimet, objekt prokurimi, i plotesojne kerkesat e cilesise, mund t’u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise, vetem nese ato jane te argumentuara dhe te lidhura ngushtesisht dhe ne menyre te drejtperdrejte me objektin e prokurimit.
2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se.
Kjo dispozite zbatohet edhe kur kerkesat teknike u referohen kualifikimeve te kandidatit ose te ofertuesit.
3. Certifikatat dhe etiketat e kerkuara duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me objektin e kontrates, si dhe çdo operator ekonomik duhet t? ket? akses n? to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.
4. N?se autoriteti/enti kontraktor k?rkojn? nj? certifikat?, ose etiket?, ata jan? t? detyruar t? pranojn? çdo certifikat? ose etiket? ekuivalente/ t? barasvlershme me t?, ose nj? dokument q?

provon t? nj?jtin informacion.
5. Kur eshte e dukshme qe nje operator ekonomik e ka te pamundur te marre etiketen specifike, te cilesuar nga autoriteti/enti kontraktor ose nje etikete ekuivalente, brenda afateve kohore perkatese, per shkaqe qe nuk lidhen me ate operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon menyra te tjera vertetimi te pershtatshme, qe mund te perfshijne nje dosje teknike nga prodhuesi, nese operatori ekonomik ne fjale verteton se punet, furnizimet ose sherbimet qe ai duhet te ofrojne permbushin kerkesat e etiketes specifike ose kerkesat specifike te cilesuara nga autoriteti/enti kontraktor."
119. Nderkohe, ne piken 2 te Nenit 44 "Kerkesat e cilesise" te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", ligjvenesi ka lene nje hapsire per autoritetin kontraktor qe te kerkoje etiketa, kur prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera:
"2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se."
120. Pra, ligjvenesi nuk i ka lene dore te lire autoritetit kontraktor me qellim qe te shmangi kerkesat abuzive dhe aspak te argumentuara sic eshte kerkesa e kualifikimit ne fjale ISO 37001:2016 per "Sistemet e menaxhimit kunder ryshfetit ? Kerkesat me udhezime per perdorim". Autoriteti kontraktor nuk po prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike per

"Sistemet e menaxhimit kunder ryshfetit ? Kerkesat me udhezime per perdorim" perndryshe ne do ta kuptonim kerkesen. Ne proceduren objekt ankese nuk ka asnje mall apo sherbim te cilat kane karakteristika specifike te "Sistemeve te menaxhimit kunder ryshfetit ? Kerkesat me udhezime per perdorim".
121. Referuar Argumentimit te Kritereve te Kualifikimit, rezulton qartesisht se autoriteti nuk ka arritur dot ta mbeshtese ne ligj kerkesen dhe nuk ka arritur te argumentoje se perse kerkon nje ISO te tille. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka theksuar se:
Argumentim: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per ISO 37001 eshte nje standard nderkombetar, per te perkufizuar kerkesat e nje sistemi menaxhimi anti-rryshfet.Qellimi i ketij standardi eshte qe te ndihmoje shoqerite, t'i paraprije, te zbuloje dhe te luftoje aktet e korrupsionit.
Bashkia Kamez eshte nje autoritet kontraktor I cili eshte pro organizmave kombetare dhe nderkombetare per luften kunder korrupsionit dhe nepermjet vendosjes se ketij kriteri kerkon te sigurohet mbi certifikimin e pastertise se figures se operatoreve ekonomik ofertues te cilet nepermjet pjesmarrjes ne kete procedure jane kandidat per ofrimin e sherbimit ne kete bashki. miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".
122. Referuar dispozitave ligjore ku eshte bazuar autoriteti kontraktor per hartimin e kriterit kualifikues, del qarte se asnje prej tyre nuk i jep te drejte autoritetit qe te kerkoje Certifikat ISO pavaresisht "merakut" te shtuar qe ka autoriteti kontraktor se mos e korruptojne operatoret ekonomik dhe pastaj atyre "do tu ngelte hateri" dhe do te "fyheshin" rende.
123. Persa analizuam me siper, del qarte se kerkesa e autoritetit kontraktor per Certifikaten ISO 37001:2016 per "Sistemet e menaxhimit kunder ryshfetit ? Kerkesat me udhezime per perdorim", nuk lidhet aspak me objektin e kontrates dhe me objektin e procedures se prokurimit, nuk eshte aspak e argumentuar, per pasoje kerkojme heqjen e ketij kriteri.
124. SE DYTI, ne ne lidhje me kerkesen "Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Çertifikate ISO 37001:2016 (e vlefshme) ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika

e Shqiperise", vlene argumenti i dhene me siper keshtu nuk do te bjeme perseritje.
Persa me siper, kerkojme heqjen e kerkeses qe detyron operatoret ekonomik te paraqesin Certifikatat ISO te Prodhuesit.
XI) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
125. 2.3.9 Operatori ekonomik, diten e hapjes se ofertave, per artikujt objekt prokurim, duhet te depozitojne prane Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamez, mostrat si me poshte:
? Tavolina nxenesi CU(120x64x45 cm)
? Karrige nxenesi CU (35x38x37/70 cm)

? Tavolina nxenesi AMU (120x75x45 cm)
? Karrige nxenesi AMU(35x38x42/75 cm)
? Tavolina mesuesi ne klasa (120x60x76 cm)
? Dollap per klasa
? Rafte per çdo mesues ne sallen e mesuesve
? Karrige per sallen polifunksionale
? Shtrat vizite per infermierine
? Mos paraqitja e mostrave nga OE eshte kusht per skualifikim nga AK.
Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qellim vertetimin se operatori ekonomik i ploteson kerkesat minimale ne perputhje me nenin 40, pika 6 b) te VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kerkoje operatoreve ekonomike te dorezojne deshmi, qe tregojne se ata i plotesojne kerkesat minimale, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si:
a) mostra te mallit, kur e gjykon se kjo ka rendesi per vleresimin e ofertes teknike. N? k?t? rast, autoriteti/enti kontraktor duhet t? argumentoj? k?rkes?n p?r mostrat. Mostrat duhet te trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet te jene ne kontroll te autoritetit/entit kontraktor. N? rastin e procedurave t? zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor p?rcakton qart? procedur?n p?r dor?zimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori t? interesuar si dhe konfidencialitetin p?r pjes?marrjen n? proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesen e tij, brenda 30 (tridhjete) diteve pas nenshkrimit te kontrates, me kusht qe kontrata ne fjale te mos jete objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqesor. Ne rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesen e tij, brenda 30 (tridhjete) diteve nga data e marrjes se vendimit perfundimtar te anulimit;
Vendosja e kriterit te sipercituara ka per qellim verifikimin e perputhueshmerise se produkteve te ofruara nga operatoret ekonomike te interesuar me specifikimet teknike te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor me qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi me sukses.
Qellimi i vendosur nga ligjvenesi per paraqitjen e mostrave, eshte dhenia e mundesise se autoritetit kontraktor, i cili eshte pergjegjes per prokurimin e fondeve publike, te kryerjes se verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) te mostrave te dorezuar nga operatori ekonomik ne rast se keto te fundit jane ne perputhje me kerkesat e autoritetit kontraktor te pasqyruar ne specifikimet teknike te procedures se prokurimit. Njesia e Prokurimit gjykon se dorezimi i mostrave eshte i rendesishem per autoritetin kontraktor ne funksion te verifikimit te perputhshmerise se specifikimeve teknike me mostrat e dorezuara me qellim realizimin me sukses te kontrates objekt prokurimi.
Nga ana e AK jane kerkuar mostra ne perputhje me bazen ligjore te siperpermendur duke qene se nepermjet kerkeses per dorezim mostrash AK krijon siguri te plote dhe verteton plotesisht permbushjen e specifikimeve teknike dhe perputhshmerine e mallrave te kerkuar me ato te ofertuar nga operatori ekonomik.
Ne lidhje me afatin e levrimit te mallit nga ana specialistit te fushes u vleresua se nisur nga volumi i kontrates, proceset qe do kryhen (prodhim, transport, furnizim vendosje), furnizimi ne shkolle ne Bashkine Kamez te percaktuara ne plan shperndarje u caktua afati i levrimit prej _____ muajsh nga nenshkrimi i kontrates.

126. Ne nenin 2 “Qellimi” te ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qellim i ketij ligji eshte: a) te rrise efiçencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik; b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik; dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik.”
127. Ndekohe ne nenin 3 “Parime te pergjithshme” te ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:
“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatoret ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore jane te detyruara te zbatojne detyrimet e percaktuara ne legjislacionin mjedisor, social e te punes dhe ne dispozitat e marreveshjeve dhe konventat nderkombetare, te ratifikuara ne perputhje me Kushtetuten.”
128. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor eshte pergjegjes per prokurimin ne perputhje me dispozitat e ketij ligji dhe te akteve nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij, duke garantuar respektimin e parimeve te trajtimit te barabarte, transparences, konkurrences dhe mosdiskriminimit, te parashikuara ne kete ligj.
129. Ne nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kerkesat per kualifikim” i ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne kerkesat per kualifikim per operatoret ekonomike bazuar ne: a) pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftesine teknike dhe profesionale. Kerkesat kufizohen vetem ne ato qe jane te pershtatshme per te garantuar qe nje kandidat ose ofertues te kete kapacitetet juridike, financiare dhe aftesite teknike e profesionale per te zbatuar kontraten qe do te jepet. Te gjitha kerkesat duhet te kene lidhje dhe te jene proporcionale me objektin e kontrates. [...] 4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne veçanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontratat e zbatuara ne te shkuaren. Aftesia profesionale e operatoreve ekonomike per te ofruar sherbimin, punen, mallin vleresohet ne lidhje me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem per te zbatuar kontraten, siç eshte pershkruar nga autoriteti ose enti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates.

130. Ne nenin 40 pika 6 germa a) “Kerkesa te veçanta per kontratat e mallrave” te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:
“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kerkoje operatoreve ekonomike te dorezojne deshmi, qe tregojne se ata i plotesojne kerkesat minimale, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si: a) mostra te mallit, kur e gjykon se kjo ka rendesi per vleresimin e ofertes teknike. N? k?t? rast, autoriteti/enti kontraktor duhet t? argumentoj? k?rkes?n p?r mostrat. Mostrat duhet te trajtohen si informacion konfidencial 38 tregtar dhe duhet te jene ne kontroll te autoritetit/entit kontraktor. N? rastin e procedurave t? zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor p?rcakton qart? procedur?n p?r dor?zimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori t? interesuar si dhe konfidencialitetin p?r pjes?marrjen n? proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesen e tij,

brenda 30 (tridhjete) diteve pas nenshkrimit te kontrates, me kusht qe kontrata ne fjale te mos jete objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqesor. Ne rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesen e tij, brenda 30 (tridhjete) diteve nga data e marrjes se vendimit perfundimtar te anulimit;"

131. Shoqeria jone thekson, se kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve te operatoreve ekonomike, te cilet nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithçka ne funksion realizimit me sukses te kontrates. Ne kete kuptim, per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatori ekonomik zoteron kapacitetet teknike, ne perputhje dhe ne perpjesetim me volumin e kontrates te percaktuar ne dokumentet e tenderit. Per autoritetin kontraktor eshte teper e rendesishme qe te sigurohet qe mallrat objekt-prokurimi te ofertuara nga operatoret ekonomike pjesemarres, jane ne perputhje me kerkesat ne dokumentet e tenderit. Ne percaktimin apo vendosjen e kritereve specifike, qe ne thelb konsiderohen si kritere fituese, per shkak te rendesise qe kane, ligjvenesi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit qe ka ne perzgjedhjen e tyre. Ne kete menyre, dispozitat e siperpermendura, urdherojne se percaktimi i ketyre kritereve duhet te jete: (i) ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates (ii) Ne çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatoret ekonomike per permbushjen e ketyre kritereve. Autoriteti kontraktues eshte ne te drejten e tij per te percaktuar kriteret per kualifikim, mjafton qe ato te mos jene diskriminuese e perjashtuese.

132. Per kete arsye, gjykojme, se eshte me vend te ndalemi ne faktin nese kjo kerkese eshte ne proporcion me objektin e kontrates qe do te prokurohet ne zbatim te nenit 77 pika 1 te LPP-se. Ne rastin konkret, konstatohet se synimi baze i autoritetit kontraktor eshte vertetimi, se subjektet ofertues zoterojne kapacitetet e nevojshme per realizimin e kontrates. Per permbushjen e ketij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar ne dokumentet e procedures se prokurimit jo vetem kritere kualifikimi te cilat lidhen me vertetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere te tjera kualifikimi te cilat lidhen me vertetimin e plotesimit te specifikimeve teknike te produktit. Nga shqyrtimi i kritereve te kualifikimit, konstatojme, se per disa nga artikuj objekt-prokurimi, konkretisht:

? Tavolina nxenesi CU(120x64x45 cm)
? Karrige nxenesi CU (35x38x37/70 cm)

? Tavolina nxenesi AMU (120x75x45 cm)
? Karrige nxenesi AMU(35x38x42/75 cm)
? Tavolina mesuesi ne klasa (120x60x76 cm)
? Dollap per klasa
? Rafte per çdo mesues ne sallen e mesuesve
? Karrige per sallen polifunksionale
? Shtrat vizite per infermierine

kerkohet dorezimi i mostrave ne ambientet e autoritetit kontraktor. Sa me siper, referuar kerkesave te vendosura nga autoriteti kontraktor, si dhe argumenteve te parashtruara nga ana jone, gjykojme, se referuar objektit te prokurimit si dhe natyres se produkteve qe kerkohet te furnizohet, gjykojme se kerkesa e autoritetit kontraktor per paraqitjen e mostrave per artikujt e siperpermendur eshte nje kerkese e ekzagjeruar dhe qe shkon pertej asaj se çfare eshte e nevojshme per realizimin e synimit, nisur nga lloji dhe natyra e mallit qe kerkohet te prokurohet. Vlen te theksojme, se qellimi i autoritetit kontraktor, eshte furnizimi ne kohe dhe ne cilesi me produktet objekt-prokurimi, por ne respekt te parimeve te ligjit per prokurimin publik, kriteret e kualifikimit te hartuara nga autoriteti kontraktor, ne asnje rast nuk duhet te diskriminojne/perjashtojne nga konkurrimi operatoret ekonomike ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin keta kombetare apo nderkombetare. Ne hartimin e

kritereve te kualifikimit autoritetet kontraktore duhet te shmangin çdo forme diskriminimi, e cila kufizon pjesemarrjen e gjere te operatoreve ekonomike ne nje procedure prokurimi. Akoma me tej, autoriteti kontraktor ka ne dispozicion edhe momentin procedural te kontrollit te dyte pas lidhjes se kontrates te perputhshmerise se produkteve te furnizuara nga operatori ekonomik i kualifikuar me ato te kerkuara nga autoriteti kontraktor. Referuar rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitoroje zbatimin e kontrates, per t'u siguruar nese cilesia e mallit do te jete e njejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuara ne oferte dhe te percaktuara ne kontrate.
Sa me siper, kerkojme heqjen e kriterit per paraqitjen e mostrave.
133. Akoma me tej, per mostrat ka vendosur edhe Komisioni i Prokurimeve Publike i cili merr vendime administrativisht perfundimtare. Ne vendimin Nr.454/2024, date 07.05.2024, KPP ka arsyetuar se duhet hequr kerkesa per Mostra:
"III.4.6.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve te operatoreve ekonomike, te cilet nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithçka ne funksion realizimit me sukses te kontrates. Ne kete kuptim, per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatori ekonomik zoteron kapacitetet teknike, ne perputhje dhe ne perpjesetim me volumin e kontrates te percaktuar ne dokumentet e tenderit. Per autoritetin kontraktor eshte teper e rendesishme qe te sigurohet qe mallrat objekt-prokurimi te ofertuara nga operatoret ekonomike pjesemarres, jane ne perputhje me kerkesat ne dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ne percaktimin apo vendosjen e kritereve specifike, qe ne thelb konsiderohen si kritere fituese, per shkak te rendesise qe kane, ligjvenesi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit

qe ka ne perzgjedhjen e tyre. Ne kete menyre, dispozitat e siperpermendura, urdherojne se percaktimi i ketyre kritereve duhet te jete: (i) ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates (ii) Ne çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatoret ekonomike per permbushjen e ketyre kritereve. Autoriteti kontraktues eshte ne te drejten e tij per te percaktuar kriteret per kualifikim, mjafton qe ato te mos jene diskriminuese e perjashtuese.
III.4.7. Referuar pretendimit te operatorit ekonomik ankimues te paraqitur ne ankese, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se eshte me vend te ndalet ne faktin nese kjo kerkese eshte ne proporcion me objektin e kontrates qe do te prokurohet ne zbatim te nenit 77 pika 1 te LPP-se. Ne rastin konkret Komisioni konstaton, se synimi baze i autoritetit kontraktor eshte vertetimi, se subjektet ofertues zoterojne kapacitetet e nevojshme per realizimin e kontrates. Komisioni konstaton, se per permbushjen e ketij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar ne dokumentet e procedures se prokurimit jo vetem kritere kualifikimi te cilat lidhen me vertetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere te tjera kualifikimi te cilat lidhen me vertetimin e plotesimit te specifikimeve teknike te produktit. Nga shqyrtimi i kritereve te kualifikimit, KPP veren, se per disa nga artikuj objekt-prokurimi, konkretisht Element per raft zyre dhe tavolina 80*60; Karrike rrotulluese specialist; Element per Grila roller me gjithe mekanizem; Karrike fikse, kerkohet dorezimi i mostrave ne ambientet e autoritetit kontraktor. Sa me siper, referuar kerkesave te vendosura nga autoriteti kontraktor, si dhe argumenteve te parashtruara nga operatori ekonomik ankimues, ne ankesen e tij, gjykojme, se referuar objektit te prokurimit si dhe natyres se produkteve qe kerkohet te furnizohet, gjykojme se kerkesa e autoritetit kontraktor per paraqitjen e mostrave per artikujt e siperpermendur eshte nje kerkese e ekzagjeruar dhe qe shkon pertej asaj se çfare eshte e nevojshme per realizimin e synimit, nisur nga lloji dhe natyra e mallit qe kerkohet te prokurohet. Vlen te theksojme, se qellimi i autoritetit kontraktor, eshte furnizimi ne kohe dhe ne cilesi me produktet objekt-prokurimi, por ne respekt te parimeve te ligjit per prokurimin publik, kriteret e

kualifikimit te hartuara nga autoriteti kontraktor, ne asnje rast nuk duhet te diskriminojne/perjashtojne nga konkurrimi operatoret ekonomike ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin keta kombetare apo nderkombetare. Ne hartimin e kritereve te kualifikimit autoritetet kontraktore duhet te shmangin çdo forme diskriminimi, e cila kufizon pjesemarrjen e gjere te operatoreve ekonomike ne nje procedure prokurimi. Akoma me tej, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka ne dispozicion edhe momentin procedural te kontrollit te dyte pas lidhjes se kontrates te perputhshmerise se produkteve te furnizuara nga operatori ekonomik i kualifikuar me ato te kerkuara nga autoriteti kontraktor. KPP sjell ne vemendje, se referuar rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitoroje zbatimin e kontrates, per t'u siguruar nese cilesia e mallit do te jete e njejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuara ne oferte dhe te percaktuara ne kontrate. Sa me siper pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qendron."
134. Nga sa me siper analizuar si edhe bazuar ne vendimin me te fundit te Komisionit te Prokurimeve Publike, kerkojme heqjen e kerkeses per paraqitjen e Mostrave.
Nga sa parashtruam dhe analizuam me siper, kerkojme:
? Pezullimin e procedures deri ne shqyrtimin e plote te ankeses;
? Pranimin teresisht te ankeses sipas parashtrimeve te referuara me siper, duke hequr dhe modifikuar kriteret e vecanta te kualifikimit te ankimuara.

**4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

3. Rrethanat dhe faktet
Pershkruani rrethanat e faktit.
Ne daten 12.06.2024, eshte publikuar ne SPE procedura e prokurimit me te dhenat e referuara me siper. Nga verifikimi me kujdes i kritereve, rezulton se ato nuk jane hartuar ne perputhje me legjislacionin e prokurimeve publike. Duke qene se jemi brenda afatit 10 ditor te percaktuar ne nenin 110 te LPP-se, pasi procedura e prokurimit ne fjale eshte mbi kufirin e larte monetare (12.06.2024-21.06.2024), paraqesim ankesen me shkeljet konkrete si ne vijim: I) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
1. 2.3.2.Operatori/et ekonomik pjesemarres per te realizuar prodhimin/montimin dhe shperndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe sherbimin e transportit duhet te kete minimalisht te punesuar, si me poshte:
Stafi
Nr.
Shofer

2
Punetore te thjeshte
4
Marangoz
4
Saldator
2
Inxhinier Perpunimit te drurit
2
Arkitekt
1
Total
15
- Per punonjesit e punesuar shofer te paraqitet kontrate pune perkatese si dhe leje drejtimi per secilin.
- Per punonjesit e punesuar punetore te thjeshte te paraqitet vetem kontrate pune perkatese.

- Per punonjesit e punesuar marangoz te paraqitet kontrate pune perkatese si dhe iqt deshmite e kualifikimit profesional teknik per secilin .
- Per punonjesit e punesuar saldator te paraqitet kontrate pune perkatese si dhe iqt deshmite e kualifikimit profesional teknik secilin.
- Per punonjesit e punesuar Inxhinier Perpunimit te Drurit te paraqitet kontrate pune perkatese, diploma dhe CV per secilin,
- Per punonjesin e punesuar Arkitekt te paraqitet kontrate pune perkatese, diploma dhe CV,
Te gjithe punonjesit e kerkuar me lart duhet te jene te deklaruar dhe te paraqitet listepagesat e sigurimeve shoqerore per 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave
Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:
Nr
Emer Mbiemer
Profesioni
Data e fillimit te marredhenieve te punes
2. SE PARI Kerkesa per ......“4 Marangoz”...... eshte teresisht e ekzagjeruar dhe aspak e argumentuar, ne nje kohe qe proceset e punes jane teresisht te automatizuara dhe montimi i mobileve behet tereisht nga puntoret.
3. Referuar procesverbalit “PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM”, te publikuar nga ana e autoritetit kontraktor ne Sistemin Prokurimit Elektronik, eshte argumentuar si me poshte:
Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter eshte i lidhur ngushte me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarres.
Kerkesa per numrin minimal te punonjesve eshte percaktuar duke patur parasysh sasine e pajisjeve te nevojshme, afatin e percaktuar per levrimin e kontratave bazuar ne MK, e lidhur kjo me kohen e perfundimit te Rindertimit te godines dhe venien e menjehereshme te saj ne funksionim.
Kerkesa per dy Inxhinier Perpunimit te drurit eshte e lidhur ngushtesisht me realzimin e objektit te prokurimit per shkak te ndjekjes specifike dhe realizimit ne kohe te te gjithe sasise se mallit te prokuruar qe baze te tij ka materialet drusore dhe derivate te tij.
4. Sic dukshem shihet, pervec sa autoriteti kontraktor ka theksuar ne menyre te pergjithshme se “Kerkesa per numrin minimal te punonjesve eshte percaktuar duke patur parasysh sasine e

pajisjeve te nevojshme, afatin e percaktuar per levrimin e kontratave bazuar ne MK, e lidhur kjo me kohen e perfundimit te Rindertimit te godines dhe venien e menjehereshme te saj ne funksionim.", nuk ka argumentuar ne baze te nje Analize teknike dhe Grafike se numri prej 4 Marangozash eshte jetik dhe se 1 ose 2 Marangoz nuk japin garanci se objekti do realizohet me sukses. Pra, jemi perpara atyre rasteve klasike kur autoriteti kontraktor thjesht sa ka deshtuar te mireargumentoje nje kerkese per nje numer kaq te madh Mobileresh, thua se punen e bejne Mobileret dhe jo punonjesit dhe makinerite e automatizuara.



5. Sic del nga sa me siper, autoriteti kontraktor ka deshtuar te provoje ne baze te nje analize teknike dhe grafike se perse nevojiten 4 Marangoz dhe jo fjala vjen 6 apo 2 apo edhe 1 te tille. Autoriteti kontraktor eshte mjaftuar me nje rrjesht fjalie dhe mendon se e ka permbushur detyrimin ligjor qe te mireargumentoje kriteret dhe kerkesat qe i'u ngarkon operatoreve ekonomik qe duan te marin pjese ne gare.

6. Ne nenin 2 "Qellimi" te ligjit 162/2020 "Per Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se: "Qellim i ketij ligji eshte: a) te rrise efiçencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik; b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik; dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik."

7. Ne Nenin 3 "Parime te pergjithshme" te ligjit 162/2021 "Per prokurimin publik",i ndryshuar, parashikohet se: "1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatoret ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore jane te detyruara te zbatojne detyrimet e percaktuara ne legjislacionin mjedisor, social e te punes dhe ne dispozitat e marreveshjeve dhe konventat nderkombetare, te ratifikuara ne perputhje me Kushtetuten.".

8. Ne Nenin 21 "Autoriteti ose enti kontraktor" te ligjit 162/2021 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: "1. Autoriteti ose enti kontraktor eshte pergjegjes per prokurimin ne perputhje me dispozitat e ketij ligji dhe te akteve nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij, duke garantuar respektimin e parimeve te trajtimit te barabarte, transparences, konkurrences dhe mosdiskriminimit, te parashikuara ne kete ligj. Ne kuptim te kesaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin te mireplanifikoje ne cilesi dhe ne kohe fondet publike e nevojat e tij dhe te prokuroje e te zbatoje kontraten ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.".

9. Ne Nenin 77 "Kerkesat per kualifikim", pika 4, te ligjit nr.162/2020 "Per prokurimin publik", i ndyshuar, parashikohet shprehimisht se: "4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne veçanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontratat e zbatuara ne te shkuaren. Aftesia profesionale e operatoreve ekonomike per te ofruar sherbimin, punen, mallin vleresohet ne lidhje me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem per te zbatuar kontraten, siç eshte pershkruar nga autoriteti ose enti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates.".

10. Ne nenin 40, pika 5 "Kerkesa te veçanta per kontratat e mallrave" te VKM Nr. 285 date 19.5.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar parashikohet se: "Per te provuar pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale, kapacitetet teknike dhe

profesionale, autoriteti/enti kontraktor kerkon: a) licencat profesionale per prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore; dhe /ose b) nje liste te personelit

kryesor, te nevojshem per te zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentet e saj. Lista e personelit kryesor duhet te perfshije CV-te e tyre dhe licencat profesionale, kur kane te tilla sipas legjislacionit p?rkat?s; dhe/ose c) fuqine punetore te operatorit ekonomik te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten, te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit.".

11. Theksojme se kriteret per kualifikim vendosen qe ti sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithçka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne kete kuptim, per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatoret ekonomike pjesemarres ne proceduren e prokurimit zoterojne kapacitetin teknik e konkretisht deshmi per pervojen e meparshme. Autoriteti kontraktor eshte organi pergjegjes per prokurimin e fondeve publike, ne perputhje me dispozitat ligjore e nenligjore ne fuqi, ndaj dhe percaktimi i kritereve te veçanta per kualifikim eshte lene nen pergjegjesine e autoritetit kontraktor, gjithnje ne perputhje e perpjesetim me objektin e natyren e kontrates se prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret per kualifikim duhet te hartohen ne perputhje me LPP-ne dhe rregullat e prokurimit publik, ne menyre te tille qe te nxisin pjesemarrjen dhe konkurrencen e operatoreve ekonomike, te stimulojne pjesemarrjen e biznesit te vogel dhe te mesem, si dhe te sigurojne nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne keto procedura, per realizimin me sukses te kontrates me qellim zgjerimin e rrethit te pjesemarrjes se operatoreve ekonomike ne respekt te nenit 2 te LPP-se.

12. Bazuar ne sa me siper, si edhe referuar vleres se kontrates, natyres se mallit si dhe shperndajes se tij ne Bashkine Kamez, gjykojme se percaktimi i numrit te Marangozeve, duhet te vije pas nje analize te hollesishme te te gjithe elementeve te procedures se prokurimit si volumi, natyra, grafiku i levrimit, afati i kontrates dhe mundesise se mobilizimit te Marangozeve ne orare te caktuara, sikunder parashikojne dispozitat ligjore ne fuqi. Sa me siper, bazuar ne te gjithe elementet e cituar me larte, shoqeria jone gjykon se, kerkesa per disponimin e 4 Marangozeve, eshte nje kerkese e pajustifikuar nga autoriteti kontraktor. Duam te theksojme se per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet disponimi i numrit te nevojshem te Marangozeve nga ana e operatoreve ekonomike, por percaktimi i numrit te tyre duhet te vije pas nje analize gjithperfshirese te autoriteti kontraktor, i te gjithe elementeve te cituara me siper, me qellim percaktimin e numrit te tyre, ne menyre te arsyeshme, proporcionale, si dhe ne perputhje me nevojat reale, per ekzekutimin e kontrates ne menyre te suksesshme, ne respekt te nenit 77 "Kerkesat per kualifikim", pika 4, te ligjit nr.162/2020 "Per prokurimin publik", i ndyshuar dhe nenit 40, pika 3 te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" i ndryshuar, parashikon se: "3. Kerkesat e veçanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 77, te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatoret ekonomike per permbushjen e ketyre kritereve". Gjithashtu, referuar dokumentacionit te aktit mbi miratimin e dokumenteve te procedures se prokurimit objekt ankimi, konstatojme se autoriteti kontraktor nuk ka arritur te argumentoje teknikisht mbi kerkesen per disponimin e nje numri prej 4 Marangozesh si deshmi te fuqise punetore.

13. Sa me siper, kerkojme ndryshimin e kriterit kualifikues lidhur me numrin e Marangozeve duke e e ulur ne minimalisht 1-2 te tille ose ne proporcion me nje grafik dhe analize te detajuar dhe duke

u bazuar ne volumin e zerave te furnizimeve te percaktuar ne listen e preventivit/zerave te mallrave.

14. SE DYTI, kerkesa qe ??. “Per punonjesit e punesuar marangoz te paraqitet kontrate pune perkatese si dhe iqt deshmite e kualifikimit profesional teknik per secilin.”, eshte nje kerkese teresisht e paligjshme per dy arsye:
15. Se pari, vertetimi i faktit se nje person eshte apo nuk eshte Marangoz nuk vertetohet me IQT apo sic ndryshe quhen deshmi te kualifikimit teknik, por vertetohen me diploma te shkolles se mesme profesionale ose me certifikata kualifikimesh te leshuara nga Institucione Publike apo Private te Akredituara per te kualifikuar dhe certifikuar punonjes si Marangoz.
16. Ne ligjin Nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne Republiken e Shqiperise”, ne nenin 3 te tij percakton se: “Arsimi dhe formimi profesional ka per mision: a) te zhvilloje kompetenca personale e profesionale te nevojshme, si dhe shprehi e kompetenca te tjera te diversifikuara, qe pasqyrojne preferencat dhe nevojat e veçanta te punedhenesve per te siguruar mireqenie sociale dhe zhvillimin ekonomik; b) te ofroje arsim dhe formim profesional ne perputhje me nivelin e zhvillimit te shkences e te teknologjise, me kerkesat e tregut te punes ne ndryshim te vazhdueshem, si dhe me kulturen e traditen kombetare; c) te siguroje perputhshmeri nderkombetare te dokumenteve certifikuese te leshuara.” Ndersa ne piken 17 te nenit 4 te po ketij ligji thuhet se: “Certifikatat/deshmite/diplomat” jane dokumente zyrtare te llojeve te ndryshme, te leshuara nga nje organ certifikues, te cilat regjistrojne arritjet e nje individi pas vleresimit, sipas nje procedure e standardi te paracaktuar. Nderkohe sipas parashikimeve te ligjit te sipercituar, Kualifikimi profesional” eshte nje sistem njohurish, aftesish, qendrimesh dhe vlerash, te cilat mundesojne ushtrimin me sukses te nje aktiviteti te caktuar profesional, i cili mund te perftohet nepermjet mesimnxenies te nje ofrues i AFP-se, i permbyllur me provime dhe i certifikuar nepermjet nje dokumenti perkates (certifikate).
17. Akoma me tej, vete Komisioni i Prokurimeve Publike, me ane te Vendimit Nr. K.P.P.238/2021, date 25.05.2021, ka arsyetuar se:
“Lidhur me kete fakt, KPP gjykon se dokumenti Deshmi per kualifikimin e sigurimit teknik/Certifikate mbi sigurimin teknik te paraqitura nga operatori ekonomik ankimues per pjesen me te madhe te punonjesve, ka per qellim sigurimin teknik te punonjesve gjate ushtrimit te profesionit te tyre ne perputhje me ligjin nr. 8734 date 01.02.2001, “Per Garantimin e Sigurise se Punes te Pajisjeve dhe Te Instalimeve Elektrike”, i ndryshuar, por nuk zevendeson ne asnje rast deshmine profesionale te cilen autoriteti kontraktor e ka kerkuar shprehimisht ne kriterin e kualifikimit per te gjithe punonjesit.”
18. Se dyti, IQT ose apo sic ndryshe quhen deshmi te kualifikimit teknik, jepen per personat qe punojne prane Impianteve Elektrike dhe jo cdo punonjes te mundshem.
19. Lidhur me kete fakt, shoqeria jone gjykon se dokumenti Deshmi per kualifikimin e sigurimit teknik/Certifikate mbi sigurimin teknik, ka per qellim sigurimin teknik te punonjesve gjate ushtrimit te profesionit te tyre ne perputhje me ligjin nr. 8734 date 01.02.2001, “Per Garantimin e Sigurise se Punes te Pajisjeve dhe Te Instalimeve Elektrike”, i ndryshuar, por nuk zevendeson ne asnje rast deshmine profesionale per punonjesin e kualifikuar si Marangoz.

20. Ne kete kuptim, kerkojme qe te modifikohet kriteri duke vendosur qe vertetimi i punonjesve Marangoz te behet me diploma te shkolles se mesme profesionale ose me certifikate te leshuara nga Institucione Publike apo Private te Akredituara sipas legjislacionit ne fuqi.
21. SE TRETI Kerkesa per ......“2 Inxhinier Perpunim Druri”...... eshte teresisht e ekzagjeruar dhe aspak e argumentuar, ne nje kohe qe proceset e punes jane teresisht te automatizuara dhe montimi i mobileve behet teresisht nga puntoret.
22. Referuar procesverbalit “PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM”, te publikuar nga ana e autoritetit kontraktor ne Sistemin Prokurimit Elektronik, eshte argumentuar si me poshte:
Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per

prokurimin publik", i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar. Ky kriter eshte i lidhur ngushte me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarres.
Kerkesa per numrin minimal te punonjesve eshte percaktuar duke patur parasysh sasine e pajisjeve te nevojshme, afatin e percaktuar per levrimin e kontratave bazuar ne MK, e lidhur kjo me kohen e perfundimit te Rindertimit te godines dhe venien e menjehereshme te saj ne funksionim.
Kerkesa per dy Inxhinier Perpunimit te drurit eshte e lidhur ngushtesisht me realzimin e objektit te prokurimit per shkak te ndjekjes specifike dhe realizimit ne kohe te te gjithe sasise se mallit te prokuruar qe baze te tij ka materialet drusore dhe derivate te tij.
23. Sic dukshem shihet, pervec sa autoriteti kontraktor ka theksuar ne menyre te pergjithshme se "Kerkesa per dy Inxhinier Perpunimit te drurit eshte e lidhur ngushtesisht me realzimin e objektit te prokurimit per shkak te ndjekjes specifike dhe realizimit ne kohe te te gjithe sasise se mallit te prokuruar qe baze te tij ka materialet drusore dhe derivate te tij." , nuk ka argumentuar ne baze te nje Analize teknike dhe Grafike se numri prej 2 Inxhinieresh eshte jetik dhe se 1 i tille do te conte ne deshtimin e realizimit te kontrates me sukses.
24. Pra, edhe ketu jemi perpara rastit kur autoriteti kontraktor thjesht sa ka deshtuar te mireargumentoje nje kerkese per nje numer kaq te madh Inxhinieresh, thua se punen e bejne ata dhe jo Puntoret dhe makinerite e automatizuara.
25. Ne nenin 2 "Qellimi" te ligjit 162/2020 "Per Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se: "Qellim i ketij ligji eshte: a) te rrise efiçencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik; b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik; dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik."
26. Ne Nenin 3 "Parime te pergjithshme" te ligjit 162/2021 "Per prokurimin publik",i ndryshuar, parashikohet se: "1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe

jodiskriminues per operatoret ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore jane te detyruara te zbatojne detyrimet e percaktuara ne legjislacionin mjedisor, social e te punes dhe ne dispozitat e marreveshjeve dhe konventat nderkombetare, te ratifikuara ne perputhje me Kushtetuten.".
27. Ne Nenin 21 "Autoriteti ose enti kontraktor" te ligjit 162/2021 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: "1. Autoriteti ose enti kontraktor eshte pergjegjes per prokurimin ne perputhje me dispozitat e ketij ligji dhe te akteve nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij, duke garantuar respektimin e parimeve te trajtimit te barabarte, transparences, konkurrences dhe mosdiskriminimit, te parashikuara ne kete ligj. Ne kuptim te kesaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin te mireplanifikoje ne cilesi dhe ne kohe fondet publike e nevojat e tij dhe te prokuroje e te zbatoje kontraten ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.".
28. Ne Nenin 77 "Kerkesat per kualifikim", pika 4, te ligjit nr.162/2020 "Per prokurimin publik", i ndyshuar, parashikohet shprehimisht se: "4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne veçanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontratat e zbatuara ne te shkuaren. Aftesia profesionale e

operatoreve ekonomike per te ofruar sherbimin, punen, mallin vleresohet ne lidhje me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem per te zbatuar kontraten, siç eshte pershkruar nga autoriteti ose enti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates.”.

29. Ne nenin 40, pika 5 “Kerkesa te veçanta per kontratat e mallrave” te VKM Nr. 285 date 19.5.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: “Per te provuar pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kerkon: a) licencat profesionale per prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore; dhe /ose b) nje liste te personelit kryesor, te nevojshem per te zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentet e saj. Lista e personelit kryesor duhet te perfshije CV-te e tyre dhe licencat profesionale, kur kane te tilla sipas legjislacionit p?rkat?s; dhe/ose c) fuqine punetore te operatorit ekonomik te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo qe mund t’i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten, te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit.”.

30. Theksojme se kriteret per kualifikim vendosen qe ti sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithçka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Ne kete kuptim, per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatoret ekonomike pjesemarres ne proceduren e prokurimit zoterojne kapacitetin teknik e konkretisht deshmi per pervojen e meparshme. Autoriteti kontraktor eshte organi pergjegjes per prokurimin e fondeve publike, ne perputhje me dispozitat ligjore e nenligjore ne fuqi, ndaj dhe percaktimi i kritereve te veçanta per kualifikim eshte lene nen pergjegjesine e autoritetit kontraktor, gjithnje ne perputhje e perpjesetim me objektin e natyren e kontrates se prokurimit. Dokumentet e tenderit dhe kriteret per kualifikim duhet te



hartohen ne perputhje me LPP-ne dhe rregullat e prokurimit publik, ne menyre te tille qe te nxisin pjesemarrjen dhe konkurrencen e operatoreve ekonomike, te stimulojne pjesemarrjen e biznesit te vogel dhe te mesem, si dhe te sigurojne nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne keto procedura, per realizimin me sukses te kontrates me qellim zgjerimin e rrethit te pjesemarrjes se operatoreve ekonomike ne respekt te nenit 2 te LPP-se.

31. Bazuar ne sa me siper, si edhe referuar vleres se kontrates, natyres se mallit si dhe shperndajes se tij ne Bashkine Kamez, gjykojme se percaktimi i numrit te Inxhiniereve, duhet te vije pas nje analize te hollesishme te te gjithe elementeve te procedures se prokurimit si volumi, natyra, grafiku i levrimit, afati i kontrates dhe mundesise se mobilizimit te Marangozeve, Puntoreve, sikunder parashikojne dispozitat ligjore ne fuqi. Sa me siper, bazuar ne te gjithe elementet e cituar me larte, shoqeria jone gjykon se, kerkesa per disponimin e 2 Inxhiniereve, eshte nje kerkese e pajustifikuar nga autoriteti kontraktor. Duam te theksojme se per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet disponimi i numrit te nevojshem te Inxhiniereve nga ana e operatoreve ekonomike, por percaktimi i numrit te tyre duhet te vije pas nje analize gjithperfshirese te autoriteti kontraktor, i te gjithe elementeve te cituara me siper, me qellim percaktimin e numrit te tyre, ne menyre te arsyeshme, proporcionale, si dhe ne perputhje me nevojat reale, per ekzekutimin e kontrates ne menyre te suksesshme, ne respekt te nenit 77 “Kerkesat per kualifikim”, pika 4, te ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, i ndyshuar dhe nenit 40, pika 3 te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “3. Kerkesat e veçanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 77, te LPP-se. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatoret ekonomike per permbushjen e ketyre

kritereve". Gjithashtu, referuar dokumentacionit te aktit mbi miratimin e dokumenteve te procedures se prokurimit objekt ankimi, konstatojme se autoriteti kontraktor nuk ka arritur te argumentoje teknikisht mbi kerkesen per disponimin e nje numri prej 2 Inxhiniereve si deshmi te fuqise punetore.
Sa me siper, kerkojme ndryshimin e kriterit kualifikues lidhur me numrin e Inxhiniereve duke e e ulur ate ne 1 te tille.
32. SE KATERTI, Kerkesa qe krahas dokumentacionit si diploma, kontrata pune te ......"paraqiten edhe CV te Inxhiniereve te Perpunimit te Drurit dhe Inxhinierit Arkitekt"...... eshte teresisht e ekzagjeruar dhe aspak e argumentuar, ne nje kohe qe nuk eshte kerkuar si kriter nje eksperience e caktuar per ta.
33. Referuar procesverbalit "PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM", te publikuar nga ana e autoritetit kontraktor ne Sistemin Prokurimit Elektronik, eshte argumentuar si me poshte:
Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar. Ky kriter eshte i lidhur ngushte me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarres.
Kerkesa per numrin minimal te punonjesve eshte percaktuar duke patur parasysh sasine e pajisjeve te nevojshme, afatin e percaktuar per levrimin e kontratave bazuar ne MK, e lidhur kjo me kohen e perfundimit te Rindertimit te godines dhe venien e menjehereshme te saj ne funksionim.

Kerkesa per dy Inxhinier Perpunimit te drurit eshte e lidhur ngushtesisht me realzimin e objektit te prokurimit per shkak te ndjekjes specifike dhe realizimit ne kohe te te gjithe sasise se mallit te prokuruar qe baze te tij ka materialet drusore dhe derivate te tij.
34. Sic duket nga sa me siper, kemi zero argument se perse kerkohen CV e Inxhiniereve, per pasoje kemi te bejme me mosargumentim te kerkeses, nuk eshte kerkuar qe Inxhinieret te kene nje eksperince te caktuar, per pasoje kerkojme heqjen e kerkeses per CV si te pa argumentuar.
35. SE PESTI, Kerkesa qe ka te beje me:
Te gjithe punonjesit e kerkuar me lart duhet te jene te deklaruar dhe te paraqitet listepagesat e sigurimeve shoqerore per 3 (tre) muajit e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave
Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:
Nr
Emer Mbiemer
Profesioni
Data e fillimit te marredhenieve te punes
36. Referuar procesverbalit "PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM", te publikuar nga ana e autoritetit kontraktor ne Sistemin Prokurimit Elektronik, eshte argumentuar si me poshte:
Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar. Ky kriter eshte i lidhur ngushte me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarres.
Kerkesa per numrin minimal te punonjesve eshte percaktuar duke patur parasysh sasine e pajisjeve te nevojshme, afatin e percaktuar per levrimin e kontratave bazuar ne MK, e lidhur kjo me kohen e perfundimit te Rindertimit te godines dhe venien e menjehereshme te saj ne funksionim.
Kerkesa per dy Inxhinier Perpunimit te drurit eshte e lidhur ngushtesisht me realzimin e objektit te prokurimit per shkak te ndjekjes specifike dhe realizimit ne kohe te te gjithe sasise se mallit te prokuruar qe baze te tij ka materialet drusore dhe derivate te tij.

37. Sic duket nga sa me siper, kemi zero argument se perse kerkohet DATA e FILLIMIT te MARDHNIEVE te PUNES, kur ne kriter nuk kerkohet asgje ne lidhje me eksperiencen e punonjesve, per pasoje kemi te bejme me mosargumentim te kerkeses, per pasoje kerkojme heqjen e kerkeses si te pa argumentuar.
II) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
39. 2.3.3 Operatori ekonomik pjesemarres, duhet te disponoje te pakten 2 (dy) mjete transporti, me qellim transportin e mallrave, te cilet duhet t'i kete ne pronesi ose me qira.
Nje mjet transporti me kapacitet mbajtes te pakten 3 Ton dhe te pajisur me Certifikaten e transportit te mallrave dhe nje mjet transporti me kapacitet mbajtes te pakten 1,5 ton.
Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:
Nr.
Lloji i mjetit
Targa
Kapaciteti mbajtes
Statusi

1
Pronesi/qira/perdorim
Shenim: Per mjetet e transportit OE duhet te paraqese Certifikaten e Pronesise, Leje Qarkullimi, Kolaudimin, Siguracionin dhe pagesen e taksave.
Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.
Mjetet e transportit qe do te deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.
- Kriteri konsiderohet i permbushur me paraqitjen e formularit te vetedeklarimit sipas shtojces 8 te DST. Shenim: Referuar pikes 1, te nenit 26, te VKM nr.285, date 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : "Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas p?rcaktimit n? nenin 82, t? LPP-se, dhe n? k?to rregulla", si dhe percaktimet e pikes 6, te ketij neni, ku parashikohet: "Perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar, i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", te pikes 2 te ketij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne origjinal ose ne kopje te njesuara me origjinalin".
40. Kerkesa qe kapaciteti mbajtes i mjeteve te transportit te jete minimalisht 1.5 ton dhe 3 ton, eshte e pa nevojshme dhe aspak e argumentuar teknikisht apo grafikisht, sa kohe ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar qe operatoret te deklarojne transportin e mallit me mjetet e tyre, sa kohe eshte kerkuar qe operatoret te kene eksperienca te ngjashme te meparshme te sukseshme, sa kohe ka kerkuar qe operatoret te jene te certifikuar me ISO 9001-2015.
41. Sipas llogjikes se autoritetit kontraktor nje mjet transporti qe mban 500-600-800 apo 900 kg nuk vlen per te realizuar transportin e mallit. Akoma me tej, referuar Argumentave per kete kriter ne Procesverbalin per Argumentimin e Kritereve te Kualifikimit, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka hartuar nje analize dhe grafik teknik qe do te mbeshteste kerkesen e tij se mjetet duhen patjeter minimalisht 1.5 ton dhe 3 ton, pra, kemi te bejme me nje kerkese evazive dhe per pasoje abuzive. Kjo eshte nje kerkese teresisht e pajustifikuar dhe si e tille duhet te modifikohet.
42. Ne procesverbalin "PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM", te publikuar nga ana e autoritetit kontraktor ne Sistemin Prokurimit Elektronik, eshte argumentuar si me poshte:
Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per

miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky kriter eshte i lidhur ngushte me objektin e kesaj kontrate si dhe me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale nga OE pjesemarres.
43. Baza ligjore e referuar nga autoriteti nuk e zhvesh kete te fundit nga pergjegjesia per te mireargumentuar kerkesat e vecanta te kualifikimit. Pra, autoriteti nuk mund te justifikohet se ka referuar nje baze ligjore por duhej te kishte analizuar se perse i duhen mjetet me kete tonazh gje qe ka deshtuar ta beje.

44. Nisur nga sa me siper referuar, shoqeria jone gjykon se, percaktimi nga ana e autoritetit kontraktor te kriterit kualifikues te referuar me siper qe kapacitetet mbajtes te mjeteve t transporti te jene minimalisht 1.5 ton dhe 3 ton, ku ne argumentim nuk del pesha qe ka secili mall qe do furnizohet dhe rruget qe do te kryeje secili prej mjeteve si dhe duke mos percaktuar nevojen qe ka autoriteti kontraktor per nje tonazh te tille kaq te madhe dhe qe ky tonazh na qenkerka vendimtar, jetik dhe i lidhur shume ngushte me realizimin me sukses te objektit te prokurimit. Kujtojme se pesha me madhe e mallit nuk i kalon 80 kg dhe per keto pesha nuk nevojitet mjet me kapacitet mbajtes me shume se 500 kg. Referuar procesverbalit per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve per kualifikim, gjykojme se autoriteti kontraktor ne asnje rast nuk ka argumentuar ligjerisht e jo me teknikisht, se si keto dy mjetet me kapacitet mbajtes me tonazh minimalisht 1.5 ton dhe 3 ton dhe jo me fjala vjen 500-700 kg, ndikon ne realizimin me sukses te kontrates. Ne kete kuader shoqeria jone gjykon, se autoriteti kontraktor duhet te heqe kerkesen qe mjeti te kete kapacitet mbajtese minimalisht 1.5 ton dhe 3 ton duke e vendosur kete kapacitet ne nje tonazh me te ulet se 1.5 ton, sipas nje grafiku te analizuar qarte dhe sakte teknikisht, keshtu te rritet konkurrenca ndermjet operatoreve ekonomike. Per me teper qe autoriteti ka kerkuar nga operatoret ekonomik te paraqesin deklarate me ane te se ciles ata marrin persiper:
“2.3.6 Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me ane te se ciles merr persiper te kryeje sherbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen neper vende te te gjithe artikujve ne adresen e autoritetit kontraktor, te perfshire ne kete procedure prokurimi.”
45. Pra, nese nje operator deklaron nen pergjegjesin ligjore se i del “per zot” transportit te mallit sipas afatit atehere nuk ka vend per kerkesa te tjera te ekzagjeruara dhe te pa argumentuara.
46. Neni 2 Qellimi i ligjit 162/2020 Per Prokurimin Publik, parashikohet shprehimisht se: “Qellim i ketij ligji eshte: a) te rrise efiçencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik; b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik; dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik.”
47. Neni 3, “Parime te pergjithshme” te ligjit Nr.162/2021 “Per prokurimin publik”,i ndryshuar, parashikohet se:
“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatoret ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore jane te detyruara te zbatojne detyrimet e percaktuara ne legjislacionin mjedisor, social e te punes dhe ne dispozitat e marreveshjeve dhe konventat nderkombetare, te ratifikuara ne perputhje me Kushtetuten.”
48. Ne Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” te ligjit 162/2021 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor eshte pergjegjes per prokurimin ne perputhje me dispozitat e ketij ligji dhe te akteve nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij, duke garantuar respektimin e parimeve te trajtimit te barabarte, transparences, konkurrences dhe mosdiskriminimit, te parashikuara ne kete ligj. Ne kuptim te kesaj pike, autoriteti ose enti

kontraktor ka detyrimin te

mireplanifikoje ne cilesi dhe ne kohe fondet publike e nevojat e tij dhe te prokuroje e te zbatoje kontraten ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.”.

49. Akoma me tej, ne nje procedure te ngashme per nga volumi Komisioni i Prokurimeve Publike i cili merr vendime administrativisht perfundimtare, me ane te Vendimit Nr.454/2024, date 07.05.2024, ka arsyetuar se kerkesat per tonazhe ka te medha duhen hequr pasi kufizojne konkurrencen:

“III.2.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi kerkesen e autoritetit kontrakror qe mjeti i transportit te kete kapacitet mbajtes jo me te vogel se 1 ton, Komisioni i Prokurimit Publik veren se, referuar kritereve te veçanta te kualifikimit, autoriteti kontraktor ka kerkuar nder te tjera se Operatori Ekonomik duhet te deklaroje ne formularin permbledhes te vetedeklarimit se disponon jo me pak se 1 (nje) mjet transporti me kapacitet mbajtes jo me te vogel se 1 ton. Komisioni pas shqyrtimit ne teresi te dokumentacionit te procedures se prokurimit objekt-ankimi, informacionit te dorezuar nga autoriteti kontraktor prane tij, si dhe Procesverbalit “Per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve per kualifikim” konstaton se ky i fundit, ne lidhje me piken 2.3.4 nuk ka dhene asnje argument se ku eshte bazuar ne percaktimin e tonazhit te mjetit te trasportit. Pervec kesaj pike, AK ka kerkuar ne piken 2.3.6 Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje deklarate nga administratori, me ane te se ciles merr persiper te kryeje sherbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen neper vende te te gjithe artikujve ne adresat e autorizuara nga AK ne planin e shperndarjes, bashkelidhur. Referuar kerkesave te sipercituara AK si pergjegjes per dokumentacionin e tenderit duhet te kete parasysh parimin e proporcionaliteti bazuar kjo ne rendesine e procedures se prokurimit, objektin e konrates, llojin e mallrave si edhe sasine, duke percaktuar kritere te thjeshtuara, sic eshte procedura objekt ankimi, per te lehtesuar punen e operatoreve ekonomike dhe rritur pjesmarrjen dhe konkurrencen. Akoma me tej, Komisioni thekson se eshte pergjegjesi e operatoreve ekonomike qe me nenshkrimin e kontrates te realizojne ate me mjete transporti ne kohen e duhur sipas afateve te percaktuara. Me nenshkrimin e kontrates operatori ekonomik eshte subjekti i pare i interesuar ta realizoje ate ne kohe. Persa referuar me siper, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet te rishikoje kriterin 2.3.4 duke modifikuar ate ne lidhje me tonazhin e mjetit te tansportit te mallrave.”

50. Gjithashtu, ne nje procedure te ngashme per nga volumi Komisioni i Prokurimeve Publike i cili merr vendime administrativisht perfundimtare, me ane te Vendimit Nr.357/2024, date 08.04.2024, ka arsyetuar se kerkesat per tonazhe ka te medha duhen hequr pasi kufizojne konkurrencen:

“III3.6. Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit ne teresi te dokumentacionit te procedures se prokurimit objekt- ankimi, informacionit te dorezuar nga autoriteti kontraktor prane KPP, konstaton se ky i fundit, ne procesverbalin, “Per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve per kualifikim”, ne lidhje me piken 2.3.4 Argumentim: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, te VKM nr. 285, date 19.05.2021, “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane ne dispozicion apo qe mund t’i vihen ne dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike per te permbushur kontraten, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit. Referuar specifikimeve te administruara ne dosjen e procedures eshte percaktuar se perveç furnizimit te mallit objekt – prokurimi, do te kryhet transporti dhe vendosja e tyre prane venddorezimit te tyre ne destinacionin perkates, pra per kete arsye eshte e domosdoshme qe operatoret e mundshem ekonomike te paraqesin deshmi mbi pajisjet teknike qe kane ne dispozicion, per te permbushur kontraten objekt - prokurimi. Jane kerkuar dy kamione te pershtatshem per transport mallrash, per te vertetuar qe ofertuesit pjesemarres kane automjetet e nevojshme per transportin e mallrave, kapacitetet organizative, aftesite organizative per te zbatuar kontraten, reputacionin dhe besueshmerine, duke qene se kontrata eshte komplekse me shume artikuj, te cilat duhet te transportohen

dhe te behet furnizim vendosja e tyre sipas shkollave te percaktuara.. Perveç kesaj pike, AK ka kerkuar ne piken 2.3.5. Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me ane te se ciles merr persiper te kryeje sherbimin e transportit, prane Autoritetit Kontraktor. Referuar kerkesave sipercituara, AK si pergjegjes per dokumentacionin e tenderit, duhet te kete parasysh parimin e proporcionaliteti, bazuar kjo ne rendesine e procedures se prokurimit, objektin e konrates, llojin e mallrave, si edhe sasine, duke percaktuar kritere te thjeshtuara siç eshte procedura objekt - ankimi, per te lehtesuar punen e operatoreve ekonomike dhe rritur pjesemarrjen dhe konkurrencen. Akoma me tej, Komisioni thekson, se eshte pergjegjesi e operatoreve ekonomike, qe me nenshkrimin e kontrates, te realizojne proceduren me mjetet e transportit ne kohen e duhur sipas afateve te percaktuara. Me nenshkrimin e kontrates operatori ekonomik eshte subjekti i pare i interesuar ta realizoje ate ne kohe. Operatori ekonomik ne ankesen e tij, argumenton qarte pretendimet per modifikim te kriterit 2.3.4., si kriter diskriminues dhe pengues per operatoret ekonomike. Per sa referuar me siper, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet te rishikoje kriterin 2.3.4, dukee modifikuar ate ne lidhje me tonazhin e mjetit te tansportit te mallrave. Pretendimet e ankimuesit ne lidhje me kriterin 2.3.4 qendrojne."
Nga sa me siper analizuam si edhe bazuar ne vendimin me te fundit te Komisionit te Prokurimeve Publike te referuar me siper, kerkojme modifikimin e kerkeses ne lidhje me tonazhin e mjeteve duke e ulur ate sipas nje plani te detajuar grafik.
III) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
51. 2.3.5 Operatori ekonomik pjesemarres, duhet te kete ne pronesi/qira ose ne perdorim te pakten 1 (nje) ambient per prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt prokurimi
- Per sa me siper operatori ekonomik te paraqes nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

| Nr. | Vendodhja | Statusi |
|---|---|---|
| 1 | | Pronesi/qira/perdorim |

Ne rastin e paraqitjes te kontrates se qirase kontrata te jete e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertes deri ne realizimin e kontrates.
52. Ne neni 77, pika 1 dhe 4 "Kerkesat per kualifikim" te ligjit 162/2020 "Per Prokurimin Publik" parashikohet shprehimisht se: "Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne kerkesat per kualifikim per operatoret ekonomike bazuar ne:
a) pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale;
b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
c) aftesine teknike dhe profesionale.
Kerkesat kufizohen vetem ne ato qe jane te pershtatshme per te garantuar qe nje kandidat ose ofertues te kete kapacitetet juridike, financiare dhe aftesite teknike e profesionale per te zbatuar kontraten qe do te jepet. Te gjitha kerkesat duhet te kene lidhje dhe te jene proporcionale me objektin e kontrates.".
4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie.
Autoritetet ose entet kontraktore, ne veçanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontratat e zbatuara ne te shkuaren.

Aftesia profesionale e operatoreve ekonomike per te ofruar sherbimin, punen, mallin vleresohet ne lidhje me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem per te zbatuar kontraten, siç eshte pershkruar nga autoriteti ose enti

kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates.".
53. Kerkesa e me siperme eshte teresisht e panevojshme persa kohe operatoret ekonomik kane lejen e ushtrimit te aktivitetit dhe eksperiencen e duhur qe jep garanci per realizimin me sukses te kontrates. Autoriteti kontraktor nuk mund te kerkoje dokumentacion i cili ka sherbyer per leshimin e dokumentit final qe ka te beje me lejen e ushtrimit te aktivitetit.
54. Akoma me tej, Komisioni i Prokurimeve Publike i cili merr vendime administrativisht perfundimtare. Ne vendimin Nr.357/2024, date 08.04.2024, KPP ka arsyetuar se duhet hequr kerkesa per Ambient:
"III.2.5 Komisioni i Prokurimit Publik vlereso,n se kriteret per kualifikim vendosen qe t'I sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithçka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Autoriteti kontraktor eshte organi pergjegjes per prokurimin e fondeve publike, ne perputhje me dispozitat ligjore e nenligjore ne fuqi ndaj dhe percaktimi i kritereve te veçanta per kualifikim eshte lene nen pergjegjesine e autoritetit kontraktor, gjithnje ne perputhje e perpjesetim me objektin e natyren e kontrates se prokurimit.
Referuar kritereve te kualifikimit, konstatohet, se eshte kerkuar qe "Kerkesa e mesiperme eshte teresisht e panevojshme per sa kohe operatoret ekonomike kane lejen e ushtrimit te aktivitetit dhe eksperiencen e duhur qe jep garanci per realizimin me sukses te kontrates.
Autoriteti kontraktor nuk mund te kerkoje dokumentacion i cili ka sherbyer per leshimin e dokumentit final qe ka te beje me lejen e ushtrimit te aktivitetit. Per sa me siper, kerkojme heqjen e kesaj kerkese si e panevojshme dhe e paargumentuar.".
Sa me siper, referuar specifikimeve teknike, sasise dhe grafikut te levrimit te mallit, si dhe termave te references, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kerkesa e autoritetit kontraktor per nje 1 (nje) ambient, per prodhimin ose magazinimin e mallrave objekt - prokurimi eshte nje kerkese e ekzagjeruar, jo ne perputhje me objektin dhe natyren e objektit te prokurimit, e cila kufizon pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne kete procedure prokurimi. Gjithashtu, autoriteti kontraktor, ka te drejte te kerkoje furnizime te pjesshme nga operatori ekonomik fitues, dhe eshte detyre e ketij te fundit menaxhimi i kerkesave dhe permbushja ne kohe e tyre, akoma me tej plotesimi i ketij kriteri nuk eshte tregues mbi krijimin e besueshmerise nga ana e autoritetit kontraktor per operatoret ekonomike
pjesemarres, per permbushjen me sukses te kontrates.
Referuar DST dhe kritereve te percaktura nga ana e autoritetit kontraktor verejme se garancine per zbatimin me sukses te kontrates, autoriteti e siguron nepermjet kritereve te tjera te kualifikimit sikurse eshte "pervoja e meparshme e realizuar"..Per autoritetin kontraktor e rendesishme eshte qe operatori ekonomik te vertetoje, se gezon kapacitetet e nevojshme per realizimin e furnizimit dhe nuk mund te percaktoje kritere ne tejkalim te natyres dhe objektit te prokurimit. Sqarojme gjithashtu, se dokumentet e tenderit dhe kriteret per kualifikim, duhet te hartohen ne perputhje me LPP-ne dhe rregullat e prokurimit publik, ne menyre te tille qe te nxisin pjesemarrjen dhe konkurrencen e operatoreve ekonomike, te stimulojne pjesemarrjen e biznesit te vogel dhe te mesem, si dhe te sigurojne nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike pjesemarres ne keto procedura, per realizimin me sukses te kontrates, me qellim zgjerimin e rrethit te pjesemarrjes se operatoreve ekonomike, ne respect te ligjit dhe rregullave per prokurimin publik. Per kete arsye, autoriteti

kontraktor duhet te modifikoje kriterin, duke e hequr kete kerkese. Sa me siper, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qendron."
55. Persa me siper, kerkojme heqjen e kesaj kerkese si e pa nevojshme dhe e pa argumentuar.
IV) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:

56. 2.3.7 Kerkohen te paraqiten kataloge teknike per te gjithe artikujt e ofertuar ku te jene te pasqyruara te gjitha specifikimet teknike te kerkuara per artikujt. Ne kataloge, duhet te shenohet sipas numrit te artikullit ne Formularin e Ofertes dhe te markohen me ngjyre te ndezur (te verdhe), artikujt e ofruar. (Katalogет duhet te ngarkohen ne www.app.gov.al se bashku me dokumentacionin e kerkuar ne keto DT. Pershkrimi teknik duhet te jete i perkthyer ne gjuhen shqipe).
57. SE PARI, nga verifikimi me kujdes i specifikimeve te Karriges rrotulluese drejtuesi me rregullim gjatesie, nuk konstatojme askund fjaline ose ekuivalent, thua se kjo karrige eshte e vetmja ne bote dhe nuk ka prodhues te tjere te karrigeve rrotulluese. Kerkojme ndryshimin e specifikimeve, duke vendosur ne specifikimet teknike fjalin ose ekuivalente.
58. 23. Karrige rrotulluese drejtuesi me rregullim gjatesie
Shtylla vertikale me sklet te perberenga pese kembe , ne forme ylli me pese rrpta rrotulluese ne forme sferike te pershtatura per dysheme me tapete
Zvvendosje pa shkalle te pjeses ku rri ulur , me suste per thellesine dhe mekanizem clodhes , susta perkuljes e rregullueshme sipas peshes se trupit.
Tapiceria e ndjenjeses dhe e mbeshteteses e mbushur me material mbushes sfugjer dhe veshur me cope stof , ngjyra sipas deshires se porositesit me bordura mbrojtese.
Krahet e karriges : Prej plastike , prodhim , furznizim dhe vendosje .
60. Neni 2 “Qellimi i ligjit” 162/2021 “Per prokurimin publik” parashikohet se: Qellim i ketij ligji eshte: a) te rrise efiçencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik; b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik; dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik.

61. Neni 3 Parime te pergjithshme 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatoret ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore jane te detyruara te zbatojne detyrimet e percaktuara ne legjislacionin mjedisor, social e te punes dhe ne dispozitat e marreveshjeve dhe konventat nderkombetare, te ratifikuara ne perputhje me Kushtetuten.
62. Neni 77 “Kerkesat per kualifikim”, te ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne kerkesat per kualifikim per operatoret ekonomike bazuar ne: a) pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftesine teknike dhe profesionale. Kerkesat kufizohen vetem ne ato qe jane te pershtatshme per te garantuar qe nje kandidat ose ofertues te kete kapacitetet juridike, financiare dhe aftesite teknike e profesionale per te zbatuar kontraten qe do te jepet. Te gjitha kerkesat duhet te kene lidhje dhe te jene proporcionale me objektin e kontrates. 4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie”.
63. Ne nenin 40 pika 1, 2 dhe 6 te VKM Nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimmisht se: “1. Ne procedurat e prokurimit per mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasine e mallrave qe do te levroje, si dhe grafikun e levrimit te mallrave. 2. Per mallrat qe do te prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojne specifikimet teknike, te cilat duhet te pershkruajne minimumin ose teresine e elementeve me te rendesishme perberese, qe garantojne cilesine e kerkuar, ne perputhje me nenin 36, te LPPse, dhe qe i vlereson mallrat si te pranueshme per funksionet e kerkuara. 3. Autoriteti/enti kontraktor mund

t’u kerkoje operatoreve ekonomike te dorezojne deshmi, qe tregojne se ata i plotesojne kerkesat minimale, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si: a) mostra te mallit, kur e gjykon se kjo ka rendesi per vleresimin e ofertes teknike. N? k?t? rast, autoriteti/enti kontraktor duhet t? argumentoj? k?rkes?n p?r mostrat. Mostrat duhet te trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet te jene ne kontroll te autoritetit/entit kontraktor. N? rastin e procedurave t? zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor p?rcakton qart? procedur?n p?r dor?zimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori t? interesuar si dhe konfidencialitetin p?r pjes?marrjen n? proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesen e tij, brenda 30 (tridhjete) diteve pas nenshkrimit te kontrates, me kusht qe kontrata ne fjale te mos jete objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqesor. Ne rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesen e tij, brenda 30 (tridhjete) diteve nga data e marrjes se vendimit perfundimtar te anulimit; dhe/ose b) fotografite apo katalogет teknike; dhe/ose c) deshmi per rezultatet e testimeve zyrtare, te leshuara nga institucione te autorizuara, qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike.”

64. Ne nenin 36 “Specifikimet teknike” te ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “1. Specifikimet teknike, siç percaktohen ne nenin 4 te ketij ligji, duhet te pershkruhen ne dokumentet e tenderit. Ne specifikimet teknike percaktohen qarte karakteristikat e puneve, sherbimit ose furnizimit qe do te prokurohet. Keto karakteristika mund te lidhen edhe me procesin specifik ose metoden e prodhimit ose ofrimit te puneve, furnizimeve ose sherbimeve te kerkuara ose me nje proces specifik per nje faze tjeter te ciklit jetesor edhe kur keta faktore nuk perbejne permbajtjen e saj thelbesore nese ato jane te lidhura me objektin e kontrates dhe proporcionale me vleren dhe objektivat e saj. Ne specifikimet teknike mund te specifikohet edhe nese do te jete i nevojshem transferimi i te drejtave te pronesise intelektuale. Specifikimet teknike, me perjashtim te rasteve te justifikuara plotesisht, hartohen



ne menyre te tille qe te marrin ne konsiderate kriteret e aksesueshmerise per personat me aftesi te kufizuar ose projektimit per te gjithe perdoruesit, sipas kerkesave ne legjislacionin ne fuqi. 2. Specifikimet teknike duhet te mundesojne trajtim te barabarte per te gjithe kandidatet dhe ofertuesit dhe te mos sherbejne si pengesa per konkurrencen e hapur ne prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet te pershkruajne qarte kerkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kerkesave funksionale ose te performances, perfshire karakteristikat mjedisore, me kusht qe parametrat te jene te sakte ne menyre qe t’u japin mundesi ofertuesve te percaktojne objektin e kontrates dhe autoriteteve ose enteve kontraktore te japin kontraten; b) standardeve kombetare, qe mbeshteten ne ato nderkombetare, miratimeve teknike nderkombetare, specifikimeve teknike te pergjithshme, standardeve nderkombetare apo sistemeve te tjera teknike te referimit, te percaktuara nga organet nderkombetare te standardizimit. Kur keto nuk ekzistojne, ato u referohen standardeve kombetare, miratimeve teknike kombetare ose specifikimeve teknike kombetare, qe lidhen me projektimin, perllogaritjen dhe ekzekutimin e puneve ose perdorimin e produkteve; c) kerkesave ne terma funksionale sipas shkronjes “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjes “b” te kesaj pike, si menyre qe nenkupton pajtueshmeri me kerkesat funksionale; ç) te dyja metodave te percaktuara ne shkronjat “a” dhe “b” te pikes 3 te ketij neni, per mallra, sherbime ose pune te ndryshme, te perfshira ne te njejtin objekt kontrate. Çdo reference duhet te shoqerohet nga fjalet “ose ekuivalenti i tij/saj”. 4. Ne specifikimet teknike, nese nuk e justifikon objekti i kontrates, nuk duhet te permendet asnje marke prodhimi ose burim specifik apo proces i veçante, qe karakterizon produktet ose sherbimet e ofruara nga nje operator ekonomik specifik apo asnje marke tregtare, patente, tipi ose origjine apo prodhim specifik, me qellim favorizimin ose eliminimin e disa

65. Kriteret per kualifikim vendosen qe t’i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit ekonomik per permbushje me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj, autoriteti kontraktor percakton kerkesat e veçanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t’u permbushur nga operatoret

ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit. Operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentet e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumente duhet te refuzohen si te papranueshme.
Gjithashtu, nje nder parimet kryesore te zhvillimit te procedures se prokurimit eshte ai barazise ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik”. Zbatimi i parimit te transparences, barazise dhe mosdiskriminimit, jane garancite kyçe ndaj ofertuesve qe ofron kuadri ligjor ne fuqi. Keto parime nder te tjera nenkuptojne, se operatoret ekonomike duhet te jene ne nje pozicion barazie, si kur pergatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur te vleresohen ato. Operatoret ekonomike pjesemarres ne proceduren e prokurimit, me dokumentacionin e dorezuar, duhet te vertetojne, qe produkti i ofruar eshte ne perputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kerkuara nga autoriteti kontraktor. Operatoret ekonomike ofertues marrin persiper permbushjen e specifikimeve teknike/kritereve te percaktuara ne dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nepermjet deklaratave dhe dokumentacionit provues ne te cilin duhet te faktojne perputhshmerine e dokumentacionit me kriteret e percaktuara nga autoriteti kontraktor, ne menyre qe nga ana e ketij te fundit te mund te kryhet me lehtesi e saktesi vleresimi i mallrave apo sherbimeve te ofertuara nga operatoret ekonomike pjesemarres, duke perzgjedhur ate ofertues i cili me dokumentacionin e dorezuar garanton perputhshmerine me kriteret e percaktuara ne DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses te kontrates objekt-prokurimi.
66. Vlen te theksojme se, ne respekt te parimeve te ligjit per prokurimin publik, specifikimet teknike te hartuara nga autoriteti kontraktor, ne asnje rast nuk duhet te diskriminojne /perjashtojne nga konkurrimi operatoret ekonomike ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin keta kombetar apo nderkombetare. Ne hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet te shmangin çdo forme diskriminimi, qofte ato te dukshme, qofte ato te fshehta, te cilat kane

te njejtin efekt. Ne asnje rast, specifikimet teknike nuk duhet te hartohen ne menyre qe te drejtojne drejt nje produkti/malli/sherbimi, qe ofrohen nga nje operator i vetem ekonomik ose nga nje prodhues i vetem.
67. Modifikimi eshte shume i domosdoshem, pasi sic do te shohim me poshte ka shume llojesh karrigesh zyrash drejtuesi, te prodhuara sigurisht nga prodhues te tjere, te cilet nuk duhet te perjashtohen nga e drejta per te ofertuar me to:
68. Nga sa me siper, del qarte se karriget e drejtuesve prodhohen ne disa lloje, perfshi ketu edhe ato me kembe jo plastike por me metalike, krahet e karriges prej metali me mbeshtetese sfungjeri, me kembe druri, me krahet e karriges prej druri, etj etje dhe kjo nuk mund dhe nuk duhet te perjashtoj nga konkurrimi nje game shume here me te madhe se karriget qe kemi sjelle per shembush.
69. Theksojme se nga kerkimet qe beme ne, rezulton se Karrigja e kerkuar nga autoriteti kontraktor e ka nje shites dhe rrjedhimisht nje prodhues i caktuar, cka eshte teresisht ne shkelje te hapur te dispozitave ligjore te referuar me siper. Konkretisht, linku https://www.techly.com/easy-office-chair-red.html te njerre direkt ne Karrigen e kerkuar nga autoriteti kontraktor ne Specifikimet Teknike:

70. Akoma me tej, po ne linkun perkates ne Rubriken “Data sheet” del edhe emri i prodhuesit te kesaj karrige cili eshte TECHLY:

TECHLY - PROPERTY OF IC INTRACOM ITALIA S.P.A. TAX CODE 09228790151 R.E.A. 47752 - VAT ID IT01191370939 FULLY PAID SHARE CAPITAL 150.000,00 EURO IC INTRACOM ITALIA SPA 2016 ? ALL RIGHTS RESERVED
TECHLY- PRONA E IC INTRACOM ITALIA S.P.A. KODI TATIMOR 09228790151 R.E.A. 47752 - ID e TVSH-se IT01191370939
KAPITALI AKSIONAL I PAGUAR PLOTESISHT 150.000,00 EURO IC INTRACOM ITALIA SPA 2016 ? TE GJITHA TE DREJTAT E REZERVUARA

71. Nga sa me siper analizuar, kerkojme ndryshimin e specifikimeve teknike duke vendosur fjalen ose ekuivalent, si ne vijim:
Shtylla vertikale me sklet te perberenga pese kembe , ne forme ylli me pese rrpta rrotulluese ne forme sferike te pershtatura per dysheme me tapete OSE EKUIVALENTE
Zvvendosje pa shkalle te pjeses ku rri ulur , me suste per thellesine dhe mekanizem clodhes , susta perkuljes e rregullueshme sipas peshes se trupit. OSE EKUIVALENTE
Tapiceria e ndjenjeses dhe e mbeshteteses e mbushur me material mbushes sfugjer dhe veshur me cope stof , ngjyra sipas deshires se porositesit me bordura mbrojtese. OSE EKUIVALENTE
Krahet e karriges : Prej plastike , prodhim , furznizim dhe vendosje OSE EKUIVALENTE.
V) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
72. 2.3.8 Ofertuesi duhet te paraqese:
Certifikate ISO 9001:2015 ose ekuivalente, ”Per Sistemin e menaxhimit te cilesise”,
(Certifikata te jete leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, per tregtim dhe/ose prodhim te mobiljeve, per artikujt e mobilimit te ofertuara.)
Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Certifikate ISO 9001:2015 ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
73. Argumentimi: Kerkesa e mesiperme bazohet ne nenin 77, pika 1/a dhe 2, nenin 79 te LPP, nenit 40, pika 8, dhe 44, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.
Legjislacioni ne fuqi per prokurimin publik i jep mundesine autoriteteve kontraktore qe te kerkojne certifikime nga organe te pavarura te njohura nga sistemet e standardizimit kombetar

ose nderkombetar, ne menyre qe te vertetojne se mallrat objekt prokurimi dhe sherbimet lidhur me to, i plotesojne kerkesat e cilesise.
Autoriteti kontraktor, duke qene se eshte perfituesi direkt i kontrates objekt prokurimi, eshte ne te drejten e tij te garantohet se operatoret ekonomike pjesemarres i plotesojne kerkesat e cilesise per furnizimin qe do te kryhejne, e rrjedhimisht eshte e drejte e ketij te fundit t’u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga organe te pavarura te njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombetar ose Nderkombetar, referuar nenit 79 te ligjit 162/2020.
Qe te realizohet me cilesi dhe konform standarteve procedura, objekt prokurimi, operatori duhet te jete i çertifikuar me çertifikaten ISO te menaxhimit si me siper, te cilat ne rastin konkret vleresohen te nevojshme persa i perket cilesise dhe sigurise, pasi deshmon se sistemi i administrimit te operatorit ekonomik te çertifikuar i pergjigjet asaj qe kerkohet nga Autoriteti Kontraktor. Pra konsiderohet si kriter i lidhur ngushtesisht me objektin e kontrates qe prokurohet dhe i bazuar ne LPP.
74. Ne nenin 44 i VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, nuk permend me asnje vend qe operatoret ekonomik duhet te ngarkohen me barre qe te detyrojne prodhuesin qe t’iu veri ne dispozicion Certifikatat ISO. Theksojme se Prodhuesi eshte person juridik i trete, qe nuk eshte pjestare ne gare, per pasoje autoriteti kontraktor nuk mund te detyroje operatoret ekonomik qe duan te marrin pjese ne gare te paraqesin ISO te Prodhuesit.
75. Ne nenin “Kerkesat e cilesise” te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, theksohet se:
“1. Autoriteti/enti kontraktor, per te vertetuar se punet, mallrat ose sherbimet, objekt prokurimi, i plotesojne kerkesat e cilesise, mund t’u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise, vetem nese ato jane te argumentuara dhe te lidhura ngushtesisht dhe ne menyre te drejtperdrejte me objektin e prokurimit.

2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se.
Kjo dispozite zbatohet edhe kur kerkesat teknike u referohen kualifikimeve te kandidatit ose te ofertuesit.
3. Certifikatat dhe etiketat e kerkuara duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me objektin e kontrates, si dhe çdo operator ekonomik duhet t? ket? akses n? to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.
4. N?se autoriteti/enti kontraktor k?rkojn? nj? certifikat?, ose etiket?, ata jan? t? detyruar t? pranojn? çdo certifikat? ose etiket? ekuivalente/ t? barasvlershme me t?, ose nj? dokument q? provon t? nj?jtin informacion.
5. Kur eshte e dukshme qe nje operator ekonomik e ka te pamundur te marre etiketen specifike, te cilesuar nga autoriteti/enti kontraktor ose nje etikete ekuivalente, brenda afateve kohore perkatese, per shkaqe qe nuk lidhen me ate operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon menyra te tjera vertetimi te pershtatshme, qe mund te perfshijne nje dosje teknike nga prodhuesi, nese operatori

ekonomik ne fjale verteton se punet, furnizimet ose sherbimet qe ai duhet te ofrojne permbushin kerkesat e etiketes specifike ose kerkesat specifike te cilesuara nga autoriteti/enti kontraktor."
76. Pra, kerkesa per ISO, duhet te kufizohet vetem te operatoret ekonomik. Nga ana tjeter, dispozita ligjore e referuar me siper, thekson qarte se ofertuesit duhet te kene akses ne certifikatat e kerkuara sic eshte rasti i ISO se Prodhuesit, duke respektuar keshtu parimin e mosdiskriminimit. Pra, autoriteti kontraktor mund te detyroje operatoret ekonomik te paraqesin certifikimet e tyre per te cilat kane akses, por kurrsesi nuk mund te kerkoje certifikatat e prodhuesve te cilet ndoshta nuk certifikohen fare apo ndoshta nuk deshirojne te japin certifikatat Iso te bleresit.
Per sa analizuam me siper, kerkojme heqjen e kerkeses qe detyron operatoret ekonomik te paraqesin Certifikatat ISO te Prodhuesit.
VI) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
77. Certifikate ISO 14001:2015 "Sistemi i menaxhimit te mjedisit" ose ekuivalente.
(Certifikata te jete leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, per tregtim dhe/ose prodhim te mobiljeve, per artikujt e mobilimit te ofertuara.)
Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Certifikate ISO 14001:2015 ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata te jete brenda afatit te vlefshmerise, ne gjuhen shqipe ose te perkthyera dhe te noterizuara.
78. SE PARI, ne nenin 44 i VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", nuk permend askund Certifikata per Menaxhim Mjedisi. Ne kete dispozite eshte specifikuar shume qarte se autoriteti kontraktor mund te kerkoje per Mallrat dhe Sherbimet, Certifikata te Cilsise.
79. Ne nenin 44 "Kerkesat e cilesise" te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", theksohet se:
"1. Autoriteti/enti kontraktor, per te vertetuar se punet, mallrat ose sherbimet, objekt prokurimi, i plotesojne kerkesat e cilesise, mund t'u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise, vetem nese ato jane te argumentuara dhe te lidhura ngushtesisht dhe ne menyre te drejtperdrejte me objektin e prokurimit.

2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se.
Kjo dispozite zbatohet edhe kur kerkesat teknike u referohen kualifikimeve te kandidatit ose te ofertuesit.
3. Certifikatat dhe etiketat e kerkuara duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me objektin e kontrates, si dhe çdo operator ekonomik duhet t? ket? akses n? to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

4. N?se autoriteti/enti kontraktor k?rkojn? nj? certifikat?, ose etiket?, ata jan? t? detyruar t? pranojn? çdo certifikat? ose etiket? ekuivalente/ t? barasvlershme me t?, ose nj? dokument q? provon t? nj?jtin informacion.
5. Kur eshte e dukshme qe nje operator ekonomik e ka te pamundur te marre etiketen specifike, te cilesuar nga autoriteti/enti kontraktor ose nje etikete ekuivalente, brenda afateve kohore perkatese, per shkaqe qe nuk lidhen me ate operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon menyra te tjera vertetimi te pershtatshme, qe mund te perfshijne nje dosje teknike nga prodhuesi, nese operatori ekonomik ne fjale verteton se punet, furnizimet ose sherbimet qe ai duhet te ofrojne permbushin kerkesat e etiketes specifike ose kerkesat specifike te cilesuara nga autoriteti/enti kontraktor."
80. Nderkohe, ne piken 2 te Nenit 44 "Kerkesat e cilesise" te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", ligjvenesi ka lene nje hapsire per autoritetin kontraktor qe te kerkoje etiketa, kur prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera:
"2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se."
81. Pra, ligjvenesi nuk i ka lene dore te lire autoritetit kontraktor me qellim qe te shmangi kerkesat abuzive dhe aspak te argumentuara sic eshte kerkesa per ISO 14001:2015 "Sistemi i menaxhimit te mjedisit". Autoriteti kontraktor nuk po prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, perndryshe ne do ta kuptonim kerkesen. Ne procedure objekt ankese nuk ka asnje mall apo sherbim te cilat paskerkan karakteristika specifike Mjedisore.
82. Referuar Argumentimit te Kritereve te Kualifikimit, rezulton qartesisht se autoriteti nuk ka arritur dot ta mbeshtese ne ligj kerkesen dhe nuk ka arritur te argumentoje se perse kerkon nje ISO te tille. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka theksuar se:
Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Ky kriter eshte i lidhur ngushte me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale dhe respektimin e rregullave te mbrojtjes dhe sigurise ne pune nga OE pjesemarres.
Kriteri vendoset per rastin kur OE eshte prodhues vendor, si nje kerkese e shtuar per garantimin e zbatimit te kontrates ne cilesine dhe ne afatin e kerkuar nga AK.
Certifikatat per menaxhimin e sistemit te sigurise ne pune dhe menaxhimin e mjedisit nga keto OE, kane lidhje me kerkesat per zbatimin e standarteve, dhe jane vendosur ne perputhje me rekomandimin e APP nr. 3341/1 date 20.03.2018 "Mbi hartimin e kritereve per kualifikim ne DT te procedurave te prokurimit".

83. Referuar dispozitave ligjore ku eshte bazuar autoriteti kontraktor per hartimin e kriterit

kualifikues, del qarte se asnje dispozite prej tyre nuk i jep te drejte autoritetit qe te kerkoje Certifikat ISO.
84. Nga ana tjeter, si baze ligjore ne vendosjen e kerkeses per ISO, autoriteti i referohet rekomandimit te APP nr. 3341/1 date 20.03.2018 “Mbi hartimin e kritereve per kualifikim ne DT te procedurave te prokurimit”., ne te cilin ne asnje pike nuk i rekomandon autoritetet kontraktore qe te “Cmenden” dhe te kerkojne cfardo ISO qe egziston ne planet, por perkundrazi i orienton ata per procedurat e prokurimit per Punet Publike si dhe i’u kerkon autoriteteve qe te mos kerkojne certifikata ISO te cilat nuk jane te lidhura me objektin qe prokurojne duke respektuar parimin e mosdiskriminimit.
85. Persa analizuam me siper, del qarte se kerkesa e autoritetit kontraktor per Certifikaten ISO 14001:2015 “Sistemi i menaxhimit te mjedisit”., nuk lidhet aspak me objektin e kontrates dhe procedures se prokurimit, nuk eshte aspak e argumentuar, per pasoje kerkojme heqjen e ketij kriteri. Per me teper, qe operatoret jane te pajisur me leje mjedisi nga Ministria e linjes.
86. SE DYTI, ne ne lidhje me kerkesen “Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Certifikate ISO 14001:2015 ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata te jete brenda afatit te vlefshmerise, ne gjuhen shqipe ose te perkthyera dhe te noterizuara”., vlen argumenti i dhene me siper keshtu nuk do te bjeme perseritje.
Persa me siper, kerkojme heqjen e kerkeses qe detyron operatoret ekonomik te paraqesin Certifikatat ISO te Prodhuesit.
VII) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
87. Ofertuesi duhet te paraqese Çertifikate ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit te sigurise dhe shendetit ne pune” ose ekuivalente.
Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Çertifikate ISO 45001:2018 ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
88. SE PARI, ne nenin 44 i VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, nuk permend askund Certifikata per Menaxhim te Sigurise dhe shendetit ne Pune. Per me teper, qe ne nuk jemi shoqeri ndertimi pra nuk ofrojme pune por mall dhe sherbim. Pavaresisht kesaj, ne dispoziten ligjore te referuar me siper, eshte specifikuar qarte se autoriteti kontraktor mund te kerkoje per Mallrat dhe Sherbimet, Certifikata te Cilsise.
89. Ne nenin 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, theksohet se:

“1. Autoriteti/enti kontraktor, per te vertetuar se punet, mallrat ose sherbimet, objekt prokurimi, i plotesojne kerkesat e cilesise, mund t’u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise, vetem nese ato jane te argumentuara dhe te lidhura ngushtesisht dhe ne menyre te drejtperdrejte me objektin e prokurimit.
2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se.
Kjo dispozite zbatohet edhe kur kerkesat teknike u referohen kualifikimeve te kandidatit ose te ofertuesit.
3. Certifikatat dhe etiketat e kerkuara duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me objektin e kontrates, si dhe çdo operator ekonomik duhet t? ket? akses n? to, duke respektuar edhe

parimin e mosdiskriminimit.
4. N?se autoriteti/enti kontraktor k?rkojn? nj? certifikat?, ose etiket?, ata jan? t? detyruar t? pranojn? çdo certifikat? ose etiket? ekuivalente/ t? barasvlershme me t?, ose nj? dokument q? provon t? nj?jtin informacion.
5. Kur eshte e dukshme qe nje operator ekonomik e ka te pamundur te marre etiketen specifike, te cilesuar nga autoriteti/enti kontraktor ose nje etikete ekuivalente, brenda afateve kohore perkatese, per shkaqe qe nuk lidhen me ate operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon menyra te tjera vertetimi te pershtatshme, qe mund te perfshijne nje dosje teknike nga prodhuesi, nese operatori ekonomik ne fjale verteton se punet, furnizimet ose sherbimet qe ai duhet te ofrojne permbushin kerkesat e etiketes specifike ose kerkesat specifike te cilesuara nga autoriteti/enti kontraktor."
90. Nderkohe, ne piken 2 te Nenit 44 "Kerkesat e cilesise" te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", ligjvenesi ka lene nje hapsire per autoritetin kontraktor qe te kerkoje etiketa, kur prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera:
"2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se."
91. Pra, ligjvenesi nuk i ka lene dore te lire autoritetit kontraktor me qellim qe te shmangi kerkesat abuzive dhe aspak te argumentuara sic eshte kerkesa per ISO 45001:2018 "Sistemi i menaxhimit te sigurise dhe shendetit ne pune". Autoriteti kontraktor nuk po prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike te sigurise dhe shendetit ne pune, perndryshe ne do ta kuptonim kerkesen. Ne procedure objekt ankese nuk ka asnje mall apo sherbim te cilat karakteristika specifike te sigurise dhe shendetit ne pune.

92. Referuar Argumentimit te Kritereve te Kualifikimit, rezulton qartesisht se autoriteti nuk ka arritur dot ta mbeshtese ne ligj kerkesen dhe nuk ka arritur te argumentoje se perse kerkon nje ISO te tille. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka theksuar se:
Argumentimi: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Ky kriter eshte i lidhur ngushte me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale dhe respektimin e rregullave te mbrojtjes dhe sigurise ne pune nga OE pjesemarres.
Kriteri vendoset per rastin kur OE eshte prodhues vendor, si nje kerkese e shtuar per garantimin e zbatimit te kontrates ne cilesine dhe ne afatin e kerkuar nga AK.
Certifikatat per menaxhimin e sistemit te sigurise ne pune dhe menaxhimin e mjedisit nga keto OE, kane lidhje me kerkesat per zbatimin e standarteve, dhe jane vendosur ne perputhje me rekomandimin e APP nr. 3341/1 date 20.03.2018 "Mbi hartimin e kritereve per kualifikim ne DT te procedurave te prokurimit".
93. Referuar dispozitave ligjore ku eshte bazuar autoriteti kontraktor per hartimin e kriterit kualifikues, del qarte se asnje prej tyre nuk i jep te drejte autoritetit qe te kerkoje Certifikat ISO.
94. Nga ana tjeter, si baze ligjore ne vendosjen e kerkeses per ISO, autoriteti i referohet rekomandimit te APP nr. 3341/1 date 20.03.2018 "Mbi hartimin e kritereve per kualifikim ne DT te procedurave te prokurimit"., ne te cilin ne asnje pike nuk i rekomandon autoritetet kontraktore qe te "Cmenden" dhe te kerkojne cfardo ISO qe ekziston, por perkundrazi i orienton ata per procedurat e prokurimit per Punet Publike si dhe i'u kerkon autoriteteve qe te mos kerkojne certifikata ISO te cilat nuk jane te lidhura me objektin qe prokurojne duke respektuar parimin e mosdiskriminimit.
95. Persa analizuam me siper, del qarte se kerkesa e autoritetit kontraktor per Certifikaten ISO

45001:2018 “Sistemi i menaxhimit te sigurise dhe shendetit ne pune”., nuk lidhet aspak me objektin e kontrates dhe procedures se prokurimit, nuk eshte aspak e argumentuar, per pasoje kerkojme heqjen e ketij kriteri.
96. SE DYTI, ne ne lidhje me kerkesen Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Certifikate ISO 45001:2018 “Sistemi i menaxhimit te sigurise dhe shendetit ne pune”ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Çertifikata te jete brenda afatit te vlefshmerise, ne gjuhen shqipe ose te perkthyera dhe te noterizuara., vlene argumenti i dhene me siper keshtu nuk do te bjeme perseritje.
Persa me siper, kerkojme heqjen e kerkeses qe detyron operatoret ekonomik te paraqesin Certifikatat ISO te Prodhuesit.

VIII) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
97. Ofertuesi duhet te paraqese Çertifikate sipas standartit EN ISO 28001 - 2007 per “zinxhirin e furnizimit” ose ekuivalente.
Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Çertifikate sipas standartit EN ISO 28001 - 2007 ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
98. Certifikata sipas standartit EN ISO 28001 – 2007, eshte referuar si sistemi i menaxhimit te sigurise se zinxhirit te furnizimit dhe ne shume sektore te zinxhirit te furnizimit mund te thyejne ose natyren ne problemet e sigurise publike ndikojne negativisht ne organizimin e tyre. Rreziqe te tilla duhet te identifikohen ne zinxhirin e furnizimit per organizatat dhe t'i menaxhojne keto rreziqe ne menyre efikase ne nje diagnoze te madhe te sakte.
ISO 28001:2007 Sistemi i Menaxhimit te Sigurise se Zinxhirit te Furnizimit eshte nje standard nderkombetar, ISO 28001 percakton kerkesat e sistemit te menaxhimit te sigurise se zinxhirit te furnizimit
99. SE PARI, ne nenin 44 i VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, nuk permend askund Certifikata te tilla. Per me teper, qe kjo ISO ka tebeje me Sigurine e Furnizimit qe nuk ka asnje pike lidhje me shoqerite e Mobiljeve. Pavaresisht kesaj, ne dispoziten ligjore te referuar me siper, eshte specifikuar qarte se autoriteti kontraktor mund te kerkoje per Mallrat dhe Sherbimet, Certifikata te Cilsise dhe cdo certifikat te mundshme qe ka pare ne enderr personi qe ka hartuar keto kritee apo subjekti qe ia ka ofruar keto lloj kriteresh te cilat e bejne te pa mundur pjesmarrjen ne gare lirisht sikunder marrim pjese ne autoritete te tjera.
100. Ne nenin 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, theksohet se:
“1. Autoriteti/enti kontraktor, per te vertetuar se punet, mallrat ose sherbimet, objekt prokurimi, i plotesojne kerkesat e cilesise, mund t’u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise, vetem nese ato jane te argumentuara dhe te lidhura ngushtesisht dhe ne menyre te drejtperdrejte me objektin e prokurimit.
2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se.
Kjo dispozite zbatohet edhe kur kerkesat teknike u referohen kualifikimeve te kandidatit ose te ofertuesit.

3. Certifikatat dhe etiketat e kerkuara duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me objektin e kontrates, si dhe çdo operator ekonomik duhet t? ket? akses n? to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.
4. N?se autoriteti/enti kontraktor k?rkojn? nj? certifikat?, ose etiket?, ata jan? t? detyruar t? pranojn? çdo certifikat? ose etiket? ekuivalente/ t? barasvlershme me t?, ose nj? dokument q? provon t? nj?jtin informacion.
5. Kur eshte e dukshme qe nje operator ekonomik e ka te pamundur te marre etiketen specifike, te cilesuar nga autoriteti/enti kontraktor ose nje etikete ekuivalente, brenda afateve kohore perkatese, per shkaqe qe nuk lidhen me ate operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon menyra te tjera vertetimi te pershtatshme, qe mund te perfshijne nje dosje teknike nga prodhuesi, nese operatori ekonomik ne fjale verteton se punet, furnizimet ose sherbimet qe ai duhet te ofrojne permbushin kerkesat e etiketes specifike ose kerkesat specifike te cilesuara nga autoriteti/enti kontraktor."
101. Nderkohe, ne piken 2 te Nenit 44 "Kerkesat e cilesise" te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", ligjvenesi ka lene nje hapsire per autoritetin kontraktor qe te kerkoje etiketa, kur prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera:
"2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se."
102. Pra, ligjvenesi nuk i ka lene dore te lire autoritetit kontraktor me qellim qe te shmangi kerkesat abuzive dhe aspak te argumentuara sic eshte kerkesa e kualifikimit per EN ISO 28001 - 2007 per "Sistemet e menaxhimit te sigurise per zinxhirin e furnizimit - Praktikat me te mira per zbatimin e sigurise se zinxhirit te furnizimit, vleresimet dhe planet - Kerkesat dhe udhezimet". Autoriteti kontraktor nuk po prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike te Sistemet e menaxhimit te sigurise per zinxhirin e furnizimit - Praktikat me te mira per zbatimin e sigurise se zinxhirit te furnizimit, vleresimet dhe planet - Kerkesat dhe udhezimet, perndryshe ne do ta kuptonim kerkesen. Ne proceduren objekt ankese nuk ka asnje mall apo sherbim te cilat karakteristika specifike te Sistemet e menaxhimit te sigurise per zinxhirin e furnizimit - Praktikat me te mira per zbatimin e sigurise se zinxhirit te furnizimit, vleresimet dhe planet - Kerkesat dhe udhezimet.
103. Referuar Argumentimit te Kritereve te Kualifikimit, rezulton qartesisht se autoriteti nuk ka arritur dot ta mbeshtese ne ligj kerkesen dhe nuk ka arritur te argumentoje se perse kerkon nje ISO te tille. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka theksuar se:
Argumentim: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Ky kriter eshte i lidhur ngushte me aftesine zbatuese te kontrates, me garantimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale dhe respektimin e rregullave te mbrojtjes dhe sigurise ne pune nga OE pjesemarres.

104. Referuar dispozitave ligjore ku eshte bazuar autoriteti kontraktor per hartimin e kriterit kualifikues, del qarte se asnje prej tyre nuk i jep te drejte autoritetit qe te kerkoje Certifikat ISO.
105. Persa analizuam me siper, del qarte se kerkesa e autoritetit kontraktor per Certifikaten EN ISO 28001 - 2007 per "Sistemet e menaxhimit te sigurise per zinxhirin e furnizimit - Praktikat me te mira per zbatimin e sigurise se zinxhirit te furnizimit, vleresimet dhe planet - Kerkesat dhe udhezimet", nuk lidhet aspak me objektin e kontrates dhe procedures se prokurimit, nuk eshte aspak e argumentuar, per pasoje kerkojme heqjen e ketij kriteri.
106. SE DYTI, ne ne lidhje me kerkesen "Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Çertifikate sipas standartit EN ISO 28001 - 2007 ose ekuivalente, per prodhuesin e

deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise", vlene argumenti i dhene me siper keshtu nuk do te bjeme perseritje.
Persa me siper, kerkojme heqjen e kerkeses qe detyron operatoret ekonomik te paraqesin Certifikatat ISO te Prodhuesit.
IX) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
107. Ofertuesi duhet te paraqese Çertifikate ISO 22301-2012 (e vlefshme) per "Sistemit te Menaxhimit te Vazhdimesise se Biznesit"ose ekuivalente.
Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Çertifikate ISO 22301-2012(e vlefshme) ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
108. SE PARI, ne nenin 44 i VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", nuk permend askund Certifikata te tilla. Per me teper, qe kjo ISO ka te beje me "Siguria shoqerore - Sistemet e menaxhimit te vazhdimesise se biznesit – Kerkesat" qe nuk ka asnje pike lidhje me shoqerite ne Shqiperi te cilat jane rregulluar nga nje kuader ligjor perkates. Pavaresisht kesaj, ne dispoziten ligjore te referuar me siper, eshte specifikuar qarte se autoriteti kontraktor mund te kerkoje per Mallrat dhe Sherbimet, Certifikata te Cilsise dhe cdo certifikat te mundshme qe ja ka futur kot personi qe ka hartuar keto kritere apo subjekti qe ia ka ofruar keto lloj kriteresh te cilat e bejne te pa mundur pjesmarrjen ne gare lirisht sikunder marrim pjese ne autoritete te tjera. Kerkojme nga KPP qe te pergatise nje medalje per kete person dhe ta dergoje prane APP-se qe tia dorezojne vete me doren e tyre, madje ti japin edhe nje bonus pasi eshte lodhur, ka vrare mendjen per te gjetur certifikatat ISO qe ekzistojne ne bote.
109. Ne nenin 44 "Kerkesat e cilesise" te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", theksohet se:
"1. Autoriteti/enti kontraktor, per te vertetuar se punet, mallrat ose sherbimet, objekt prokurimi, i plotesojne kerkesat e cilesise, mund t'u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga nje

organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise, vetem nese ato jane te argumentuara dhe te lidhura ngushtesisht dhe ne menyre te drejtperdrejte me objektin e prokurimit.
2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se.
Kjo dispozite zbatohet edhe kur kerkesat teknike u referohen kualifikimeve te kandidatit ose te ofertuesit.
3. Certifikatat dhe etiketat e kerkuara duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me objektin e kontrates, si dhe çdo operator ekonomik duhet t? ket? akses n? to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.
4. N?se autoriteti/enti kontraktor k?rkojn? nj? certifikat?, ose etiket?, ata jan? t? detyruar t? pranojn? çdo certifikat? ose etiket? ekuivalente/ t? barasvlershme me t?, ose nj? dokument q? provon t? nj?jtin informacion.
5. Kur eshte e dukshme qe nje operator ekonomik e ka te pamundur te marre etiketen specifike, te cilesuar nga autoriteti/enti kontraktor ose nje etikete ekuivalente, brenda afateve kohore perkatese, per shkaqe qe nuk lidhen me ate operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon menyra te tjera vertetimi te pershtatshme, qe mund te perfshijne nje dosje teknike nga prodhuesi, nese

operatori ekonomik ne fjale verteton se punet, furnizimet ose sherbimet qe ai duhet te ofrojne permbushin kerkesat e etiketes specifike ose kerkesat specifike te cilesuara nga autoriteti/enti kontraktor."

110. Nderkohe, ne piken 2 te Nenit 44 "Kerkesat e cilesise" te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", ligjvenesi ka lene nje hapsire per autoritetin kontraktor qe te kerkoje etiketa, kur prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera:

"2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se."

111. Pra, ligjvenesi nuk i ka lene dore te lire autoritetit kontraktor me qellim qe te shmangi kerkesat abuzive dhe aspak te argumentuara sic eshte kerkesa e kualifikimit ne fjale "Siguria shoqerore - Sistemet e menaxhimit te vazhdimesise se biznesit – Kerkesat". Autoriteti kontraktor nuk po prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike te Sigurise shoqerore - Sistemet e menaxhimit te vazhdimesise se biznesit, perndryshe ne do ta kuptonim kerkesen. Ne proceduren objekt ankese nuk ka asnje mall apo sherbim te cilat karakteristika specifike te Siguria shoqerore - Sistemet e menaxhimit te vazhdimesise se biznesit.



112. Referuar Argumentimit te Kritereve te Kualifikimit, rezulton qartesisht se autoriteti nuk ka arritur dot ta mbeshtese ne ligj kerkesen dhe nuk ka arritur te argumentoje se perse kerkon nje ISO te tille. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka theksuar se:

Argumentim: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

Çertifikate ISO 22301-2012(e vlefshme) ose ekuivalente, eshte nje standard nderkombetar per Sistemet e Menaxhimit te Vazhdimesise se Biznesit. Ky eshte nje standart dhe nje kriter i vendosur per te siguruar autoritetin kontraktor mbi qendrueshmerine e vazhdueshme te operatorit ekonomik ofertues duke siguruar vazhdimesin e operacioneve dhe sherbimeve te ofruara kundrejt cdo rreziku. Ky kriter eshte nje kriter i cili siguron autoritetin kontraktor mbi qendrueshmerin ekonomike te vazhdueshme te operatorit ekonomik ofertues.

113. Referuar dispozitave ligjore ku eshte bazuar autoriteti kontraktor per hartimin e kriterit kualifikues, del qarte se asnje prej tyre nuk i jep te drejte autoritetit qe te kerkoje Certifikat ISO pavaresisht "merakut" te shtuar qe ka autoriteti kontraktor se mos Bizneset ngelen rruges dhe nuk i vene Mobilet ne destinacion.

114. Persa analizuam me siper, del qarte se kerkesa e autoritetit kontraktor per Certifikaten ISO 22301-2012 per "Siguria shoqerore - Sistemet e menaxhimit te vazhdimesise se biznesit", nuk lidhet aspak me objektin e kontrates dhe procedures se prokurimit, nuk eshte aspak e argumentuar, per pasoje kerkojme heqjen e ketij kriteri.

115. SE DYTI, ne ne lidhje me kerkesen "Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Çertifikate ISO 22301-2012(e vlefshme) ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, vlene argumenti i dhene me siper keshtu nuk do te bjeme perseritje.

Persa me siper, kerkojme heqjen e kerkeses qe detyron operatoret ekonomik te paraqesin Certifikatat ISO te Prodhuesit.

X) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:

116. Ofertuesi duhet te paraqese Çertifikate ISO 37001:2016 (e vlefshme) "sistemin e menaxhimit anti-ryshfet te kompanise ose ekuivalente" ose ekuivalente.

Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Çertifikate ISO 37001:2016

(e vlefshme) ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.
117. SE PARI, ne nenin 44 i VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, nuk permend askund Certifikata te tilla. Per me teper, qe kjo ISO 37001:2016 per “Sistemet e menaxhimit kunder ryshfetit ? Kerkesat me udhezime per

perdorim” nuk ka asnje pike lidhje me objektin e prokurimit. Pavaresisht kesaj, ne dispoziten ligjore te referuar me siper, eshte specifikuar qarte se autoriteti kontraktor mund te kerkoje per Mallrat dhe Sherbimet, Certifikata te Cilsise dhe jo cdo certifikat te mundshme ISO.
118. Ne nenin 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, theksohet se:
“1. Autoriteti/enti kontraktor, per te vertetuar se punet, mallrat ose sherbimet, objekt prokurimi, i plotesojne kerkesat e cilesise, mund t'u kerkoje ofertuesve te paraqesin certifikata te leshuara nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise, vetem nese ato jane te argumentuara dhe te lidhura ngushtesisht dhe ne menyre te drejtperdrejte me objektin e prokurimit.
2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se.
Kjo dispozite zbatohet edhe kur kerkesat teknike u referohen kualifikimeve te kandidatit ose te ofertuesit.
3. Certifikatat dhe etiketat e kerkuara duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me objektin e kontrates, si dhe çdo operator ekonomik duhet t? ket? akses n? to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.
4. N?se autoriteti/enti kontraktor k?rkojn? nj? certifikat?, ose etiket?, ata jan? t? detyruar t? pranojn? çdo certifikat? ose etiket? ekuivalente/ t? barasvlershme me t?, ose nj? dokument q? provon t? nj?jtin informacion.
5. Kur eshte e dukshme qe nje operator ekonomik e ka te pamundur te marre etiketen specifike, te cilesuar nga autoriteti/enti kontraktor ose nje etikete ekuivalente, brenda afateve kohore perkatese, per shkaqe qe nuk lidhen me ate operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon menyra te tjera vertetimi te pershtatshme, qe mund te perfshijne nje dosje teknike nga prodhuesi, nese operatori ekonomik ne fjale verteton se punet, furnizimet ose sherbimet qe ai duhet te ofrojne permbushin kerkesat e etiketes specifike ose kerkesat specifike te cilesuara nga autoriteti/enti kontraktor.”
119. Nderkohe, ne piken 2 te Nenit 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, ligjvenesi ka lene nje hapsire per autoritetin kontraktor qe te kerkoje etiketa, kur prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera:
“2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose te tjera, ne specifikimet teknike, kriteret per shpalljen e kontrates fituese ose ne kushtet per zbatimin e kontrates, mund te kerkoje nje etikete specifike si nje menyre per te vertetuar se punet, sherbimet ose furnizimet perkojne me karakteristikat e kerkuara, n? p?rputhje me nenin 37, t? LPP-se.”
120. Pra, ligjvenesi nuk i ka lene dore te lire autoritetit kontraktor me qellim qe te shmangi kerkesat abuzive dhe aspak te argumentuara sic eshte kerkesa e kualifikimit ne fjale ISO 37001:2016 per “Sistemet e menaxhimit kunder ryshfetit ? Kerkesat me udhezime per perdorim”. Autoriteti kontraktor nuk po prokuron pune, furnizime ose sherbime me karakteristika specifike per

“Sistemet e menaxhimit kunder ryshfetit ? Kerkesat me udhezime per perdorim” perndryshe ne do ta kuptonim kerkesen. Ne proceduren objekt ankese nuk ka asnje mall apo sherbim te cilat kane karakteristika specifike te “Sistemeve te menaxhimit kunder ryshfetit ? Kerkesat me udhezime per perdorim”.
121. Referuar Argumentimit te Kritereve te Kualifikimit, rezulton qartesisht se autoriteti nuk ka arritur dot ta mbeshtese ne ligj kerkesen dhe nuk ka arritur te argumentoje se perse kerkon nje ISO te tille. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka theksuar se:
Argumentim: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar dhe piken 3 te nenin 40 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per ISO 37001 eshte nje standard nderkombetar, per te perkufizuar kerkesat e nje sistemi menaxhimi anti-rryshfet.Qellimi i ketij standardi eshte qe te ndihmoje shoqerite, t’i paraprije, te zbuloje dhe te luftoje aktet e korrupsionit.
Bashkia Kamez eshte nje autoritet kontraktor I cili eshte pro organizmave kombetare dhe nderkombetare per luften kunder korrupsionit dhe nepermjet vendosjes se ketij kriteri kerkon te sigurohet mbi certifikimin e pastertise se figures se operatoreve ekonomik ofertues te cilet nepermjet pjesmarrjes ne kete procedure jane kandidat per ofrimin e sherbimit ne kete bashki. miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.
122. Referuar dispozitave ligjore ku eshte bazuar autoriteti kontraktor per hartimin e kriterit kualifikues, del qarte se asnje prej tyre nuk i jep te drejte autoritetit qe te kerkoje Certifikat ISO pavaresisht “merakut” te shtuar qe ka autoriteti kontraktor se mos e korruptojne operatoret ekonomik dhe pastaj atyre “do tu ngelte hateri” dhe do te “fyheshin” rende.
123. Persa analizuam me siper, del qarte se kerkesa e autoritetit kontraktor per Certifikaten ISO 37001:2016 per “Sistemet e menaxhimit kunder ryshfetit ? Kerkesat me udhezime per perdorim”, nuk lidhet aspak me objektin e kontrates dhe me objektin e procedures se prokurimit, nuk eshte aspak e argumentuar, per pasoje kerkojme heqjen e ketij kriteri.
124. SE DYTI, ne ne lidhje me kerkesen “Shenim: Ne rastin kur ofertuesi nuk eshte prodhues, te paraqese edhe Çertifikate ISO 37001:2016 (e vlefshme) ose ekuivalente, per prodhuesin e deklaruar te pajisjeve te mobilimit te ofertuara, te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit te cilat jane te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise”, vlene argumenti i dhene me siper keshtu nuk do te bjeme perseritje.
Persa me siper, kerkojme heqjen e kerkeses qe detyron operatoret ekonomik te paraqesin Certifikatat ISO te Prodhuesit.
XI) Ne kriteret e vecanta te kualifikimit eshte kerkuar:
125. 2.3.9 Operatori ekonomik, diten e hapjes se ofertave, per artikujt objekt prokurim, duhet te depozitojne prane Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamez, mostrat si me poshte:
? Tavolina nxenesi CU(120x64x45 cm)
? Karrige nxenesi CU (35x38x37/70 cm)

? Tavolina nxenesi AMU (120x75x45 cm)
? Karrige nxenesi AMU(35x38x42/75 cm)
? Tavolina mesuesi ne klasa (120x60x76 cm)
? Dollap per klasa
? Rafte per çdo mesues ne sallen e mesuesve
? Karrige per sallen polifunksionale
? Shtrat vizite per infermierine
? Mos paraqitja e mostrave nga OE eshte kusht per skualifikim nga AK.
Argumentimi: Ky kriter eshte vendosur nga ana e Autoritetit Kontraktor me qellim vertetimin se operatori ekonomik i ploteson kerkesat minimale ne perputhje me nenin 40, pika 6 b) te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. ku shprehet rrjedhimisht: 6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kerkoje operatoreve ekonomike te dorezojne deshmi, qe

tregojne se ata i plotesojne kerkesat minimale, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si:
a) mostra te mallit, kur e gjykon se kjo ka rendesi per vleresimin e ofertes teknike. N? k?t? rast, autoriteti/enti kontraktor duhet t? argumentoj? k?rkes?n p?r mostrat. Mostrat duhet te trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet te jene ne kontroll te autoritetit/entit kontraktor. N? rastin e procedurave t? zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor p?rcakton qart? procedur?n p?r dor?zimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori t? interesuar si dhe konfidencialitetin p?r pjes?marrjen n? proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesen e tij, brenda 30 (tridhjete) diteve pas nenshkrimit te kontrates, me kusht qe kontrata ne fjale te mos jete objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqesor. Ne rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesen e tij, brenda 30 (tridhjete) diteve nga data e marrjes se vendimit perfundimtar te anulimit;
Vendosja e kriterit te sipercituara ka per qellim verifikimin e perputhueshmerise se produkteve te ofruara nga operatoret ekonomike te interesuar me specifikimet teknike te kerkuara nga Autoriteti Kontraktor me qellim realizimin e kontrates objekt prokurimi me sukses.
Qellimi i vendosur nga ligjvenesi per paraqitjen e mostrave, eshte dhenia e mundesise se autoritetit kontraktor, i cili eshte pergjegjes per prokurimin e fondeve publike, te kryerjes se verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) te mostrave te dorezuar nga operatori ekonomik ne rast se keto te fundit jane ne perputhje me kerkesat e autoritetit kontraktor te pasqyruar ne specifikimet teknike te procedures se prokurimit. Njesia e Prokurimit gjykon se dorezimi i mostrave eshte i rendesishem per autoritetin kontraktor ne funksion te verifikimit te perputhshmerise se specifikimeve teknike me mostrat e dorezuara me qellim realizimin me sukses te kontrates objekt prokurimi.
Nga ana e AK jane kerkuar mostra ne perputhje me bazen ligjore te siperpermendur duke qene se nepermjet kerkeses per dorezim mostrash AK krijon siguri te plote dhe verteton plotesisht permbushjen e specifikimeve teknike dhe perputhshmerine e mallrave te kerkuar me ato te ofertuar nga operatori ekonomik.
Ne lidhje me afatin e levrimit te mallit nga ana specialistit te fushes u vleresua se nisur nga volumi i kontrates, proceset qe do kryhen (prodhim, transport, furnizim vendosje), furnizimi ne shkolle ne Bashkine Kamez te percaktuara ne plan shperndarje u caktua afati i levrimit prej _____ muajsh nga nenshkrimi i kontrates.

126. Ne nenin 2 “Qellimi” te ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qellim i ketij ligji eshte: a) te rrise efiçencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik; b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik; dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik.”
127. Ndekohe ne nenin 3 “Parime te pergjithshme” te ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:
“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatoret ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore jane te detyruara te zbatojne detyrimet e percaktuara ne legjislacionin mjedisor, social e te punes dhe ne dispozitat e marreveshjeve dhe konventat nderkombetare, te ratifikuara ne perputhje me Kushtetuten.”
128. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor eshte pergjegjes per prokurimin ne perputhje me dispozitat e ketij ligji dhe te akteve nenligjore te nxjerra ne zbatim te tij, duke

garantuar respektimin e parimeve te trajtimit te barabarte, transparences, konkurrences dhe mosdiskriminimit, te parashikuara ne kete ligj.
129. Ne nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kerkesat per kualifikim” i ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne kerkesat per kualifikim per operatoret ekonomike bazuar ne: a) pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftesine teknike dhe profesionale. Kerkesat kufizohen vetem ne ato qe jane te pershtatshme per te garantuar qe nje kandidat ose ofertues te kete kapacitetet juridike, financiare dhe aftesite teknike e profesionale per te zbatuar kontraten qe do te jepet. Te gjitha kerkesat duhet te kene lidhje dhe te jene proporcionale me objektin e kontrates. [...] 4. Ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne veçanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontratat e zbatuara ne te shkuaren. Aftesia profesionale e operatoreve ekonomike per te ofruar sherbimin, punen, mallin vleresohet ne lidhje me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem per te zbatuar kontraten, siç eshte pershkruar nga autoriteti ose enti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates.

130. Ne nenin 40 pika 6 germa a) “Kerkesa te veçanta per kontratat e mallrave” te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:
“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kerkoje operatoreve ekonomike te dorezojne deshmi, qe tregojne se ata i plotesojne kerkesat minimale, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si: a) mostra te mallit, kur e gjykon se kjo ka rendesi per vleresimin e ofertes teknike. N? k?t? rast, autoriteti/enti kontraktor duhet t? argumentoj? k?rkes?n p?r mostrat. Mostrat duhet te trajtohen si informacion konfidencial 38 tregtar dhe duhet te jene ne kontroll te autoritetit/entit kontraktor. N? rastin e procedurave t? zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor p?rcakton qart? procedur?n p?r dor?zimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori t? interesuar si dhe konfidencialitetin p?r pjes?marrjen n? proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesen e tij, brenda 30 (tridhjete) diteve pas nenshkrimit te kontrates, me kusht qe kontrata ne fjale te mos jete objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqesor. Ne rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kerkesen e tij, brenda 30 (tridhjete) diteve nga data e marrjes se vendimit perfundimtar te anulimit;”
131. Shoqeria jone thekson, se kriteret per kualifikim vendosen qe t’i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve te operatoreve ekonomike, te cilet nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithçka ne funksion realizimit me sukses te kontrates. Ne kete kuptim, per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatori ekonomik zoteron kapacitetet teknike, ne perputhje dhe ne perpjesetim me volumin e kontrates te percaktuar ne dokumentet e tenderit. Per autoritetin kontraktor eshte teper e rendesishme qe te sigurohet qe mallrat objekt-prokurimi te ofertuara nga operatoret ekonomike pjesemarres, jane ne perputhje me kerkesat ne dokumentet e tenderit. Ne percaktimin apo vendosjen e kritereve specifike, qe ne thelb konsiderohen si kritere fituese, per shkak te rendesise qe kane, ligjvenesi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit qe ka ne perzgjedhjen e tyre. Ne kete menyre, dispozitat e siperpermendura, urdherojne se percaktimi i ketyre kritereve duhet te jete: (i) ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates (ii) Ne çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatoret ekonomike per permbushjen e ketyre kritereve. Autoriteti kontraktues eshte ne te drejten e tij per te percaktuar kriteret per kualifikim,

mjafton qe ato te mos jene diskriminuese e perjashtuese.
132. Per kete arsye, gjykojme, se eshte me vend te ndalemi ne faktin nese kjo kerkese eshte ne proporcion me objektin e kontrates qe do te prokurohet ne zbatim te nenit 77 pika 1 te LPP-se. Ne rastin konkret, konstatohet se synimi baze i autoritetit kontraktor eshte vertetimi, se subjektet ofertues zoterojne kapacitetet e nevojshme per realizimin e kontrates. Per permbushjen e ketij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar ne dokumentet e procedures se prokurimit jo vetem kritere kualifikimi te cilat lidhen me vertetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere te tjera kualifikimi te cilat lidhen me vertetimin e plotesimit te specifikimeve teknike te produktit. Nga shqyrtimi i kritereve te kualifikimit, konstatojme, se per disa nga artikuj objekt-prokurimi, konkretisht:
? Tavolina nxenesi CU(120x64x45 cm)
? Karrige nxenesi CU (35x38x37/70 cm)

? Tavolina nxenesi AMU (120x75x45 cm)
? Karrige nxenesi AMU(35x38x42/75 cm)
? Tavolina mesuesi ne klasa (120x60x76 cm)
? Dollap per klasa
? Rafte per çdo mesues ne sallen e mesuesve
? Karrige per sallen polifunksionale
? Shtrat vizite per infermierine
kerkohet dorezimi i mostrave ne ambientet e autoritetit kontraktor. Sa me siper, referuar kerkesave te vendosura nga autoriteti kontraktor, si dhe argumenteve te parashtruara nga ana jone, gjykojme, se referuar objektit te prokurimit si dhe natyres se produkteve qe kerkohet te furnizohet, gjykojme se kerkesa e autoritetit kontraktor per paraqitjen e mostrave per artikujt e siperpermendur eshte nje kerkese e ekzagjeruar dhe qe shkon pertej asaj se çfare eshte e nevojshme per realizimin e synimit, nisur nga lloji dhe natyra e mallit qe kerkohet te prokurohet. Vlen te theksojme, se qellimi i autoritetit kontraktor, eshte furnizimi ne kohe dhe ne cilesi me produktet objekt-prokurimi, por ne respekt te parimeve te ligjit per prokurimin publik, kriteret e kualifikimit te hartuara nga autoriteti kontraktor, ne asnje rast nuk duhet te diskriminojne/perjashtojne nga konkurrimi operatoret ekonomike ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin keta kombetare apo nderkombetare. Ne hartimin e kritereve te kualifikimit autoritetet kontraktore duhet te shmangin çdo forme diskriminimi, e cila kufizon pjesemarrjen e gjere te operatoreve ekonomike ne nje procedure prokurimi. Akoma me tej, autoriteti kontraktor ka ne dispozicion edhe momentin procedural te kontrollit te dyte pas lidhjes se kontrates te perputhshmerise se produkteve te furnizuara nga operatori ekonomik i kualifikuar me ato te kerkuara nga autoriteti kontraktor. Referuar rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitoroje zbatimin e kontrates, per t'u siguruar nese cilesia e mallit do te jete e njejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuara ne oferte dhe te percaktuara ne kontrate.
Sa me siper, kerkojme heqjen e kriterit per paraqitjen e mostrave.
133. Akoma me tej, per mostrat ka vendosur edhe Komisioni i Prokurimeve Publike i cili merr vendime administrativisht perfundimtare. Ne vendimin Nr.454/2024, date 07.05.2024, KPP ka arsyetuar se duhet hequr kerkesa per Mostra:
"III.4.6.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapacitetetеve te operatoreve ekonomike, te cilet nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithçka ne funksion realizimit me sukses te kontrates. Ne kete kuptim, per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatori ekonomik zoteron kapacitetet teknike, ne perputhje dhe ne perpjesetim me volumin e kontrates te percaktuar ne dokumentet e tenderit. Per autoritetin kontraktor eshte teper e rendesishme qe te sigurohet qe mallrat objekt-prokurimi te ofertuara nga

operatoret ekonomike pjesemarres, jane ne perputhje me kerkesat ne dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ne percaktimin apo vendosjen e kritereve specifike, qe ne thelb konsiderohen si kritere fituese, per shkak te rendesise qe kane, ligjvenesi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit

qe ka ne perzgjedhjen e tyre. Ne kete menyre, dispozitat e siperpermendura, urdherojne se percaktimi i ketyre kritereve duhet te jete: (i) ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates (ii) Ne çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatoret ekonomike per permbushjen e ketyre kritereve. Autoriteti kontraktues eshte ne te drejten e tij per te percaktuar kriteret per kualifikim, mjafton qe ato te mos jene diskriminuese e perjashtuese.
III.4.7. Referuar pretendimit te operatorit ekonomik ankimues te paraqitur ne ankese, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se eshte me vend te ndalet ne faktin nese kjo kerkese eshte ne proporcion me objektin e kontrates qe do te prokurohet ne zbatim te nenit 77 pika 1 te LPP-se. Ne rastin konkret Komisioni konstaton, se synimi baze i autoritetit kontraktor eshte vertetimi, se subjektet ofertues zoterojne kapacitetet e nevojshme per realizimin e kontrates. Komisioni konstaton, se per permbushjen e ketij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar ne dokumentet e procedures se prokurimit jo vetem kritere kualifikimi te cilat lidhen me vertetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere te tjera kualifikimi te cilat lidhen me vertetimin e plotesimit te specifikimeve teknike te produktit. Nga shqyrtimi i kritereve te kualifikimit, KPP veren, se per disa nga artikuj objekt-prokurimi, konkretisht Element per raft zyre dhe tavolina 80*60; Karrike rrotulluese specialist; Element per Grila roller me gjithe mekanizem; Karrike fikse, kerkohet dorezimi i mostrave ne ambientet e autoritetit kontraktor. Sa me siper, referuar kerkesave te vendosura nga autoriteti kontraktor, si dhe argumenteve te parashtruara nga operatori ekonomik ankimues, ne ankesen e tij, gjykojme, se referuar objektit te prokurimit si dhe natyres se produkteve qe kerkohet te furnizohet, gjykojme se kerkesa e autoritetit kontraktor per paraqitjen e mostrave per artikujt e siperpermendur eshte nje kerkese e ekzagjeruar dhe qe shkon pertej asaj se çfare eshte e nevojshme per realizimin e synimit, nisur nga lloji dhe natyra e mallit qe kerkohet te prokurohet. Vlen te theksojme, se qellimi i autoritetit kontraktor, eshte furnizimi ne kohe dhe ne cilesi me produktet objekt-prokurimi, por ne respekt te parimeve te ligjit per prokurimin publik, kriteret e kualifikimit te hartuara nga autoriteti kontraktor, ne asnje rast nuk duhet te diskriminojne/perjashtojne nga konkurrimi operatoret ekonomike ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin keta kombetare apo nderkombetare. Ne hartimin e kritereve te kualifikimit autoritetet kontraktore duhet te shmangin çdo forme diskriminimi, e cila kufizon pjesemarrjen e gjere te operatoreve ekonomike ne nje procedure prokurimi. Akoma me tej, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka ne dispozicion edhe momentin procedural te kontrollit te dyte pas lidhjes se kontrates te perputhshmerise se produkteve te furnizuara nga operatori ekonomik i kualifikuar me ato te kerkuara nga autoriteti kontraktor. KPP sjell ne vemendje, se referuar rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitoroje zbatimin e kontrates, per t'u siguruar nese cilesia e mallit do te jete e njejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuara ne oferte dhe te percaktuara ne kontrate. Sa me siper pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qendron."
134. Nga sa me siper analizuar si edhe bazuar ne vendimin me te fundit te Komisionit te Prokurimeve Publike, kerkojme heqjen e kerkeses per paraqitjen e Mostrave.
Nga sa parashtruam dhe analizuam me siper, kerkojme:
? Pezullimin e procedures deri ne shqyrtimin e plote te ankeses;
? Pranimin teresisht te ankeses sipas parashtrimeve te referuara me siper, duke hequr dhe modifikuar kriteret e vecanta te kualifikimit te ankimuara.

**5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme**

Po ☐ Jo ☑

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)*

---

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

jo

---

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

jo

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:** gshehi@gmail.com

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar** Gëzim Shehi

Gezim Shehi

Digitally signed by Gezim Shehi
Date: 2024.06.18 01:29:45 +02'00'